



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Auditimi për auditimin e ushtruar në “Shoqërinë Rajonale të
Ujësjiellës Kanalizimeve, Elbasan”

32

RAPORT AUDITIMI
MBI PËRPUTHSHMËRINË

NË

SHOQËRINË RAJONALE TË UJËSJELLËS KANALIZIME
ELBASAN

TIRANË KORRIK 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-7
1.	Përshkrim i shkurtër i rezultateve të auditimit	2
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	2-5
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	6-7
II.	HYRJA	8-12
1.	Objektivat dhe qëllimi	8
2.	Identifikimi i çështjes	8
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4.	Përgjegjësitë e audituesve	9
5.	Kriteret e vlerësimit	9
6.	Standardet e auditimit	10
7.	Metodat e auditimit	10-11
8.	Dokumentimi i auditimit	11-12
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13-
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	13
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	13
2.1	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese,(Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori) vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	13-16
2.2	Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë.	16-30
2.3	Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.	30-44
2.4	Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).	44-73
2.5	Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.	73-80
2.6	Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.	80-90
IV.	REKOMANDIME	91-112
V.	ANEKSE	113-119
VI.	LISTA E DOKUMENTEVE	119-120

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Shoqëria Rajonale e Ujësjetës Kanalizimeve Elbasan(SHRUKE), është krijuar bazuar në VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për organizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” dhe Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetës Kanalizime Elbasan SHA, datë 15.07.2022, lidhur ndërmjet MIE dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin. Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M23322201V, datë 22.09.2022 dhe pjesëmarrje të aksioneve si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë 51%, Bashkia Elbasan 28.52%, Bashkia Cërrik 5.46%, Bashkia Belsh 4.42%, Bashkia Gramsh 4.13%, Bashkia Peqin 3.34% dhe Bashkia Librazhd 3.13%. Shoqëria kryen aktivitetin në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Rregullores së Brendshme dhe Statutit.

-Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë, sipas Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, është:

-Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;

-Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;

-Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;

-Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;

-Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura

-Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

-Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi;

Auditimi në Shoqërinë Rajonale Elbasan dhe njësitë e UK, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar riorganizimi i shoqërisë, shpenzime për investime, shpenzimet operative, strukturat dhe pagat, programi ekonomik dhe realizimi i tij, etj. Është audituar vendimmarrja e organeve drejtuese, si edhe probleme të tjera.

Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime të pajustificuara në zbatimin e kontratave, në strukturën organizative dhe pagat, mangësi në dokumentacionin bankar si edhe në drejtim të përthithjes së 6 shoqërive të UK, etj.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ Procedurat e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit

Në 4 raste janë konstatuar punime të pakryera me një **dëm ekonomik në vlerën 1,335,638 lekë** projektet e investimit me objekt “Ujësjetësi i fshatit Bishqem xhami dhe ndërtim pusi”, “Instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengel-Samurr-Golodesh, (për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve)”, “KUZ Belsh Lagjia Hysë” dhe “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjetësit në Fshatin Zgosht, Bashkia Librazhd”.

▪ Referuar akt - rakordimit midis SHRUKE dhe FSHU të muajit mars 2024, rezulton se

SHRUKË ka një detyrim total për energjinë elektrike në vlerën 2,044,387,395.08 lekë, nga e cila vlera e detyrimit për energjinë elektrike të konsumuar është 1,058,289,531 lekë, ndërsa vlera prej 986,097,863 lekë është kamatëvonesë.

Detyrimi i kamatëvonesave nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Po ashtu, përveç aktit të rakordimit midis SHRUKË dhe FSHU, Drejtoria Tregtare nuk dispononte evidenca lidhur me këtë detyrim të ndarë në vite.

Për shkak se shitësi i energjisë elektrike FSHU SHA, për arkëtimin e detyrimeve që Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA ka ndaj tij, ka angazhuar përmbaruesin privat, shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Elbasan ka paguar edhe shpenzimet përmbarimore në vlerën 14,224,576 lekë, vlerë e cila ashtu si edhe interesat, ka rënduar edhe më shumë buxhetin e shoqërisë. Vlera e kamatëvonesave prej 986,097,863 lekë, si dhe vlera për shpenzimet përmbarimore prej 14,224,576 lekë, pra në total shuma e vlerave të mësipërme prej 1,000,322,439 lekë, e paguar pa përfituar asgjë, por për shkak të mos pagesave të detyrimeve për energjinë elektrike, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shoqërisë, si dhe keq përdorim i fondeve publike.

- Për sa më sipër përmbaruesit privat kanë ndaj SHRUKË SHA dy detyrime:

- a) arkëtimin e debisë nga debitorët e ujit në vlerën 83,428,616 lekë;
- b) arkëtimin e shpenzimeve përmbarimore të paguara paradhënie nga ish Ujësjetllës Kanalizime Elbasan, në vlerën 18,049,762 lekë, të cilat duhet të paguhen nga debitorët nëpërmjet përmbarimit, për llogari të SHRUKË SHA.

Vlera prej 18,049,762 lekë konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e SHRUKË SHA dhe buxhetin e shtetit.

Gjithashtu, vlera prej 83,428,616 lekë konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet, si rezultat i mos mbledhjes së detyrimeve që debitorët e ujësjetllës kanë ndaj SHRUKË SHA. Për këto detyrime duhet të ishin marrë masat e duhura për tu arkëtuar nga vetë subjekti i audituar dhe më vonë pas lidhjes së kontratës me përmbaruesin privat, nga këta të fundit.

- Nga grupi i auditimit u konstatua se lidhur me vonesat e ndryshme në pagesa, SHRUKË SHA dhe njësitë, është gjobitur si më poshtë: me “Detyrimin për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale”, “Gjoha me DRSHTRR”, “Gjoha për likuidimin e vonuar të taksave të Bashkisë Elbasan”, “Gjoha nga QKB”, “Gjoha për O...”, etj, nga ku rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë paguar gjoha dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën 10,621,713 lekë, e cila konsiderohet *efekt financiar negativ* në buxhetin e SHRUKË SHA.

Gjithashtu, edhe pse nuk është paguar ende vlera 9,476,713 lekë, e cila përfaqëson gjoha të pa paguara, kjo vlerë do të ketë efektet e saj negative në buxhetin e vitit të ardhshëm, me kryerjen e pagesës.

- Në dokumentet përkatëse që shoqërojnë veprimet ekonomike të ish shoqërive, dokumentet vërtetuese janë me mangësi duke mos pasur të dhëna të plota e të sakta që përshkruajnë me vërtetësi kalimet, treguesit sasiorë dhe të vlerës, fletëdaljet, proces verbalët e dorëzimit, etj. Faturat janë përpiluar në përshkrimin e mallit me cilësimin si transferim inventarësh afatgjatë, afatshkurtër, inventar i imët, etj, duke mos pasur përshkrimin përcaktues të aktiveve të transferuara. Në veprimet e transferimit të aktivitetit tek shoqëria përthithëse nuk janë respektuar përcaktimet në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011.

- Në marrëveshje janë përcaktuar procedurat që duhen ndjekur për transferimin e njërive, por nga auditimi konstatohet se referuar listë pagesave personat të cilët janë caktuar me detyrën e likuidatorit kanë qenë punonjës të njërive dhe janë punonjës në strukturën e SHRUKË. Për periudhën 8 mujore nga SHRUKË është paguar për likuidatorët e njërive shuma 3,606,215 lekë. Nga auditimi konstatohet se Likuidatorët nuk kanë kryer asnjë funksion në lidhje me transferimin

e njësisve si edhe veprimet që duhej të ndiqnin në zyrat e Drejtorive tatimore dhe QKB për çregjistrimin e aktivitetit të njësisve.

- Gjendja llogarive të arkëtueshme, klientët më 31.12.2023 është 480,579,000 lekë dhe në krahasim me gjendjen më 31.12.2022 e cila ishte 523,317,000 lekë, rezulton të jetë zvogëluar në vlerën 42,738,000 lekë. Ulja e detyrimeve të klientëve ka ardhur si rezultat i masave të marra nga drejtimi i shoqërisë, si identifikimi dhe ndjekja e debitorëve me shoqëritë përmbarese, njoftimet përkatëse si edhe ndërprerje të shërbimit.

-Situata e llogarive të pagueshme paraqitet e rënduar, me detyrime për furnitorë në vlerën 1,174,224,406 lekë, ku 996,730,000 lekë janë detyrime ndaj FSHU, të mbartura nga ish UK rajonale, si dhe një pjesë të madhe furnitorë të mbartur. Vlera e detyrimit ndaj FSHU përmban vetëm principalin si detyrim. Shoqëria nuk ka përfshirë vlerën prej 986,097,000 lekë kamatëvonesa në zërin e detyrimeve. Në llogaritë për tu paguar rezultojnë detyrime për të tretë që mbulohen me fonde të Buxhetit të Shtetit, në vlerën 375,635,000 lekë, ku vlerën më të madhe e ka “Strabag AG” me 312,299,000 lekë. Në llogarinë 467 me vlerë 176,358,368 lekë, shoqëria ka kontabilizuar detyrimet ndaj bashkive për taksën që mbledh për llogari të tyre, vlera këto të mbartura në bilanc nga ish UK rajonale.

Situata ekonomiko financiare e shoqërisë nuk është e mirë. Shoqëria e re e krijuar ka mbartur nga ish UK rajonale vlera të konsiderueshme detyrimesh, të cilat tejkalojnë shumë herë llogaritë e arkëtueshme.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës Kanalizime në lidhje me **zbatimin e kontratave të punimeve të ndërtimit** të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga sipërmarrësit e punimeve arkëtimin e vlerës prej **1,335,638 lekë** të faturuara dhe të paguara nga AK, konstatuar dëm ekonomik nga mos kryerja e punimeve.

- Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të analizojnë **efektin negativ financiar** me vlerë **10,621,713 lekë**, të nxjerrë përgjegjësitë dhe shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë, si edhe të merren masa për likuidimin e detyrimeve për gjobat në vlerën **9,476,713 lekë**, të cilat janë krijuar për mos pagesën në kohë të detyrimeve nga ish Ujësjiellës Kanalizime Peqin SHA, mospagesa të cilat sjellin **si pasojë urdhër sekuestro të llogarive bankare** të Shoqërisë Rajonale të Ujësjiellës Kanalizime Elbasan dhe njësitë e saj.

- Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të kërkojë prej përmbareuesve privat me të cilët ka lidhur 1019 kontrata, zbatimin prej tyre të detyrimeve kontraktuale, pra arkëtimin e debisë në vlerën 83,428,616 lekë, si dhe të vlerës së shërbimit prej 18,049,762 lekë.

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë në të ardhmen të lidh kontratë shërbimi me zyrën përmbareuese shtetërore dhe jo me përmbareues privat.

- Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të marrin masa për arritjen e një aktmarrëveshjeje me FSHU lidhur me shlyerjen e detyrimit prej 2,044,387,395 lekë, në mënyrë që të shmanget vendosja e masës sekuestro konservative nga përmbareimi privat dhe krijimi i kamatëvonesave të tjera.

- Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës Kanalizime dhe Drejtoria e Financës të marrë masa për arkëtimin e shumës **3,606,215 lekë**, nga likuidatorët e 6 shoqërive të UK përfituar padrejtësisht nga procesi i bashkimit të shoqërive (sipas listës në aneksin nr.1).

- Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë, të marrin masa në lidhje me

menaxhimin e aktiveve të njësisë dhe riskut të lidhur me to, duke miratuar sistemet e kontrollit dhe të informimit. Gjithashtu të merren masa për vlerësimin e gjendjes së aktiveve si ndërtesa, linja ujësjellësi, pajisje teknologjike, duke plotësuar informacionet për to me koston, dëmtime e avari, vlerën aktuale, mirëmbajtjet e kërkuara me qëllim përmirësimin e strukturës së tyre.

▪ Këshilli i Mbikëqyrës dhe administratori i SHRUK Elbasan SHA, të vlerësojnë me prioritet situatën e llogarive të arkëtueshme të shoqërisë, të kryejë një analizë objektive të të gjithë abonentëve debitorë, të ri-konfirmojë ekzistencën e tyre, të specifikohen grupet kryesore dhe të ndërmarrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre.

3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

Opinion për auditimin e përputhshmërisë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve ish UK Cërrik SHA, ish UK Belsh SHA, ish UK Gramsh SHA, ish UK Peqin SHA, ish UK Librazhd SHA për periudhën nga data 01.01.2020 deri më 19.09.2022; ish UK Elbasan për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 19.09.2022, si dhe Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA për periudhën nga 19.09.2022 deri më datë 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjektet të ligjeve, vendimeve, rregulloreve, udhëzimeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjektet e audituara, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

Opinionin i modifikuar i kundërt¹:

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se veprimtaria e ish shoqërive UK, nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Shkeljet e konstatuara janë materiale dhe të përhapura, gjë e cila justifikon dhënien e një opinionin të modifikuar të kundërt.

Baza për opinionin e modifikuar të kundërt.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjekteve ish UK Cërrik SHA, ish UK Belsh SHA, ish UK Gramsh SHA, ish UK Peqin SHA, ish UK Librazhd SHA për periudhën nga data 01.01.2020 deri më 19.09.2022; ish UK Elbasan për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 19.09.2022, si dhe Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA për periudhën nga 19.09.2022 deri më datë 31.12.2023 në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet ISSAI-P1, “Deklarata e Limës”; ISSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI P-12, ISSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që

¹ -Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, vendimin nr. 24, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.102), Kapitulli VII, pika 7.3.2. “Në varësi të masës së mospërputhjes, kjo mund të rezultojë në: (i) Opinion të kundërt (nëse rastet e mospërputhjeve janë materiale dhe të përhapura).

lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 400 dhe 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë, si dhe evidentimin e çështjeve të mëposhtme:

Çështjet kryesore:

-Parregullsi në procesin e bashkimit në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA, në lidhje me transferimin e aktiveve. Në dokumentet vërtetuese e shoqëruese të akteve të transferimit mungonin të dhënat e plota e të sakta për identifikimin e aktiveve.

-Nga ish shoqëritë UK SHA, nuk janë kryer zhvlerësimet e aktiveve financiare të bartura në pasqyrat financiare të shoqërisë mëmë.

- Nga ish shoqëritë UK SHA, nuk janë përdorur norma menaxheriale të mirë-argumentuara nga specialistët përkatës, në amortizimin e aktiveve.

-Në lidhje me zbatimin e kontratave për punime:

Në 4 raste janë konstatuar punime të pakryera me një dëm ekonomik në vlerën 1,335,638 lekë projektet e investimit.

-Llogaritë bankare të SHRUKE SHA janë sekuestruar përgjatë periudhës kohore 2021 - 2022, nga përmbartuesi privat.

-Vlera totale e detyrimit ndaj OSHEE Group SHA, deri në periudhën e auditimit në terren, rezulton në vlerën 2,044,387,395 lekë, nga ku detyrimi për energjinë elektrike ka arritur në vlerën 1,058,289,531 lekë dhe kamatëvonesat e këtij detyrimi në vlerën 986,097,863 lekë detyrim ky i cili përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë SHRUKE SHA.

-Për shkak të mosveprimeve lidhur me shlyerjen e këtyre detyrimeve janë paguar shpenzime përmbartimore në vlerën 14,224,576 lekë, që konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e SHRUKE SHA.

-Në vitin 2023 vlera e debisë së kthyer nga debitorët për detyrime ndaj ujësjellësit është 288,033 lekë, kurse vlera e kthyer për pagesën e përmbartimit privat është 3,778,966 lekë. Po ashtu, duke analizuar rezultatin financiar të kësaj mase të marrë për të ulur detyrimet e palëve të tretë SHRUKE SHA, rezulton se kjo shoqëri është rënduar financiarisht në vlerën 18,049,762 lekë që konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e SHRUKE SHA.

-Lidhur me vonesat e ndryshme në pagesa, SHRUKE SHA dhe njësitë Elbasan, Peqin dhe Librazhd - Përrenjas, për periudhën objekt auditimi kanë paguar gjoba dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën 10,621,713 lekë që konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e SHRUKE SHA. Gjithashtu edhe pse nuk është paguar ende vlera 9,476,713 lekë, e cila përfaqëson gjoba të pa paguara, kjo vlerë do të ketë efektet e saj negative në buxhetin e vitit të ardhshëm, me kryerjen e pagesës.

-Për periudhën 8 mujore nga SHRUKE është paguar për likuidatorët e njërive shuma 3,606,215 lekë. Nga auditimi konstatohet se Likuidatorët nuk kanë kryer asnjë funksion në lidhje me transferimin e njërive si edhe veprimet që duhej të ndiqnin në zyrat e Drejtorive tatimore dhe QKB për çregjistrimin e aktivitetit të njërive.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme

dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, hartimin e rregullave të brendshme referuar funksionit të veprimtarisë së shoqërisë, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi në zbatim të akteve ligjore në fuqi, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit. Përgjegjësi e strukturave drejtuese të institucionit është përdorimi me efektivitet dhe ligjor të fondeve, duke eliminuar shpenzimet jo efektive dhe jo në funksion të veprimtarisë së tij, sigurisht dhe marrja e masave për njohjen e akteve ligjore që veprojnë dhe në fuqi për të gjithë punonjësit e strukturës funksionale duke programuar trajnimin e vazhdueshëm dhe mbikëqyrur integritetin e tyre.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së: Përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme, që veprimtaria e subjektit nën auditim, në të gjitha aspektet, është pa gabime dhe anomali materiale. Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), Objektivi ynë lidhet me dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të projekteve të huaja, me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Për këtë audituesit e KLSH, aplikojnë gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese nëpërmjet të cilës, audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme që trajtohen në këtë material.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1044/1, datë 05.01.2024, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 08.01.2024 deri në datë 15.04.2024, në subjektin Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës Kanalizime SHA, Elbasan, për periudhën nga data 19.09.2022 deri në datë 31.12.2023, rajonet e ish UK Cërrik, Belsh, Gramsh, Peqin dhe Librazhd për periudhën nga data 01.01.2020 si edhe ish UK Elbasan për periudhën nga data 01.01.2022 deri në ditën e përthithjes nga Shoqëria Rajonale UK Elbasan, u krye auditimi “Mbi Përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare” nga Grupi i Auditimit, me përbërje:

1. M. B, Përgjegjës Grupi
2. A. T
3. S. H
4. K. G
5. B.Sh
6. I. B

1. Objektivat dhe qëllimi Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës Kanalizime SHA, Elbasan dhe njësitë e UK, në të gjithë aspektet materiale, aktivitet ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizën ligjore të prokurimit publik, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së Shoqërisë. Auditimi ka për qëllim promovimin e transparencës, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar, siç kërkohet në aktet ligjore. Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuarra i shkëlqes së parimeve të ligjshmërisë, është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga subjekti i audituar. Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik, duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

2. Identifikimi i çështjes Shoqëria duhet të ketë organizimin e duhur për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet. Raporti i Auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime SHA, Elbasan për periudhën e audituar, ka identifikuar sipas kriterëve specifikë të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Ligjshmërinë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese dhe vendimeve të marra;
- Hartimin, shqyrtimin, miratimin si edhe realizimin e programit ekonomik;
- Zbatimin e strukturës organizative dhe administrimin e marrëdhënieve të punës;
- Rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve;
- Mbajtjen e evidencës kontabile dhe analiza e debitorëve e kreditorëve;
- Zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave; etj.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Një ndër përgjegjësitë kryesore të strukturave drejtuese është ngritja e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive të punonjësve. Hartimi i rregullave të brendshme referuar funksionit të veprimtarisë së shoqërisë, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi në zbatim të akteve ligjore në fuqi, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit. Përgjegjësi e strukturave drejtuese të institucionit është përdorimi me efektivitet dhe ligjor të fondeve, duke eliminuar shpenzimet jo efektive dhe jo në funksion të veprimtarisë së tij, sigurisht dhe marrja e masave për njohjen e akteve ligjore që veprojnë dhe në fuqi për të gjithë punonjësit e strukturës funksionale duke programuar trajnimin e vazhdueshëm dhe mbikëqyrur integritetin e tyre. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Në zbatim të dispozitave ligjore, Shoqëria, merr masa për:

- Krijimin e kushteve të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së punonjësve.
- Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për mbarëvajtjen në punë.
- Zbatimin e rregullave për mbrojtjen nga zjarri.
- Zbatimin e dispozitave të vendosura në Kontratën e Punës.

4. Përgjegjësitë e audituesve Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion të saktë objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen ose jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara mbi përputshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë ekonomiko financiare, në bazë të auditimit tonë. Ne mbajmë përgjegjësi që në praktikën e auditimit si dhe në hartimin e Raportit të auditimit janë zbatuar procedurat në përputhje me rregulloret e miratuara dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Referuar këtyre Standardeve audituesi gjithashtu duhet të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Siguria e kërkuar i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

5. Kriteret e vlerësimit Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë dhe dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;; Ligji nr. 8901, datë 23.05.2012 “Për falimentin”, i ndryshuar;; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; i ndryshuar, Ligji nr.35/2023, datë 24.03.2023 “Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar; VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi

në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”,

6. Standardet e auditimit Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

-Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

-ISSAI 100 – (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*).

-ISSAI 400 – (*Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë*).

-Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.

-ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;

-ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;

-Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;

-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

7. Metodatat e auditimit Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Shoqërisë, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjyqimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet, observacionet e subjektit dhe hartimin e Projekt Raportit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morrën në konsideratë dy elementë:

-Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe

-Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, dhe Publikimi i Auditimit.

▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve

justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara nuk kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- *Kontrolli i vlerësimeve*

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmimi nga të tretët*

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- *Kontrolli sipas një treguesi*

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- *Intervista*

U kryen intervista me specialistët e Shoqërisë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

- *Raporte dhe Informacione*

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim

- *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuar të gabimeve materiale. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja².

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

8. Dokumentimi i auditimit është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore.

² Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Raporti i auditimit është i strukturuar në 6 kapituj. Në kapitullin e parë të përmbledhjes ekzekutive janë trajtuar çështjet e rezultateve të auditimit, gjetjet rekomandimet kryesore dhe konkluzioni e opinionit i auditimit, në kapitullin e dytë janë trajtuar objektivat dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve, metodat, etj. Në vijim në kapitullin e tretë është përshkrimi i auditimit, në të cilin trajtohet një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 6 drejtimeve të auditimit. Në kapitullin e katërt jepen rekomandimet, bazuar në rezultatet e auditimit gjetjet dhe rekomandimet të strukturuar sipas llojit të tyre, janë vendosur në kapitullin e pestë anekset dhe kapitulli gjashtë lista e dokumenteve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizimeve Elbasan(SHRUKE), është krijuar bazuar në VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për organizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” dhe Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh. a, datë 15.07.2022, lidhur ndërmjet MIE dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin. Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M23322201V, datë 22.09.2022 dhe pjesëmarrje të aksioneve si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë 51%, Bashkia Elbasan 28.52%, Bashkia Cërrik 5.46%, Bashkia Belsh 4.42%, Bashkia Gramsh 4.13%, Bashkia Peqin 3.34% dhe Bashkia Librazhd 3.13%. Shoqëria kryen aktivitetin në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Rregullores së Brendshme dhe Statutit.

-Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë, krijuar sipas Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, është:

-Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;

-Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;

-Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;

-Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;

-Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura

-Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

-Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi;

Auditimi në Shoqërinë rajonale Elbasan dhe njësitë e UK, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar riorganizimi i shoqërisë, shpenzime për investime, shpenzimet operative, strukturat dhe pagat, programi ekonomik dhe realizimi i tij, etj. Është audituar vendimmarrja e organeve drejtuese, si edhe probleme të tjera.

Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve, zbatimin e kontratave, në strukturën organizative dhe pagat, mangësi në dokumentacionin bankar si edhe në drejtim të përthithjes së 6 shoqërive të UK, etj.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori) vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA përbëhet prej 5 anëtarë të cilët janë z. A. L, znj. A. J, znj. E. B, znj. A. S dhe z. E. H. Me Vendim Qarkullues Nr.2, datë 16.11.2022 të Asamblesë së Përgjithshme është zëvendësuar anëtarja znj. A. S me anëtarin z. A.Q.

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA përbëhet nga z. K. J (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), z. G. Ll (Bashkia Elbasan), z. K. G (Bashkia

Librazhd), z. K.T (Bashkia Gramsh), z. A. S (Bashkia Cërrik), z. A.T (Bashkia Belsh) dhe z. L. T(Bashkia Peqin).

-Për vitin 2022 Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme ka marrë 3 vendime dhe 3 vendime qarkullues.

-Për vitin 2023 Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme ka marrë 7 vendime dhe 1 vendim qarkullues.

Asambleja e Përgjithshme:

Me Vendim Nr.1, datë 19.09.2022, Asambleja e Përgjithshme pasi shqyrtoi të gjitha çështjet, vendosi:

-Emërimin e Këshillit Mbikëqyrës për një afat 3 vjeçar i përbërë prej z. A. L, znj. A. J, znj. E. B, znj. A. S dhe z. E.H.

-Emërimin si Administrator të shoqërisë për një periudhë 1 vjeçare z. L. T.

-Të caktojë si ekspert kontabël të parë të shoqërisë Audituesit ligjorë O. V dhe A. B me afat 1 vjeçar nga data e këtij vendimi.

-Të caktojë ekspert kontabël për mbikëqyrjen e procedurave të transferimit të aktivitetit të shoqërive Ujësjiellës Kanalizime Elbasan, Librazhd, Cërrik, Gramsh, Belsh, Peqin, Audituesin Ligjor z. S.T, i cili duhet të përgatisë raportin e transferimit të aktiveve.

-Përcaktimin e pagës së Administratorit.

-Përcaktimin e pagave të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

-Përcaktimi i një emërtimi të shkurtuar të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan SHA me emërtimin Ujësjiellës Kanalizime Rajoni Elbasan

-Përcaktimi i logos së shoqërisë së re.

Grupi i auditimit konstaton se vendimmarrja e çështjeve të mësipërme nga Asambleja e Përgjithshme është marrë komform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi *Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”* i ndryshuar si dhe Statuti i Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan SHA.

Këshilli Mbikëqyrës:

-Këshilli Mbikëqyrës ka marrë Vendimin Nr.2, datë 25.11.2022 me objekt “Miratimi i ndryshimeve në Buxhetin e vitit 2022 të shoqërisë”. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administratori i shoqërisë z. L. T. Grupi i auditimit konstaton se në zbatimin e këtij vendimi nuk ka mangësi.

-Këshilli Mbikëqyrës ka marrë Vendimin Nr.3, datë 09.12.2022 me objekt “Miratimi i Buxhetit të vitit 2023 të shoqërisë”, “Miratim struktura organizative” dhe “Miratim tarifa të tjera”. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administratori i shoqërisë z. L. T. Grupi i auditimit konstaton se në zbatimin e këtij vendimi nuk ka mangësi dhe vendimmarrja është konform përgjegjësive që ka Këshilli Mbikëqyrës.

- Vendimet e Këshillit të Administrimit “Ujësjiellës Kanalizime Librazhd” SHA viti 2020-2022.

Këshilli i Administrimit “UKL” SHA përbëhet prej 3 anëtarëve të cilët janë z. A. M, z. F. K dhe z. A. G.

-Për vitin 2020 Këshilli i Administrimit ka marrë 26 vendime.

-Për vitin 2021 Këshilli i Administrimit ka marrë 27 vendime.

-Për vitin 2022 Këshilli i Administrimit ka marrë 19 vendime.

- Vendimet e Këshillit të Administrimit “Ujësjiellës Kanalizime Cërrik” SHA viti 2020-2022.

Këshilli i Administrimit “UKC” SHA përbëhej prej 4 anëtarëve, të cilët janë z. E. H, z. A. D, znj. F. Xh dhe z. E. T.

-Për vitin 2020 Këshilli i Administrimit ka marrë 13 vendime.

-Për vitin 2021 Këshilli i Administrimit ka marrë 16 vendime.

-Për vitin 2022 Këshilli i Administrimit ka marrë 11 vendime.

- Vendimet e Këshillit të Administrimit “Ujësjetllës Kanalizime Belsh” SHA viti 2020-2022.

Këshilli i Administrimit “UKB” SHA përbëhej prej 3 anëtarëve të cilët janë z. M. B, z. H.Gj dhe z. E. P.

-Për vitin 2020 Këshilli i Administrimit ka marrë 12 vendime.

-Për vitin 2021 Këshilli i Administrimit ka marrë 12 vendime.

-Për vitin 2022 Këshilli i Administrimit ka marrë 13 vendime.

- Vendimet e Këshillit të Administrimit Ujësjetllës Kanalizime Peqin SHA viti 2020-2022.

Këshilli i Administrimit “UKP” SHA përbëhej prej 3 anëtarëve të cilët janë znj. M. S, z. N.T dhe z. M. S.

-Për vitin 2020 Këshilli i Administrimit ka marrë 7 vendime.

-Për vitin 2021 Këshilli i Administrimit ka marrë 7 vendime.

-Për vitin 2022 Këshilli i Administrimit ka marrë 1 vendim.

- Vendimet e Këshillit të Administrimit njësia Ujësjetllës Kanalizime Gramsh SHA viti 2020-2022.

Këshilli i Administrimit “UKG” SHA përbëhej prej 3 anëtarëve të cilët janë z. Z. C, z. Xh. B, z. T. B dhe z. A.Sh.

-Për vitin 2020 Këshilli i Administrimit ka marrë 8 vendime.

-Për vitin 2021 Këshilli i Administrimit ka marrë 10 vendime.

-Për vitin 2022 Këshilli i Administrimit ka marrë 9 vendime.

- Vendimet e Këshillit të Administrimit Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA viti 2022.

Këshilli i Administrimit “UKE” SHA përbëhej prej 5 anëtarëve, të cilët janë z. A. C, z. C. L, znj. A. B, z. L.K dhe z. A.Q.

-Për vitin 2022 Këshilli i Administrimit ka marrë 14 vendime

- Vendimet e Këshillit të Administrimit Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA viti 2022-2023.

Për sa më sipër grupi i auditimit konstatoi:

-Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA nuk ka një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e pranishëm në atë mbledhje në kundërshtim me *Statutin e Shoqërisë Neni 14, pika 6.*

-Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të SHRUKE SHA nuk kanë një kontratë pune me shoqërinë, në të cilën janë parashikuar ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritët të arrijë anëtari i Këshillit në terma vjetorë në kundërshtim me *Statutin e Shoqërisë Neni 12, pika 3.*

-Këshilli Mbikëqyrës i Ujësjetllës Kanalizime Peqin SHA, për vitet objekt auditimi nuk ka dërguar për miratim pasqyrat financiare drejtuar Asamblesë së Përgjithshme dhe rrjedhimisht ato nuk janë të miratuara veprime këto në kundërshtim me *Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Neni 81, pika 1.e).*

-Këshilli Mbikëqyrës i SHA Ujësjetllës Kanalizime Cërrik për vitet objekt auditimi nuk ka dërguar për miratim pasqyrat financiare drejtuar Asamblesë së Përgjithshme dhe rrjedhimisht ato nuk janë të miratuara veprime këto në kundërshtim me *Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Neni 81 pika 1.e).*

Në procesverbalin e mbajtur nga Sekretari i Këshillit Mbikëqyrës z. A. K për mbledhjet e Këshillit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA nuk ka një përshkrim për çështjet e diskutuara prej anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje veprime këto në kundërshtim me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Neni 161, pika 3.

2.2. Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë.

Në lidhje me zbatimin e kriterëve në planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas ligjeve dhe udhëzimeve të Ministrisë mbi hartimin dhe zbatimin e programit ekonomik, bazuar në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme e shoqërisë
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë.
- Statuti i Shoqërisë
- Programet e miratuara dhe ndryshimet e kryera gjatë vitit
- Realizimi i shpenzimeve me planifikimet.
- Zbatimi i kriterëve në programim, mbështetur në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Programet ekonomikë dhe financiarë për vitet 2020-2022 për 6 shoqëritë e Ujësjellës kanalizimeve deri në 31.12.2022, janë miratuar me Vendimet e Këshillave Mbikëqyrës si mëposhtë:

Nr	Njësia	Vendimet e këshillit mbikëqyrës
1	Elbasan	
	Viti 2022	nr.398, datë 24.12.2021
2	Librazhd	
	Viti 2020	nr.19, datë 27.12.2019
	Viti 2021	nr.15, datë 24.12.2020
	Viti 2022	nr.24, datë 28.12.2021
3.	Cërrik	
	Viti 2020	nr.16, datë 31.01.2019
	Viti 2021	nr.10, datë 19.10.2020
	Viti 2022	nr.3, datë 28.03.2022
4.	Belsh	
	Viti 2020	nr.1/3, datë 07.01.2020
	Viti 2021	nr.1, datë 09.01.2021
	Viti 2022	nr.2, datë 25.01.2022
5.	Gramsh	
	Viti 2020	nr.2, datë 07.02.2020
	Viti 2021	nr.1, datë 28.01.2020
	Viti 2022	nr.2, datë 03.02.2022
6.	Peqin	
	Viti 2020	nr.8, datë 30.12.2019
	Viti 2021	nr.1, datë 22.12.2020
	Viti 2022	nr.1, datë 06.01.2022

Për ushtrimin e aktivitetit shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve kanë hartuar dhe miratuar programet ekonomikë dhe financiar të zhvillimit për vitet 2020, 2021 dhe 2022. Në lidhje me hartimin,

miratimin dhe realizimin e programit ekonomik për periudhën objekt auditimi, janë paraqitur treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara si edhe treguesit e mbulimit të Kostos direkte dhe kostos totale të operimit. Gjithashtu është bërë edhe krahasimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara më planin.

Parashikimi dhe realizimi i treguesve kryesorë, për çdo shoqëri paraqitet si mëposhtë:

1. Ujësjiellës Kanalizime - Gramsh

000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
	Kosto e punës	27,214	26,469	97	29,968	29,273	98	31,397	30,868	98
	Kosto e energjisë	2,360	2,408	102	2,500	2,182	87	2,500	3,640	146
	Kosto e riparimit	5,729	4,070	71	5,861	3,884	66	6,856	4,787	70
	Kosto te tjera	5,696	4,393	77	6,356	4,224	66	9,962	9,560	96
I	Kosto Direkte	40,999	37,340	91	44,685	39,564	89	50,715	48,855	96
	Pa amortizimin	40,999	37,340	91	44,685	39,564	89	50,715	48,855	96
	Amortizimi	6,500	6,868	106	8,000	9,260	116	8,800	8,889	101
II	Kosto Totale	47,499	44,208	93	52,685	48,824	93	59,515	57,744	97
	Familjarë	28,051	28,015	100	28,987	29,207	101	28,056	27,907	99
	Totali i faturuar	4,689	4,824	103	4,826	4,848	100	4,855	4,965	102
III	Shuma e faturuar	32,740	32,839	100	33,813	34,055	101	32,911	32,872	100
	Shuma të tjera	3,448	5,765	167	4,613	5,354	116	10,090	11,210	111
IV	Totali te ardhura nga faturimi	36,188	38,603	107	38,426	39,409	103	43,001	44,083	103
	Subvencion nga shteti		1,667							

Për vitin 2020, Në tabelën më sipër është paraqitur një panoramë e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara për vitin 2020 si dhe treguesit e mbulimit të Kostos direkte dhe kostos totale të operimit. Gjithashtu në këtë pasqyrë është bërë krahasimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara me planin e miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit. Për vitin 2020 siç jepet edhe në tabelë kostoja direkte e operimit është mbuluar 103.38% nga të ardhurat e vitit 2020, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 87.32%.

Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 107% të planit dhe shpenzimet në masën 91% të planit.

Për vitin 2020, paraqiten me tejkalim shpenzimet për zërin “energji elektrike” +2% nga planifikimi.

Subvencioni i UK Gramsh është përdorur për mbulimin e kostove.

Për vitin 2021, referuar tabelës kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 99.61% nga të ardhurat e vitit 2021, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 80.72%.

Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 103% të planit dhe shpenzimet në masën 96% të planit.

Për vitin 2022, Kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 90.23 % nga të ardhurat e vitit 2022, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 76.34%.

Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 103% të planit dhe shpenzimet në masën 96% të planit Për vitin 2022, paraqiten me tejkallim shpenzimet për zërin “energji elektrike” +46% nga planifikimi.

Pra, në 3 vite shoqëria me të ardhurat e realizuara nuk ka mbuluar koston duke rritur humbjen çdo vit.

2. Ujësjellës Kanalizime - Peqin

Nr	Emërtimi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
	Kosto e punës	38,478	38,526	100	44,250	44,362	100	47,790	47,006	98
	Kosto e energjisë	25,000	30,788	123	26,250	32,659	124	27,563	50,167	182
	Kosto e riparimit	3,000	2,924	97	5,209	4,951	95	4,566	5,329	117
	Kosto të tjera	10,759	7,010	65	8,950	6,929	77	5,788	6,941	120
	Kosto kimikateve	2,800	2,871	103	2473	1,938	78	1,000	1,052	105
	Kosto karburanteve	674	774	115	1000	1,039	104	800	894	112
I	Kosto Direkte	80,711	82,893	103	88,132	91,878	104	87,507	111,389	127
	Taksa dhe tatime								9,458	
	Pa amortizimin	80,711	82,893	103	88,132	91,878	104	87,507	120,847	138
	Amortizimi	4300	4,220	98	4,515	6062	134	4,741	5003	106
II	Kosto Totale	85,011	87,113	102	92,647	97,940	106	92,248	125,850	136
III	Shuma e faturuar	50,715	36,505	72	58,322	50,460	87	64,154	49,120	77
	Shuma të tjera		270			519			411	
IV	Totali të ardhura nga faturimi	50,715	36,775	73	58,322	50,979	87	64,154	49,531	77
	Subvencion nga shteti		12, 671			8, 858				

Për vitin 2020, Referuar tabelës më sipër janë paraqitur treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara për vitin 2020 si edhe treguesit e mbulimit të Kostos direkte të operimit dhe koston totale.

Për vitin 2020, kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 44.36% nga të ardhura e vitit 2020, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 42.22%.

Në lidhje më realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 73% të planit dhe shpenzimet në masën 103% të planit.

Për vitin 2020, paraqiten me tejkallim shpenzimet për zërin “energji elektrike” +23% nga planifikimi, shpenzimet për kimikate në masën +3% dhe shpenzimet e karburantit në masën +15%.

Për vitin 2021, kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 54.92 % nga të ardhurat e vitit 2021, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 51.52%. Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 87 % të planit dhe shpenzimet në masën 104% të planit.

Për vitin 2021, paraqiten me tejkallim shpenzimet për zërin “energji elektrike” +24% nga planifikimi dhe shpenzimet e karburantit në masën +4%.

Subvencioni i UK Peqin është përdorur për mbulimin e shpenzimeve për energji elektrike, paga, sigurime dhe likuidim furnitorësh.

Për vitin 2022, Referuar tabelës kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 44.1 % nga të ardhurat e vitit 2022, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 39.03 %. Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 77 % të planit dhe shpenzimet në masën 127 % të planit. Për vitin 2022, paraqiten me tejkalim shpenzimet për zërin “energji elektrike” +82% nga planifikimi, kosto të tjera në masën +20%, kosto e riparimit +17%, shpenzimet e karburantit në masën +12% dhe shpenzimet për kimikate në masën +5%.

Për 3 vite kjo shoqëri paraqet tejkalime të theksuara të disa zërave të shpenzimeve dhe mosrealizim të të ardhurave me tregues negativ në rritje nga njëri vit në tjetrin. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura, Shoqëria ka performuar dobët nën nivelin 80%. Ky rezultat ka ardhur kryesisht si pasojë e kostove të larta për energjinë elektrike që nevojitet për prodhimin e ujit të pijshëm.

Planifikimi i shpenzimeve nuk është bazuar në realizimin e vitit paraardhës por janë planifikuar për vitin pasardhës apriori, pa analiza dhe kërkesa nga degët si: shpenzime karburanti, kosto e punës, kosto të tjera, kosto e riparimit, ku referuar tabelës më lart rezulton se nga një vit në tjetrin këto shpenzime janë planifikuar më të larta nga realizimi i vitit paraardhës.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. N. T, me detyrë Administrator, z. A. Xh- ish Drejtor Teknik.

2. Ujësjellës Kanalizime -Belsh

Nr	Emërtimi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
	Kosto e punës	38,782	37,282	96	41,011	37,052	90	40,386	38,730	96
	Kosto e energjisë	32,090	30,895	96	30,895	31,258	101	34,384	46,485	135
	Kosto e riparimit	4,422	2,726	62	2,863	1,983	44	2,082	3,190	153
	Kosto të tjera	1,050	1,020	97	1,071	946	88	993	1,130	114
	Kosto kimikateve	330	415	126	423	429	101	442	431	98
	Kosto karburanteve	1,600	1,350	84	1,485	1,236	83	1,273	1,871	147
	Kosto të tjera kontraktimi	1,592	2,124	133	1,574	2,036	129	1,699	2,123	125
I	Kosto Direkte	79,866	75,812	95	79,322	74,940	94	81,259	93,960	116
	Taksa dhe tatime	155	152	98	80	69	86	82	47	57
	Pa amortizimin	80,021	75,964	95	79,402	75,009	94	81,341	94,007	116
	Amortizimi	3,774	3,912	104	4,303	5,427	126	4,733	5,361	113
II	Kosto Totale	83,795	79,876	95	83,705	80,436	96	86,074	99,368	115
III	Shuma e faturuar	51,300	53,596	104	53,034	54,552	103	57,102	52,142	91
	Shuma të tjera	1,137	857	75	910	829	91	895	796	89
IV	Totali të ardhura nga faturimi	52,437	54,453	104	53,944	55,381	103	57,997	52,938	91
	Subvencion nga shteti		6,963			4,792				

Për vitin 2020, kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 71.83 % nga të ardhurat e vitit 2020, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 68.17 %. Në lidhje me realizimin Plan - Fakt

të treguesve të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 104 % të planit dhe shpenzimet në masën 95 % të planit.

Për vitin 2020, paraqiten me tejkalim shpenzimet për zërin “kimikate” +26% nga planifikimi dhe kosto të tjera në masën +33%.

Për vitin 2021, kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 73.9 % nga të ardhurat e vitit 2021, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 68.85 %.

Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 103 % të planit dhe shpenzimet në masën 94 % të planit.

Për vitin 2021, paraqiten me tejkalim shpenzimet për zërin “kimikate” +1% nga planifikimi dhe kosto të tjera në masën +29 % dhe shpenzime energjie +1%.

Subvencioni për UK Belsh për vitin 2020, është përdorur për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike, pagat dhe sigurimet shoqërore.

Subvencioni për vitin 2021, është përdorur për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike.

Për vitin 2022, kostoja direkte e operimit është mbuluar 56.34% nga të ardhurat e vitit 2022, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 53.27%. Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 91% të planit dhe shpenzimet në masën 116 % të planit.

Për vitin 2022, paraqiten me tejkalim shpenzimet për zërin “Energji elektrike” +35% nga planifikimi dhe kosto të tjera në masën +14%, kosto e riparimit +53%, shpenzime karburanti në masën +47% dhe shpenzime të tjera kontraktuale +25%.

Për 3 vite kjo shoqëri paraqet tejkalime të theksuara të disa zërave të shpenzimeve dhe mosrealizim të ardhurave me tregues negativ në rritje nga njëri vit në tjetrin. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura Shoqëria ka performuar dobët nën nivelin 80%. Ky rezultat ka ardhur kryesisht si pasojë e kostove të larta për energjinë elektrike që nevojitet për prodhimin e ujit të pijshëm. *Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. E.P, ish Administrator, z. O. T ish drejtor Teknik dhe z. P.T ish drejtor Teknik.*

3. Ujësjetës Kanalizime - Cërrrik

Nr	Emërtimi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
	Kosto e punës	29,272	32,615	111	29,272	43,659	149	39,168	44,510	114
	Kosto e energjisë	-	28,019		-	21,092		-	44,534	
	Kosto e riparimit	3,000	1,503	50	3,000	1,863	62	3,000	2,950	98
	Kosto kimikateve	800	896	112	800	214	27	800	820	103
	Kosto karburanteve	800	666	83	800	780	98	1,000	1,000	100
	Kosto të kontraktuara	1,177	936	80	1,177	1,132	96	1,177	1,243	106
	Kosto të tjera	6,758	6,473	96	6,958	10,533	151	7,650	10,050	131
I	Kosto Direkte	41,807	71,108	170	42,007	79,273	189	52,795	105,107	199
	Taksa dhe tatime	-	850			2,235		-	1,500	
	Pa amortizimin	41,807	71,958	172	42,007	81,508	194	52,795	106,607	202
	Amortizimi		8,774			7,453			6,268	
II	Kosto Totale	41,807	80,732	193	42,007	88,961	212	52,795	112,875	214
III	Shuma e faturuar	78,064	42,760	55	37,936	22,207	59	37,860	20,093	53

	Shuma të tjera	4,000	4,505	113	4,000		0	4,000		0
IV	Totali të ardhura	82,064	47,265	58	41,936	22,207	53	41,860	20,093	48
	Subvencion nga shteti		6,759							

Për vitin 2020, kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 66% nga të ardhurat e vitit 2020, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 59%. Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 58% të planit dhe shpenzimet në masën 170% të planit.

Për vitin 2020, paraqiten me tejkalim shpenzimet për zërin “Kosto pune” +11% nga planifikimi dhe kosto e kimikateve në masën +12%.

Për vitin 2021, kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 28% nga të ardhurat e vitit 2021, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 25%. Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 53% të planit dhe shpenzimet në masën 189% të planit.

Për vitin 2022, kostoja direkte e operimit është mbuluar 24% nga të ardhurat e vitit 2022, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 22%. Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 48% të planit dhe shpenzimet në masën 199% të planit.

Konstatohet se zërat e shpenzimeve nuk janë planifikuar bazuar në rezultatet e vitit paraardhës si: Kosto e riparimit dhe energji elektrike, Nga kjo shoqëri nuk janë planifikuar shpenzimet për energjinë elektrike, si një nga zërat kryesor të shpenzimeve. Shpenzimet për energjinë elektrike për vitin 2020 janë 28,019 mijë lekë, për vitin 2021 në shumën 21,092 mijë lekë dhe për vitin 2022 në shumën 44,534 mijë lekë. Shpenzim i cili nga viti në vit ka ardhur në rritje dhe nga shoqëria nuk është planifikuar.

Për 3 vite kjo shoqëri paraqet tejkalime të theksuara të disa zërave të shpenzimeve dhe mosrealizim të të ardhurave me tregues negativ në rritje nga njëri vit në tjetrin. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura, Shoqëria ka performuar dobët nën nivelin 80%. Ky rezultat ka ardhur kryesisht si pasojë e kostove të larta për energjinë elektrike që nevojitet për prodhimin e ujit të pijshëm. *Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. E. T, me detyrë Administrator dhe zj. F. Xh me detyrë shefe financës.*

5. Ujësjellës Kanalizime - Librazhd

Nr	Emërtimi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Kosto e punës	37,847	32,673	86	33,800	33,677	99.5	37,340	36,496	98
2	Kosto e energjisë	310	276	89	312	414	132	450	596	132
3	Kosto e riparimit	6802	5,955	88	6,730	3,882	58	5,160	4,608	89,3
	Mirëmbajtje rrjeti	5502	4,702	85	5,240	3,133	60	4,127	3,655	88,5
	Kosto kimikateve	300	298	99	550	157	28.5	200	171	85
	Kosto karburanteve	1,000	955	95	940	592	63	833	782	94
4	Shpenzime të tjera	12,090	11,653	96	12,791	10,156	79	3,100	3,044	98
	Kosto shërbime kontraktuara	10,090	9,918	98	9,041	7,309	81	-	-	-
	Kosto të tjera	2,000	1,735	86	3,750	2,847	76	3,100	3,044	98
I	Kosto Direkte	57,049	50,557	89	53,633	48,129	89,7	46,050	44,744	97
	Taksa dhe tatime	300	253	84	287	259	90	325	233	72
	Pa amortizimin	57,349	50,810	88	53,920	48,388	89.7	46,375	44,977	97

	Amortizimi	8700	8,647	99	8,675	8,276	95	8,675	9,255	107
II	Kosto Totale	66,049	59,457	90	62,595	56,664	90.5	55,050	54,232	98,5
III	Shuma e faturuar	52,885	50,539	95	53,938	51,867	96	57,591	55,660	97
	Shuma të tjera	15,020	5,601	37	8,657	4,814	55,6	6,873	5,615	82
IV	Totali të ardhura faturimi	67,905	56,140	83	62,595	56,681	90,5	64,464	61,275	95
	Subvencion nga shteti		-			-			-	

Për vitin 2020, kostoja direkte është mbuluar në masën 111% nga të ardhurat e vitit 2020, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 94 %.

Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 82.67 % të planit dhe shpenzimet në masën 90% të planit.

Për vitin 2021, kostoja direkte është mbuluar në masën 117% nga të ardhurat e vitit 2021, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 100%.

Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 90,5 % dhe shpenzimet në masën 90,5% të planit.

Për vitin 2022, kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 134% nga të ardhurat e vitit 2022, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 111%. Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 95% dhe shpenzimet në masën 98,5% të planit. Për vitet 2021 dhe 2022 me tejkalim paraqiten shpenzimet për energjinë elektrike me +32%.

6. Ujësjellës kanalizime - Elbasan viti 2022

Nr	Emërtimi	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
	Kosto e punës	249,150	251,368	101
	Kosto e energjisë	120,000	160,191	133
	Kosto e riparimit	50,000	42,562	85
	Kosto kimikateve	9,000	7,142	79
	Kosto karburanteve	10,000	9,530	95
	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	79,101	61,718	78
	Kosto të tjera	3,000	1,152	38
I	Kosto Direkte	520,251	533,663	103
	Taksa dhe tatime	8,000	8,265	103
	Pa amortizimin	528,251	541,928	103
	Amortizimi	138,317	135,138	98
II	Kosto Totale	666,568	677,066	102
III	Shuma e faturuar	400,629	362,426	90
	Shuma të tjera	14,190	25,754	181
IV	Totali të ardhura nga faturimi	414,819	463,513	112
	Subvencion nga shteti		75,333	

Viti 2022, kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 87% nga të ardhurat e vitit 2022, ndërsa kostoja totale e operimit është mbuluar në masën 68 %. Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 112 % të planit

dhe shpenzimet në masën 102% të planit. Me tejkalim paraqiten shpenzimet për energjinë elektrike me +33% dhe kosto e punës me +1%. *Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. L. K., ish Administrator.*

Konkluzion: -Hartimi i programeve ekonomike të zhvillimit të shoqërive nuk është kryer për periudha afatmesme dhe afatgjata bazuar në objektivat e caktuara nga organet drejtuese.

-Programet e zhvillimit të shoqërisë pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës nuk janë miratuar nga Ministria përgjegjëse për ekonominë.

-Shoqëritë e UK kanë përfituar subvencion nga shteti për mbulimin e shpenzimeve të energjisë dhe nuk kanë marrë mendimin e Ministrisë përkatëse për vazhdimin e procedurave të miratimit të programeve ekonomike.

-Zërat e shpenzimeve nuk janë planifikuar bazuar në rezultatet e vitit paraardhës dhe mungon analiza ekonomike për rezultatet e arritura.

Në hartimin dhe miratimin e programeve ekonomike të shoqërive nuk janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 dhe 4.

II. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha, mbulon me shërbim ujësjellës dhe kanalizime Bashkitë e Qarkut Elbasan, si: Bashkia Elbasan, Bashkia Peqin, Bashkia Belsh, Bashkia Cërrik, Bashkia Librazhd dhe Bashkia Gramsh.

Hartimi i programit ekonomik të vitit 2023, ka synuar rimëkëmbjen ekonomike të Shoqërisë Rajonale UK Elbasan. Njëkohësisht, nëpërmjet politikave të kujdesshme si për të ardhurat edhe për shpenzimet, është synuar të sigurohet një ulje e qëndrueshme e deficitit buxhetor me qëllim uljen në nivelin 268 milionë lekë nga 370 milionë lekë. Ky program është bazuar në përmirësimin e administrimit dhe funksionimit të Shoqërisë, duke mbështetur në këtë mënyrë rimëkëmbjen ekonomike të saj. Të ardhurat janë parashikuar të rriten me 14.7% krahasuar me vitin 2022. Kjo rritje është parashikuar në një strategji të re për rritjen e faturimit dhe uljes së ujit pa të ardhura me impakt pozitiv në rritjen e arkëtimeve dhe mbulimin e shpenzimeve. Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2023 parashikohet të përqendrohen kryesisht në mbulimin e kostove operim mirëmbajtje. Shpenzimet e planifikuara synojnë mirëmbajtjen në mënyrën më eficiente të të gjithë sektorëve të shoqërisë, si edhe mbështetja që ka dhënë qeveria për sektorin e furnizimit me ujë nëpërmjet reformave të ndërmarra dhe financimit të investimeve të nevojshme, do të bëjë të mundur që të përmirësohen treguesit në rang rajoni.

Programi ekonomik i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Elbasan për vitin 2023, është miratuar dhe ndryshuar me vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Aksionareve, si më poshtë:

Nr Vendimi	Vendimet e këshillit mbikëqyrës
Nr.3, date 09.12.2022	Vendim i Këshillit Mbikëqyrës
Nr.4, date 29.12.2022	Vendim i Asamblesë së Aksionareve
Nr.4, datë 07.04.2023	Vendim i Këshillit Mbikëqyrës (Ndryshime)
Nr.4/1, datë 02.05.2023	Vendim i Asamblesë së Aksionareve (Ndryshime)

Për ushtrimin e aktivitetit shoqëria e Ujësjellës Kanalizimeve ka hartuar dhe miratuar programin ekonomik dhe financiar të zhvillimit për vitin 2023. Në lidhje me hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik, janë paraqitur treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara si edhe treguesit e mbulimit të Kostos direkte dhe kostos totale të operimit. Gjithashtu është bërë edhe krahasimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara më planin.

Parashikimi dhe realizimi i treguesve kryesorë, paraqitet si mëposhtë:

000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2023		
		Plan	Fakt	%
	Kosto e punës	578,360	571,249	99
	Kosto e energjisë	269,242	175,377	65
	Kosto e riparimit	26,957	20,733	77
	Kosto kimikateve	9,450	6,509	69
	Kosto të tjera + të kontraktuara	110,062	109,542	100
	Kosto e karburanteve	20,000	16,575	83
	Kosto të tjera	20,736	21,123	102
I	Kosto Direkte e operimit	1,034,807	921,108	89
	Taksa dhe tatime	6,132	7,830	128
	Shuma pa amortizimin	1,040,939	928,938	89
	Amortizimi	-	115,660	
II	Kosto Totale	1,040,939	1,044,598	100
	Familjarë	438,444	402,926	92
	Totali i faturuar	198,990	155,761	78
III	Shuma e faturuar	637,434	564,299	89
	Shuma subvencion + të ardhura të tjera		62,687	
IV	Totali të ardhura nga faturimi	637,434	626,986	98
	Norma e Arkëtimit të Faturave (%/Vit)	73.6%	66.7%	
	Arkëtime nga të Ardhurat nga Shitja (viti korrent)	469,259	376,427	80
	Arkëtime nga Shitja (faturat e prapambetura)	323,584	208,809	64
	Arkëtime nga Shërbime të Tjera	15,077	41,5345	275
	Arkëtime Total	807,921	683,845	84
	Grand nga AKUM		334,718	

Kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 68% nga të ardhurat e vitit 2023, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 60%.

Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 98% të planit dhe shpenzimet në masën 100% të planit. Për vitin 2023, paraqiten me tejkalim shpenzimet për zërin “Taksa dhe tatime” +28%, zëri “Kosto të tjera” +2% nga planifikimi.

Megjithëse të ardhurat janë realizuar në masën 98%, niveli i mbulimit të Kostos është tejet i ulët krahasuar edhe me kërkesat e përcaktuara në “Strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitet 2022 – 2030” ku për vitin 2023 ky tregues parashikohet në nivelin 90%.

Në muajin Prill 2023, në disa zëra shpenzimesh janë bërë ndryshime në programin ekonomik, si më poshtë:

Përshkrimi	Ishte	Bëhet	Diferenca
Shpenzime Paga	401,136	434,862	+33,726
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	59,713	65,513	+5,800
Trajtim Personeli/shpërblime	64,865	73,665	+8,800
Blerje matësa uji	0	18,333	+18,333
Energji Elektrike	314,242	269,242	-45,000

Shërbim Sigurimi Roje	58,157	49,246	-8,911
Qira	930	2,382	+1,452
Shpenzime/Shërbime te tjera te aktivitetit	18,036	20,136	2,100
Fondi rezerve	51,232	34,932	-16,300

1. Ndryshim i zërit "Paga", "Sigurime Shoqërore dhe shëndetësorë", "Trajtim personeli"

-Ndryshimi i fondit të pagave për efekt ndryshimi të pagës minimale, bazuar ne VKM nr. 113 datë 01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", ndryshuar paga minimale nga 34,000 lekë në 40,000 lekë. Efekti në buxhet vetëm për këtë kategori pagash është shtesë prej 28,295 mijë lekë për periudhën e mbetur (paga + sigurime).

-Indeksi i kategorive te pagave me 5% për nivelet e pagave 40,000 – 60,000 pasojë e ndryshimit të pagës minimale, indeksim të pagave sipas kategorive të cilat përafroheshin me 5%. Efekti në buxhet vetëm për këtë kategori pagash është shtesë prej 11,231 mijë lekë (paga + sigurime) për periudhën e mbetur të vitit.

-Përcaktimi i shtesave në pagë për punë të vështira dhe të dëmshme për shëndetin, si dhe rillogaritja e fondit për punë jashtë orarit. Në bazë të VKM 234, datë 20.04.2022 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme të administratës publike", janë përcaktuar nga ana e Shoqërisë pozicionet e punëve të vështira dhe të dëmshme për shëndetin. Pozicionet e punës janë:

-Punonjës së sektorit KUN,

-Punonjës të cilët punojnë në prezencë të substancave toksike të cilat shkaktojnë dëmtime në organizëm (Hipoklorit Natriumi, etj)

Është llogaritur një shtesë prej 150 lekë/ditë pune.

Gjithashtu është bërë një rillogaritje e fondit për punë jashtë orari të punonjësve të shoqërisë, për shkak se nuk mund të zëvendësohen apo tu jepet dite pushimi.

2.Ndryshim i zërit "Blerje matësa uji"

Për nevojat e Shoqërisë dhe për arritjen e treguesit se performancës për matjen 100% e të gjithë klientëve si dhe për matjen e sakte te konsumit te tyre, është hartuar një plan pune nga ana e strukturës përkatëse të shoqërisë. Nga kjo kërkese del se është e nevojshme blerja e matësve individuale si dhe aksesoreve te tjerë. Ne total kërkohen blerja e 8,000 cope matësa $\frac{1}{2}$, 2,370 cope matesa $\frac{3}{4}$, dhe aksesore te tjerë. Këto matesa do te përdoren për instalime tek klientët qe aktualisht faturohen me përllogaritje për fryme, si dhe për zëvendësime te matesave ekzistuese te cilët kane kaluar afatin e shfrytëzimit dhe nuk masin sakte sasinë e konsumuar. Vlera e parashikuar për blerje është rreth 22.000 mijë leke me TVSH për 1 vit. Vlera e mësipërme nuk do te ndikoje negativisht ne financat e shoqërisë pasi ne momentin e instalimit te matësit, vlera reflektohet ne faturën e ujit për tu paguar nga klienti.

3.Ndryshim i zërit "Energji elektrike"

Është rillogaritur kosto e energjisë elektrike bazuar ne Vendimin e ERRE për ndryshim çmimi për këh. Ne parashikimin e Buxhetit fillestar, bazuar ne harxhimin e energjisë elektrike për prodhim uji te pijshëm, është llogaritur një kosto energjie ne rang rajoni prej 314,242 leke pa TVSH. Bazuar ne Vendimin e Entit Rregullator te Energjisë Nr 16 date 06.02.2023 "Mbi përcaktimin e çmimit te shitjes se energjisë elektrike për vitin 2023 për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime te cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë se Fundit, me aplikimin e çmimit te ri 11.77 leke/këh për nivelet e tensionit 20/10/6kv, është llogaritur kostoja e re e energjisë prej 269,242 mijë leke pa TVSH. Ky zë i kostove ka një ulje prej rreth 45 milion leke pa TVSH.

4.Ndryshim zëri "Shërbim sigurimi i rojeve"

Ne baze te Buxhetit te miratuar te vitit 2023, fondi për Shërbimin e ruajtjes se Sigurisë fizike ishte 58.157 mijë lekë (pa TVSH) për 1 vit. U kryen procedurat e prokurimit dhe u lidh kontrata për periudhën 13.03.2023 – 12.03.2024 me vlere prej 43.245 mijë leke pa TVSH. Operatori ekonomik i cili ka lidhur kontratën ka paraqitur kërkesë për rritje te çmimit te kontratës bazuar ne Nenin 18 te ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat te sigurisë fizike”, VKM nr. 113 date 01.03.2023 “për përcaktimin e pagës minimale ne shkalle vendi”, Neni 81 i kodit te punes per oret e punes se turnit te dyte dhe te trete. Ne baze te perllogaritjeve vlere e kontrates duhet te rritet me 6.000 mijë leke pa TVSH.

5. Ndryshim i zërit “Qira”

Nga informacioni i sjelle paraprakisht nga 6 ish UK, u eshte kerkuar te sjellin kontratat e qirave të lidhura me efekt edhe ne vitin 2023 per parashikim ne buxhetin e vitit aktual. Nga ana e njësisë Belsh jemi venë në dijeni vetëm së fundmi për ekzistencën e një kontrate qiraje për tokën ku është ndërtuar depoja e uji të pijshëm. Vlora e kësaj kontrate për vitin 2023 është 1,020,240 lekë. Gjithashtu e njejta situatë është me objektin e marrë me qira në Peqin me vlerë vjetore 360,000 lekë.

6. Ndryshim i zërit “Shpenzime te tjera te aktivitetit”

Kërkoet shtese ne shërbimet e kontraktuara pasi shtrirja territoriale e sistemeve te ujësjellësit te UK Rajoni Elbasan është e madhe. Kemi sisteme ujësjellësi ne fshatra te largëta te cilat furnizojnë vetëm 15 - 80 klientë. Është detyrimi i shoqërisë ti shërbeje këtyre banoreve por nga ana ekonomike nuk është e justifikueshme përcaktimi i një punonjësi me kohe të plotë për secilin nga këto sisteme për mirëmbajtjen teknike te tyre. Për këtë arsye është parashikuar lidhja e kontratave te shërbimit për mirëmbajtjen e rrjetit ujësjellës me vlere shpërblimi te përcaktuar sipas numrit te klientëve te cilët ata do te shërbejnë, qe varion nga 3,000 - 12,000 leke/muaj. Vlora per kete shërbim eshte perllogarithur ne 2,100 mijë leke/vit ne total per 23 sisteme.

-Kosto personeli, nga krahasimi i të dhënave plan - fakt, vihet re rritje e koston së personelit si pasojë e rritjes së pagës minimale në shkallë vendi dhe shpenzimeve në rritje të personelit si pasojë e mbingarkesës në numër punonjësish.

-Kosto “blerje materiale” ka rritje, pasi është shtuar zëri “blerje matësa uji individuale”.

-Kosto “energji elektrike” ka ulje në vlerë pas vendimit të Entit Rregullator të Energjisë për ulje të çmimit për këh për Shoqëritë Ujësjaellës Kanalizime.

-Zëri “Blerje materiale elektrike” vazhdimësi e kontratës së lidhur në njësinë Elbasan (marrëveshje kuadër me vlerë totale 40,642 mijë lekë. Për vitin 2023 ka përfunduar kontrata nr.2, me vlerë 15,489 mijë lekë, ndërsa kontrata nr.1 është realizuar në vitin 2022 me vlerë 25,149 mijë lekë.

-Zëri “Blerje materiale hidraulike”, vazhdimësi e kontratës së lidhur me njësinë Elbasan (marrëveshje kuadër me vlerë totale 83,986 mijë lekë, dhe afat 36 muaj) Për vitin 2022 është realizuar 28,443 mijë lekë, për vitin 2023 është realizuar me vlerë 40,021 mijë lekë.

-Zëri “bokullime” është kryer procedura dhe marrja në dorëzim me datë 12.12.2023, por fatura elektronike ka ardhur me dt 17.01.2024, nr.7/2024. Pra, si shpenzim dhe detyrim njihet për periudhën 2024.

-Zëri “gjoba dhe penalitete” janë përfshirë të gjitha gjobat e marra për Shoqërinë dhe dëmshpërblimet e paguara, ku pjesën më të madhe e zë pagesa e dëmshpërblimit të ish punonjësës sipas vendimit te gjykatës me vlerë 1,323,179 lekë. Pjesa tjetër janë gjoba nga Bashkia, gjobat nga DRSHTRR, Drejtoria Rajonale tatimore dhe QKB.

-Zëri “taksa, licenca dhe leje” janë përfshirë te gjitha shpenzimet dhe pagesat per tarifat vjetore te ERRU, ABU, Bashkive te njesive dhe tarifave te tjera per tu paguar.

-Zëri “shpenzime të tjera” përfshin tarifën e ekspertëve kontabël për 6 njësitë 4,397,000 lekë, shpenzimet për komisione bankare 234,905 lekë, shpenzime përmbarimi 2,496,607 lekë, shpenzim për sistemin e faturimit 9,300,000 lekë, oponencë teknike për projekt 499,973 lekë, lidhje e re FSHU 1,752,138 lekë dhe të tjera 940,410 lekë (pulla dhe vendime gjyqësore, rievim topografik, nshpim pusi, aplikime për leje ndërtimi, shtesë fuqie FSHU, etj).

Në total kostot faktike janë në vlerën 1,044,598 mijë lekë, parashikimi i tyre ka qenë në vlerën 1,040,939 mijë lekë, me një tejkalim nga parashikimi në shumën 3,659 mijë lekë.

Parashikimi i nivelit të shpenzimeve në koston totale paraqitet:

Nr.	Emërtimi	Plan	Fakt
1.	Kosto personeli	55%	62%
2.	Kosto energji elektrike	26%	19%
3.	Kosto materiale	11%	12%
4.	Kosto shërbime të ndryshme	8%	7%

Referuar tabelës, konstatohet se kosto e personelit është tejkaluar në masën 7% dhe kosto e materialeve është tejkaluar në masën 1% nga parashikimi.

Kosto e personelit ka peshën më të madhe në koston totale.

Referuar plan - biznesit të zhvillimit të shoqërisë për vitet 2023 – 2027, efikasiteti i personelit parashikon ulje të vazhdueshme nga viti në vit të numrit të personelit arritjen e numrit të punonjësve 6/1000 lidhje aktive, tregues i cili nuk është arritur. Për vitin 2023 konstatohet se kosto e personelit zë 62% të Kostos totale. Gjithashtu përkeqësimi i treguesve lidhet edhe me cilësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore brenda shoqërisë.

-Në programin ekonomik për vitin 2023, shoqëria ka planifikuar një fond rezervë në shumën 51,232 mijë lekë. Planifikimi i këtij zëri është argumentuar për përdorim të ngjarjeve emergjente, avari, etj. Në fakt nga auditimi konstatohet se për vitin 2023, ky fond është përdorur për shpenzime të cilat shoqëria duhet ti planifikonte me hartimin e programit ekonomik si: për mbulimin e shpenzimeve paga, shpërblime, etj, nga i cili për këtë vit është përdorur vlera 16,300 mijë lekë.

Për ndryshimet në programin ekonomik mungojnë kërkesat për shtesa në blerje, paga, shpërblime, të cilat shoqërohen me informacion nga degët përkatëse.

Arkëtimet për vitin 2023

Përshkrimi	Plan	Fakt	%
Lidhjet e Ujit të Regjistruara			
Familjare	62,918	62,184	98.83
Ente Private	5,685	5,733	100.84
Institucione Buxhetore	607	608	100.16
Lidhje Ujësullësi Aktive			
Familjare	51,163	48,926	95.63
Te Ardhura			
Komponenti Fiks i Tarifës			
Familjare	111,445,200	117,621,730	105.54
Ente Private	25,125,600	21,280,290	84.70
Institucione Buxhetore	2,166,720	1,891,780	87.31
Ujë			
Familjare	288,783,468	251,138,343	86.96
Ente Private	79,768,592	48,752,176	61.12
Institucione Buxhetore	69,906,592	66,636,725	95.32
Kanalizime			

Familjare	38,215,874	34,165,834	89.40
Ente Private	13,133,482	7,911,229	60.24
Institucione Buxhetore	8,888,950	9,288,418	104.49
Te Ardhura Sipas Kategorive te Konsumatorëve			
Familjare	438,444,542	402,925,907	91.90
Ente Private	118,027,674	77,943,695	66.04
InstitucioneBuxhetore	80,962,262	77,816,923	96.12
Te Ardhura nga Sherbimet e tjera	0	5,612,225	
Te ardhura nga subvencioni	0	57,074,917	
Te Ardhura nga Shitja (nga tarifa)	637,434,478	564,298,750	88.53
Norma e Arketimit te Faturave (%/Vit)	73.6%	66.7%	
Arkëtime nga të Ardhurat nga Shitja (viti korent)	469,259,220	376,426,839	80.22
Arkëtime nga të Ardhurat nga Shitja (faturat e prapambetura)	323,584,500	208,808,950	64.53
Arkëtime nga Shërbime të Tjera	15,077,500	41,534,881	275
Arkëtime Total	807,921,220	683,845,587	84.6

- Zëri “arkëtime nga shërbime të tjera” përfshihen arkëtimet e tjera të faturuara 23,980,745 lekë, arkëtim për shërbime të tjera nga shoqëria (të cilat nuk kanë qenë parashikuar) si: lidhje të reja, akt kolaudim, prerje rilidhje etj, vlera e të cilave për 6 njësitë është 8,867,876 lekë, si edhe arkëtimi i shumës si agjent i mbledhjes së Taksës së Bashkive, bazuar në normën e % së secilës njesi (nuk ka qenë parashikuar në buxhet). Për këto arkëtime vlera në total është 8,686,260 lekë, specifikisht për çdo njësi:

Elbasan 8,155,005 lekë

Librazhd 81,096 lekë

Gramsh 112,323 lekë

Belsh 337,836 lekë

1. Lidhjet e ujit, Krahasuar plan/fakt për “lidhje uji familjarë”, nuk është realizuar parashikimi, për arsye se pas bashkimit është verifikuar numri i abonentëve dhe u konstatua se disa njësi kanë deklaruar kontratat e mbyllura në numrin e abonentëve të përlogaritur në parashikimin e vitit 2023.

2. Komponenti i tarifës fikse, Në lidhje me këtë pikë, nuk është realizuar parashikimi i buxhetit 2023 për kategorinë “Ente Private” dhe “Institucione” pasi në vitin 2023 hyn në fuqi ndryshimi (në ulje) i tarifave të miratuara nga Enti Rregullator i Ujit.

3. Norma e arkëtimit, Përsa i përket normës së arkëtimit korent Plan/fakt është realizuar në masën 80.22%. Arkëtimi total nga të ardhurat e shoqërisë (pa përfshirë subvencionin) është realizuar në masën 77.5%. Ndikim në këtë mosrealizim ka dhënë mos arkëtimi i detyrimeve të prapambetura. Shoqëria gjatë vitit 2023 ka marrë masa si lidhje aktmarrëveshje për likuidimin me këste të detyrimeve të prapambetura, prerje të furnizimit me ujë, si edhe dërgimin në përmbarrim për vjelje të detyrueshme të debisë.

-**Në lidhje me prodhimin e ujit**, pas instalimit të matësave të prodhimit në disa prej stacioneve kryesore rezultoi se prodhimi i ujit ishte më i madh se ai që rezultonte me përlogaritje.

	Uji pa të ardhura %	
	000/m ³	
Emërtimi	Plan	Fakt
Prodhim	20,702	26,819
Faturim	8,997	7,414
% uji pa të ardhura	56.5%	72%

Norma e lartë i referohet kryesisht rrjetit të amortizuar pra humbjeve teknike, por një peshë të rëndësishme në humbje zenë edhe lidhjet e paligjshme sidomos në zonat informale ku rrjeti nuk

është i kontrollueshëm. Uji pa të ardhura ka një normë në rritje krahasuar me rezultatet e 6 njësiteve për vitet 2020, 2021 dhe 2022 si edhe me kërkesat e përcaktuara në “Strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitet 2022-2030” ku për vitin 2023 ky tregues parashikohet në nivelin 60%.

Programi i vitit 2023 parashikonte një deficiet prej 268 milion lekë. Referuar shumës së arkëtimeve deficieti është ulur në nivelin 245 milion lekë.

000 leke

Emërtimi	Plan	Fakt
Arketim Total	807,921	683,845
Kosto Direkte	1,075,871	928,938
Deficit	267,949	245,093

Deficiti është më i ulët se parashikimi për arsye të uljes së kostos direkte.

Të ardhurat (faturim) janë parashikuar me rritje 14.7% në raport vitin 2022 - 2023 në nivelin prej 637,4 milion lekë. Fakti i vitit 2023 është 564.3 milion pra 89% e parashikimit në vlerën - 73.1 milion lekë.

Emërtimi	Plan	Fakt
Numer kontratash UK	109,029	113,113
Numer punonjesish	824	778
Punonjes 1000 lidhje UK	7.51	6.87

Konkluzion: Për hartimin e programeve ekonomike nga shoqëria nuk është ngritur grup pune për vlerësimin e rezultateve pozitive dhe negative nga 6 njësitë e UK me qëllim arritjen e objektivave nga organet drejtuese dhe minimizimin e humbjeve, pra mungon analiza ekonomike për rezultatet e arritura.

-Programet e zhvillimit të shoqërisë pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës nuk janë miratuar nga Ministria përgjegjëse për ekonominë. Në hartimin dhe miratimin e programeve ekonomikë të shoqërive nuk janë zbatuar kërkesat e Statutit të shoqërisë miratuar me nr.1962/2, datë 19.09.2022, Nuk është planifikuar zëri “Investime”, si edhe 1% i fondit të pagave për shpenzime trajnim punonjësish dhe 5 % i fondit të veçantë.

Të ardhurat (faturim) janë parashikuar me rritje 14.7% në raport vitin 2022 - 2023 në nivelin prej 637,4 milion lekë. Fakti i vitit 2023 është 564.3 milion pra 89% e parashikimit në vlerën - 73.1 milion lekë.

Në programin ekonomik për vitin 2023, shoqëria ka planifikuar një fond rezervë në shumën 51,232 mijë lekë. Planifikimi i këtij zëri është argumentuar për përdorim të ngjarjeve emergjente, avari, etj. Në fakt nga auditimi konstatohet se për vitin 2023, ky fond është përdorur për shpenzime të cilat shoqëria duhej ti planifikonte me hartimin e programit ekonomik si: për mbulimin e shpenzimeve paga, shpërblime, etj,

Për hartimin dhe ndryshimet në programin ekonomik mungojnë kërkesat për shtesa/pakësime dhe ndryshim destinacioni në blerje, paga, shpërblime, të cilat shoqërohen me informacion nga degët përkatëse.

Kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 68% nga të ardhurat e vitit 2023, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 60%. Pra, shoqëria paraqet një performancë të dobët të aktivitetit të saj.

Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 98 % të planit dhe shpenzimet në masën 100% të planit. Për vitin 2023,

paraqiten me tejkalim shpenzimet për zërin “Taksa dhe tatime” +28%, zëri “Kosto të tjera” +2% nga planifikimi.

Megjithëse të ardhurat janë realizuar në masën 98%, niveli i mbulimit të Kostos është tejet i ulët krahasuar edhe me kërkesat e përcaktuara në “Strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitet 2022-2030” ku për vitin 2023 ky tregues parashikohet në nivelin 90%. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Kreu III, VKM nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 dhe 4 dhe “Strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitet 2022-2030”.

2.3. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

Për zbatimin e strukturës organizative, pagat, proceset e rekrutimit dhe largimit nga puna për punonjësit e 6 shoqërive të Ujësjetllës Kanalizime dhe Shoqërisë Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime Elbasan, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme dhe urdhrat për organizimin dhe funksionimin;
- Statuti i shoqërisë;
- Struktura Organizative e SHRUKË, Njësive dhe numri i punonjësve;
- Planet e nevojave për rekrutim,
- Databaza e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna.
- Listë pagesat për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, etj.

➤ Realizimi i numrit të punonjësve

Për periudhën objekt auditimi numri i punonjësve, struktura dhe pagat për punonjësit e SHRUK Elbasan dhe Njësitë, janë miratuar me vendimet si mëposhtë:

Nr	Njësia	Vendimet e këshillit mbikëqyrës	Numër punonjës
1	Elbasan		
	Viti 2022	nr.398, date 24.12.2021	420
2	Librazhd		
	Viti 2020	nr.19, date 27.12.2019	60
	Viti 2021	nr.15, date 24.12.2020	71
	Viti 2022	nr.24, date 28.12.2021	66
3.	Cërrik		
	Viti 2020	nr.16, date 31.01.2019	64
	Viti 2021	nr.10, date 19.10.2020	76
	Viti 2022	nr.3, date 28.03.2022	97
4.	Belsh		
	Viti 2020	nr.1/3, date 07.01.2020	85
	Viti 2021	nr.1, date 09.01.2021	81
	Viti 2022	nr.2, date 25.01.2022	79
5.	Gramsh		
	Viti 2020	nr.2, date 07.02.2020	50
	Viti 2021	nr.1, date 28.01.2020	50
	Viti 2022	nr.2, date 03.02.2022	50

6.	Peqin		
	Viti 2020	nr.8, date 30.12.2019	91
	Viti 2021	nr.1, date 22.12.2020	95
	Viti 2022	nr.1, date 06.01.2022	95

Sipas tabelës së mësipërme me Vendimet përkatëse janë miratuar për çdo vit numri i punonjësve, struktura dhe pagat për Njësitë e UK për vitet 2020-2022.

Vitet	2020	2021	2022
Numri Punonjësve Plan	685	765	811
Numri Punonjësve Fakt	684	746	806

Sipas tabelës në lidhje me numrin e punonjësve konstatohet se për planifikimin e nevojave për punonjës nuk janë mbajtur në konsideratë treguesit e një viti më parë por çdo vit numri punonjësve është planifikuar me rritje krahasuar me planin dhe faktin e vitit paraardhës, pa shoqëruar me një analizë për nevojat në rritje me burime njerëzore në kushtet kur shoqëritë e UK paraqiten me humbje të theksuara. *Për vitin 2021*, numri i punonjësve është planifikuar 765 persona, ndërsa fakti i vitit 2020 është 684, *për vitin 2022*, numri i punonjësve është planifikuar 811 persona, ndërsa fakti i vitit 2021 është 746 dhe *për vitin 2023*, numri i punonjësve është planifikuar 824 persona, ndërsa fakti i vitit 2022 është 806 punonjës.

Nr	Emërtimi	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
	Punonjës gjithsej	685	684	765	746	811	806
1.	Elbasan	335	334	392	384	420	419
2.	Librazhd	60	60	71	65	66	64
3.	Cërrik	64	65	76	73	97	95
4.	Belsh	85	84	81	79	79	80
5.	Gramsh	50	50	50	50	50	50
6.	Peqin	91	91	95	95	95	94

Referuar tabelës në lidhje me realizimin e numrit të punonjësve, konstatohet se për vitin 2022 realizuar në masën 99%, për vitin 2021 realizuar 97% dhe për vitin 2020 realizuar 99.8%.

Krahasuar numrin e punonjësve të Njësitë UK për vitet 2020-2021, konstatohet se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve nga ai i planifikuar, por numri i punonjësve është planifikuar në rritje.

Planifikimi i nevojave për punonjës nuk është kryer bazuar në strukturën sipas nevojave dhe mundësive financiare të shoqërisë.

Nga viti në vit numri i punonjësve të miratuar ka ardhur në rritje me mesatarisht +40 punonjës dhe për këtë nuk jepen argumente ekonomike për faktorët që kanë ndikuar në rritjen e numrit të punonjësve si edhe nuk është marrë në konsideratë realizimi i një viti më parë.

UK Elbasan në vitin 2021 ka planifikuar numër punonjësish +58 punonjës krahasuar me realizimin e vitit 2021 dhe për vitin 2022 ka planifikuar +36 punonjës krahasuar me realizimin e vitit 2021.

UK Cërrik në vitin 2021 ka planifikuar numër punonjësish +6 punonjës krahasuar me realizimin e vitit 2021 dhe për vitin 2022 ka planifikuar +24 punonjës krahasuar me realizimin e vitit 2021, si edhe për vitin 2020 rezultoi me +1, tejkalim të numrit të punonjësve.

-Në vendimet e Këshillit Mbikëqyrës për miratimin e strukturës dhe organigramës është përcaktuar struktura sipas drejtorive, sektorëve, etj, por nuk është caktuar niveli i arsimit dhe profesioni që duhet të ketë punonjësi sipas vendit të punës.

Nuk ka grupe pune të ngritura nga shoqëria ku ti propozohet Këshillit niveli i pagave dhe pagat për çdo pozicion pune, për elementet që përbëjnë pagën si niveli arsimor, vjetërsia në punë, vështirësia, etj, por pagat janë caktuar apriori dhe janë miratuar në Këshill. Nga sektori financës nuk është mbajtur libri i pagave të punonjësve. Veprimet në lidhje me përcaktimin e pagave janë

në kundërshtim me ligjin nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 109/1 “Paga”, neni 119 “Përlllogaritja e pagës” dhe neni 95 “Regjistri i pagave”.

-Konstatohet se nga njësitë e UK, janë rekrutuar punonjës të rinj mbas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkimin e tyre në Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Elbasan, duke sjellë rritje të numrit të punonjësve shoqëruar me efekt negativ për shoqërinë në shumën **6,756,344 lekë (1,969,273 +4,618,890 +74,181 + 94,000)** si:

-Njësia UK Cërrik, rekrutuar punonjës të rinj pas datës 27.07.2022 kohë në të cilën është nënshkruar Marrëveshja për bashkimin në SHRUKE, janë rekrutuar 21 punonjës nga data 01.09.2022 - 31.12.2022 me efekt financiar **1,969,273 lekë**.

-Njësia UK Elbasan, ka shtuar 47 punonjës për periudhën 10.08.2022 - 13.12.2022 me efekt financiar **4,618,890 lekë**. Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12, datë 20.09.2022, janë shtuar 11 punonjës në pozicione të reja pune dhe 36 punonjës të punësuar me urdhër të drejtorit z. L. K.

-Njësia UK Belsh, janë rekrutuar 4 punonjës të cilët kanë zëvendësuar punonjës që kanë dalë në pension.

-Njësia UK Peqin, janë rekrutuar 2 punonjës nga data 08.11.2022 - 16.12.2022, me efekt financiar në shumën **74,181 lekë**.

-Njësia UK Gramsh, është rekrutuar 1 punonjës E.H në datën 08.11.2022 në pozicionin arkëtar, me efekt financiar në shumën **94,000 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 10 të Marrëveshjes së nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 22.07.2022 me objekt “*Krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve*”, i cili do të kryej veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrative të bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin, subjekt i cili është një shoqëri aksionare dhe është transferuar tërësisht veprimtaria ekonomike e shoqërive ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve të cilat kanë qenë në pronësi të bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin.

Rekrutimet e punonjësve nuk janë kryer sipas procedurës e cila fillon me shpalljen e pozicioneve të lira në faqen e ëeb-it të Shoqërisë, paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për konkurim si edhe dokumentacioni i mbajtur nga grupi i punës për vlerësimin e dokumentacionit dhe kriterëve të punësimit deri në shpalljen e fituesit, etj, nuk janë përcaktuar kriteret dhe hapat e nevojshëm për rekrutimin e punonjësve. Rekrutimi i punonjësve nuk është kryer sipas procedurave të përcaktuara që nga njoftimet, aplikimet, paraqitja e dokumentacionit dhe vlerësimi nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

Mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kriterëve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z.L. K, z.T.B, z. E.T dhe z. N.T.

➤ **Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.**

Për periudhën objekt auditimi, realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për punonjësit e Shoqërive të UK, paraqitet si më poshtë:

				000/lekë	
		Viti 2022		Viti 2023	

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1.	Paga gjithsej	378,687	387,082	102	508,527	479,858	94%
2.	Sig. shoqërore	68,324	64,433	94	65,513	79,572	121
3.	Paga DR	1,610	1,447	90	117,577	108,476	92
4.	Sig shoq.	168	219	130	1,460	18,091	1239
5.	Paga rajonale Elbasan	213,170	215,361	101	204,222	197,026	96
6.	Sig shoq	35,981	36,007	100	33,996	32,614	96
7.	Paga rajonale Librazhd	32,000	31,342	98	22,958	20,714	90
8.	Sig shoq	5,340	5,154	97	3,440	3,439	100
9.	Paga rajonale Cërrik	29,368	39,001	133	46,706	45,552	98
10.	Sig shoq	9,800	6,380	65	7,571	7,570	100
11.	Paga rajonale Belsh	34,607	33,188	96	39,061	37,539	96
12.	Sig shoq	5,779	5,542	96	6,308	6,232	99
13.	Paga rajonale Gramsh	26,980	26,467	98	31,363	24,606	78
14.	Sig shoq	4,417	4,401	100	5,137	4,077	79
15.	Paga rajonale Peqin	40,952	40,276	98	46,640	45,945	99
16.	Sig shoq	6,839	6,730	98	7,601	7,549	99

-Shpenzimet për “paga & sigurime shoqërore” për vitin 2022 janë realizuar në shumën 451,515 mijë lekë, nga 447,011 mijë të planifikuara, ose realizuar në masën 101%, +1% nga planifikimi.

-Shpenzimet për “paga & sigurime shoqërore” për vitin 2023 janë realizuar në shumën 559,430 mijë lekë, nga 574,040 mijë të planifikuara, ose realizuar në masën 97.4%.

Referuar tabelës në lidhje me realizimin e fondit të pagave për vitin 2023 realizimi paraqitet në masën 94 %, ndërsa për vitin 2022 realizimi paraqitet në masën 102 %, ku ka dhënë ndikim rekrutimi i punonjësve të rinj nga njësitë në periudhën gusht-Dhjetor të vitit 2022.

Tejkalim i fondit të pagave për vitin 2022, paraqitet nga njësitë Cërrik në masën 133%, ose +33% nga planifikimi dhe Njësia UK Elbasan në masën 101%.

Planifikimi i treguesve të punës nuk është bazuar në numrin e punonjësve të planifikuar, fondin e pagave, duke sjellë tejkalim të shpenzimeve nga planifikimi. *Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. E.T, me detyrë Administrator.*

Për periudhën objekt auditimi, realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për punonjësit e Shoqërive të UK, paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Nr	Artikulli	Viti 2020			%	Viti 2021		
		Plan	Fakt			Plan	Fakt	%
1.	Paga gjithsej	306,032	303,768	99	328,004	353,558	108	
2.	Sig. shoqërore	56,993	50,229	88	57,780	58,983	102	
3.	Paga rajonale Elbasan	164,036	158,293	96	177,792	192,381	108	
4.	Sig shoq	27,394	26,307	96	29,691	32,152	108	
5.	Paga rajonale Librazhd	30,000	28,057	94	29,000	28,909	100	
6.	Sig shoq	7,849	4,616	59	4,800	4,753	99	
7.	Paga rajonale Cërrik	22,472	29,780	133	22,472	37,411	166	
8.	Sig shoq	6,800	4,667	69	6,800	6,248	92	
9.	Paga rajonale Belsh	33,232	31,947	96	35,142	31,750	90	
10.	Sig shoq	5,550	5,335	96	5,869	5,302	90	
11.	Paga rajonale Gramsh	23,320	22,680	97	25,680	25,089	98	
12.	Sig shoq	3,894	3,789	97	4,288	4,184	98	
13.	Paga rajonale Peqin	32,972	33,011	100	37,918	38,018	100	
14.	Sig shoq	5,506	5,515	100	6,332	6,344	100	

-Shpenzimet për “paga & sigurime shoqërore” për vitin 2020 janë realizuar në shumën 353,997 mijë lekë, nga 363,025 mijë të planifikuara, ose realizuar në masën 97.5%.

-Shpenzimet për “paga & sigurime shoqërore” për vitin 2021 janë realizuar në shumën 412,541 mijë lekë, nga 385,784 mijë të planifikuara, ose realizuar në masën 107%, +7% nga planifikimi. Referuar tabelës në lidhje me realizimin e fondit të pagave për vitin 2021, realizimi paraqitet në masën 108 %, ose +8% nga planifikimi, ndërsa për vitin 2020 realizimi paraqitet në masën 99 %. Tejkallim i fondit të pagave për vitin 2021, paraqitet UK Elbasan në masën 108%, ose +8% nga planifikimi dhe UK Cërrik në masën 166%, ose +66% nga fondi i planifikuar i pagave.

Po kështu me tejkallim paraqiten pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të Njësisë UK, Elbasan për vitin 2021 në masën 102%, ose +2% nga planifikimi.

Planifikimi i treguesve të punës nuk është bazuar në numrin e punonjësve, fondin e pagave, etj, duke sjellë tejkallim të shpenzimeve nga planifikimi. *Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. E.T, me detyrë Administrator UK Cërrik, dhe z.L.K-ish Administrator i UK Elbasan.*

-Janë audituar me zgjedhje listë pagesat e punonjësve për periudhën Prill-Qershor 2022, nga ku rezulton se llogaritja e pagave dhe kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është kryer referuar legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të drejtorisë dhe Këshillit Drejtues për caktimin e pagave. Listë pagesat janë hartuar bazuar në listë prezencat mujore të hartuara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe drejtoritë përkatëse.

-Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave konstatohet se ka mospërputhje të datës së emërimit me datën e paraqitur në listë prezencën nga drejtoria përkatëse, si psh. në sektorin e taskë forcës në listë prezencën e UK Elbasan për muajin Maj dhe Qershor të vitit 2022, evdientohet se punonjësi E.H është shtuar në listë prezencën e 2 muajve me shkrim dore dhe jo nga shefi i taskë forcës, i cili ka paraqitur prezencën mujore për 7 punonjës. Referuar urdhrin nr.120, date 18.05.2022 ky punonjës transferohet nga specialist bilanci dhe fillon marrëdhëniet financiare në sektorin e task forcës më 19.05.2022, ndërkohë listë prezencë ka filluar nga data 01.05.2022 (Nuk ka shënim në lidhje me fillimin e marrëdhënieve financiare).

-Referuar *urdhrit nr. extra, datë 09.05.2022*, të Administratorit z. L.K, “Për emërim në detyrë” është emëruar znj.G.Ç në detyrën “Përgjegjëse Auditit” deri në kthimin nga leje lindje të z. E. D me pagë 60,000 lekë. Marrëdhëniet financiare fillojnë më 10.05.2022(Konceptoi H.K)

Urdhër nr.180, datë 16.08.2022, i Administratorit L.K, (Konceptoi P.A) znj. G.C ka kaluar nga përgjegjës auditit - përgjegjës në Sektorin e Taskë Forcës. Ky vendim është marrë në studim të performancës në punë.

Urdhër nr.188, datë 07.09.2022, i Administratorit L.K, (Konc. P. A) znj. G.C ka kaluar nga përgjegjës në Sektorin e Taskë Forcës në specialist në sektorin e task forces me page 45,000 lekë. Ky vendim është marrë në studim të performances në punë.

Urdhër nr.223, datë 03.10.2022, i Administratorit L.K, znj. G.C ka kaluar nga specialist në sektorin e task forcës në përgjegjëse financës me pagë 67,000 lekë. Ky vendim është marrë në studim të performancës në punë.

Urdhër nr. s'ka, datë 01.11.2022, i administratorit z. Ç.L, për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare si pasoje e dorëheqjes.

Nga auditimi konstatohet se për znj. G.Ç Drejtoria e personelit nuk disponon dosjen personale të plotësuar me dokumentacionin për punësim. Në listë prezencën e muajit Maj, Qershor dhe Gusht, emri i saj është shtuar me shkrim dore 2 muaj në pozicionin “Përgj sektori auditit”, muaji gusht në pozicionin “jurist” në drejtorinë juridike. Në të dy drejtoritë nga Drejtueset përkatëse konfirmohet se nuk është pjesë e listë prezencës së drejtorisë ku është shtuar emri i kësaj punonjëse, nuk është

shtuar prej tyre si edhe nuk e njohim këtë punonjëse as si fytyrë nuk ka ardhur në punë. Referuar CV të paraqitur zj.G. C ka kryer studimet Bachelor në Universitetin e New York në vitet 2018-2022 Dega Menaxhim Biznesi, nga ku koha e përfundimit të studimeve nuk justifikon përcaktimin nga drejtoria e Personelit se: Ky vendim është marrë në studim të performancës në punë.

Muaji Maj (10-31) zj. G.C është punonjëse në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, emri i saj është shtuar me shkrim dore dhe pa dijeninë e Drejtorit të Auditit zj. E.B.

Muaji Qershor (1-30) zj. G. C është punonjëse në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, emri i saj është shtuar me shkrim dore dhe pa dijeninë e Drejtorit të Auditit zj. E.B.

Muaji Korrik paguar në Drejtorinë e Auditit si përgjegjëse auditit, ne listë prezencën e drejtorive përkatëse mungon emri i zj. G.Ç.

Listë prezencë e muajit Gusht (1-31) zj. G.Ç është punonjëse në Drejtorinë Juridike, emri i saj është shtuar me shkrim dore dhe pa dijeninë e Drejtorit juridik zj.I. S, njëkohësisht është edhe në listë prezencën e Taskë forcës.

Muaji Shtator (1-30) në listë prezencën e task forcës.

Muaji Tetor (1-31) në degën e Financës por pa u evidentuar në listë prezencë.

Në deklaratën e datës 09.05.2022, si punonjëse e marrë rishtaz në punë si edhe në deklaratën e të larguarve nga puna zj. G.Ç është klasifikuar “Nëpunës i lartë në Administratën Shtetërore” ndërsa është specialist në UK Elbasan.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, pika 2/b, c. “Punësimi i Audituesit të brendshëm”, VKM nr.514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve”, grupi 11,12 dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 69,70.

Për sa më lart ngarkohet me përgjegjësi z. L.K-ish Administrator i UK Elbasan, zj. P.A, ish drejtoreshë e Burimeve Njerëzore dhe z. Sh.L, ish përgjegjës i financës.

➤ ***Mbi organizimin dhe mbajtjen e dosjeve të personelit.***

Nga auditimi i ushtruar në 40 dosje personeli të SHRUKE për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin ligjor, konstatohet se: Dosjet e personelit nuk janë të plotësuara me dokumentet ligjore si kërkesa për punësim, certifikata, vërtetime nga prokuroria, gjykata, librezën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; raport mjekësor për aftësimin në punë; Fletë pune të lëshuar nga Zyra e Punës; etj dokumente të nevojshme sipas kërkesave të pozicionit të punës. Po kështu u konstatua se dosjet e personelit nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin dhe renditjen e dokumentacionit, mungon inventari i dosjes si edhe mënyra e mbajtjes së tyre pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk plotëson kriteret e mbajtjes së dokumenteve shtetërore. Nuk janë kërkuar për tu paraqitur dokumentet si: librezë e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; Raport mjekësor për aftësimin në punë; Fletë pune të lëshuar nga Zyra e Punës dhe dokumente të tjerë sipas specifikës së vendit të punës.

➤ ***Mbi zbatimin e Strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.***

Shoqëria Rajonale e Ujësjetës Kanalizimeve Elbasan (SHRUKE) është krijuar bazuar në VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për organizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” dhe Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetës Kanalizimeve Elbasan SHA, datë 15.07.2022, lidhur ndërmjet MIE dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin. Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M.....V, datë

22.09.2022. Shoqëria kryen aktivitetin në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Rregullores së Brendshme dhe Statutit.

Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Shoqërisë Rajonale UKE, është miratuar me vendimin nr.7, datë 06.12.2023, të Këshillit Mbikëqyrës.

Rregullorja e funksionimit të shoqërisë është miratuar 14 muaj më vonë nga data e krijimit të saj. Në këtë rregullore janë përcaktuar detyrat e çdo pozicioni pune.

Statuti i UKE është miratuar nga Asambleja në datën 19.09.2022, ku janë përcaktuar objekti, kapitali, organet drejtuese të shoqërisë, kompetencat e Asamblesë, Këshillit Mbikëqyrës, drejtuesve të shoqërisë, etj.

➤ **Mbi zbatimin e strukturës organizative**

Struktura e shoqërisë është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.3, datë 09.12.2022 -Nga auditimi në lidhje me zbatimin e Strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për periudhën 01.09.2022-31.12.2023, knstatohet se: Me Vendimin Këshillit Drejtues nr.3, datë 09.12.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së SHRUKË, si dhe miratimin e strukturës së pagave”, numri total i punonjësve është parashikuar **818 punonjës**, si edhe me vendimin nr.4, datë 07.04.2023 për miratimin e **shtesës me 6 punonjës** duke shtuar 1 punonjës në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm për Shërbimin e Auditit të Brendshëm, pra në total **824 punonjës**.

Përveç punonjësve në strukturë janë edhe **24 punonjës me kontratë** për kryerjen e shërbimeve të ndryshme, si: Manovrues, klorinues elektropmpist dhe faturues, nga të cilët 21 punonjës me kontrata individuale janë punësuar në Njësinë e UK Gramsh, 2 punonjës në Njësinë e UK Peqin dhe 1 punonjës IT në Elbasan.

Struktura e SHRUKË përbëhet nga:

Nr.	Emërtimi	Numër punonjës 2023
1.	Administrator	1
2.	Kabineti	6
3.	<i>Statistikë analizë,</i>	2
4.	<i>Sekretare,</i>	2
5.	<i>shef kabineti,</i>	1
6.	<i>sektori komunikim media</i>	1
7.	Drejtoria e Task Forcës	20
8.	<i>Njësia Gramsh</i>	2
9.	<i>Njësia Peqin</i>	2
10.	<i>Njësia Cerrik</i>	1
11.	<i>Njësia Librazhd</i>	1
12.	<i>Njësia Elbasan</i>	14
13.	Departamenti Teknik	29
14.	<i>Drejtori Teknik</i>	1
15.	<i>Drejtoria Projektimit</i>	7
16.	<i>Sektori Monitorimit të cilësisë ujit</i>	6
17.	<i>Drejtoria Ujësjellës</i>	9
18.	<i>Drejtoria kanalizime</i>	6
19.	Departamenti Tregtar	39
20.	<i>Drejtor tregtar</i>	1
21.	<i>Drejtoria e shitjes</i>	21
22.	<i>Drejtoria Ekonomike</i>	17
23.	Departamenti Shërbimeve mbështetëse	49

24.	Drejtor	1
25.	Drejtoria e Logjistikës	24
26.	Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore	18
27.	Spektori Shërbimeve Mbështetëse	6
28.	Drejtoria e Auditit	6
29.	Njësia Elbasan	356
30.	Njësia Peqin	84
31.	Njësia Cerrik	77
32.	Njësia Belsh	68
33.	Njësia Gramsh	53
34.	Njësia Librazhd	36
	Total	824

Shoqëria është e organizuar me 6 Njësi, 3 Departamente, 9 drejtori dhe 26 sektorë.

➤ **Realizimi i numrit të punonjësve**

-Për vitin 2023, Struktura e SHRUKE është miratuar me vendimet Nr.3, datë 09.12.2022 dhe Nr.4, datë 07.04.2023

Vitet	2020	2021	2022	2023
Numri Punonjësve Plan	685	765	811	824
Numri Punonjësve Fakt	684	746	806	778

Sipas tabelës në lidhje me numrin e punonjësve konstatohet se për planifikimin e nevojave për punonjës nuk janë mbajtur në konsideratë treguesit e një viti më parë por çdo vit numri punonjësve është planifikuar me rritje krahasuar me planin dhe faktin e vitit paraardhës, pa u shoqëruar me një analizë për nevojat në rritje me burime njerëzore në kushtet kur shoqëritë e UK paraqiten me humbje të theksuara. *Për vitin 2021*, numri i punonjësve është planifikuar 765 persona, ndërsa fakti i vitit 2020 është 684, *për vitin 2022*, numri i punonjësve është planifikuar 811 persona, ndërsa fakti i vitit 2021 është 746 dhe *për vitin 2023*, numri i punonjësve është planifikuar 824 persona, ndërsa fakti i vitit 2022 është 806 punonjës.

Nr	Emërtimi	Viti 2020		Viti 2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt
	Punonjës gjithsej	685	684	765	746
1.	Elbasan	335	334	392	384
2.	Librazhd	60	60	71	65
3.	Cerrik	64	65	76	73
4.	Belsh	85	84	81	79
5.	Gramsh	50	50	50	50
6.	Peqin	91	91	95	95

Nr	Emërtimi	Viti 2022		Viti 2023	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt
	Punonjës gjithsej	811	806	824	778
1.	Punonjës në organikë DR	4	4	150	138
	Njësitë	807	802	674	640
2.	Elbasan	420	419	356	335
3.	Librazhd	66	64	36	36
4.	Cerrik	97	95	77	77
5.	Belsh	79	80	68	66

6.	Gramsh	50	50	53	44
7.	Peqin	95	94	84	82

Referuar tabelës në lidhje me realizimin e numrit të punonjësve, konstatohet se për vitin 2023, realizimi është në masën 94.4%, ose 46 punonjës më pak nga numri i planifikuar.

Per vitin 2022 realizuar në masën 99%, për vitin 2021 realizuar 97% dhe për vitin 2020 realizuar 99.8%

Krahasuar numrin e punonjësve të Njësive UK për vitet 2020-2021, konstatohet se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve nga ai i planifikuar, por numri i punonjësve është planifikuar në rritje.

Po kështu numri i punonjësve për vitin 2023 është planifikuar më i lartë se numri i punonjësve të realizuar në vitin 2022 të 6 njësive së bashku, ose +18 punonjës.

Planifikimi i nevojave për punonjës nuk është kryer bazuar në strukturën sipas nevojave dhe mundësive financiare të shoqërisë.

Megjithëse për vitin 2023 realizimi i numrit të punonjësve paraqitet në nivelin 94.4% numri i punonjësve është rritur krahasuar me numrin e punonjësve në vitin 2022.

Nga SHRUKË për vitin 2023 nuk janë marrë masa për shkurtimin e vendeve të punës si rrjedhojë e uljes së volumit të punës pasi veprimet financiare, kryerja e procedurave të prokurimit, burimet njerëzore, veprimet juridike, impelmentimi i sistemeve të arkëtimit, etj, kryhen nga punonjësit e SHRUKË dhe në këto kushte struktura në njësitë e UK duhej të minimizohej.

Nga viti në vit numri i punonjësve të miratuar ka ardhur në rritje me mesatarisht +24 punonjës dhe për këtë nuk jepen argumente ekonomike për faktorët që kanë ndikuar në rritjen e numrit të punonjësve si edhe nuk është marrë në konsideratë realizimi i një viti më parë.

Po kështu edhe planifikimi për numrin e punonjësve për vitin 2023, është i paargumentuar pasi është rritur edhe me 18 punonjës të tjerë krahasuar me realizimin e vitit 2022.

-Në vendimet e Këshillit Mbikëqyrës për miratimin e strukturës dhe organigramës është përcaktuar struktura sipas departamenteve, drejtorive, sektorëve, etj, por nuk është caktuar niveli i arsimimit dhe profesioni që duhet të ketë punonjësi sipas vendit të punës.

Nuk ka grupe pune të ngritura nga shoqëria ku ti propozohet Këshillit niveli i pagave dhe pagat për çdo pozicion pune, për elementet që përbëjnë pagën si niveli arsimor, vjetërsia në punë, vështirësia, etj, por pagat janë caktuar apriori dhe janë miratuar në Këshill.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 21 “Forma e kontratës së punës” (Elementët përbërës të pagës), neni 109/1 “Paga”, neni 119 “Përlllogaritja e pagës”, ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” neni 6, ligjin nr.35/2023 datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” neni 10/1 germa “a”, “b dhe pika 2”, “Kompetencat e organeve kolegjiale” dhe ngarkojnë me përgjegjësi z. Luan Tabaku, me detyrë Administrator i shoqërisë zj. A. L, zj. A.J, zj. E. B, z. A. Q., z.E.H (Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës) dhe zj.I. S me detyrë drejtor Juridik dhe Burimeve Njerëzore.

Megjithëse është rritur numri i shërbimeve, konstatohet rritje e numrit të punonjësve si në përbërje të Kabinetit ashtu edhe në Njësi, Drejtori dhe Sektorë.

-Për periudhën objekt auditimi, janë kryer lëvizje të personelit si rekrutime të reja ashtu edhe largime.

Emërtimi	Punësime	Largime	Procese Gjyqësore
SHRUKË	41	48	-

Librazhd	22	8	2
Gramsh	17	17	-
Belsh	23	29	2
Peqin	42	36	-
Cerrik	113	102	3
Elbasan	98	45	6
Totali	556	285	13

Rekrutimet e punonjësve nuk janë kryer sipas procedurës e cila fillon me shpalljen e pozicioneve të lira në faqen e ëeb-it të Shoqërisë, paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për konkurim si edhe dokumentacioni i mbajtur nga grupi i punës për vlerësimin e dokumentacionit dhe kriterëve të punësimit deri në shpalljen e fituesit, etj. Nga SHRUKË, nuk janë përcaktuar kriteret dhe hapat e nevojshëm për rekrutimin e punonjësve. Rekrutimi i punonjësve nuk është kryer sipas procedurave të përcaktuara që nga njoftimet, aplikimet, paraqitja e dokumentacionit dhe vlerësimi nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

Shoqëria sipas nevojave vjetore për punonjës të rinj, ka publikuar në vende të dukshme (arkat e pagesave të ujit) njoftimet për vende të lira pune, ku është përshkruar pozicioni i punës dhe dokumentet që duhen paraqitur duke u finalizuar me nënshkrimin e kontratës së punës.

Mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Evidentohet mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Elbasan, si edhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. dhe ngarkojnë me përgjegjësi z. *L.T, me detyrë Administrator i shoqërisë dhe zj. I.S me detyrë drejtor Juridik dhe Burimeve Njerëzore.*

➤ ***Mbi emërimin dhe pagesat e likuidatorëve të njërive të UK.***

Bazuar në Marrëveshjen e nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 22.07.2022 me objekt “Krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve” i cili do të kryej veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrative të bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cerrik, Belsh dhe Peqin, subjekt i cili është një shoqëri aksionare dhe është transferuar tërësisht veprimtaria ekonomike e shoqërive ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve të cilat kanë qenë në pronësi të bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cerrik, Belsh dhe Peqin.

Në këtë Marrëveshje janë përcaktuar procedurat që duhen ndjekur për transferimin e njërive, por nga auditimi konstatohet se:

1. Me vendimin nr.2, datë 27.04.2023, të Asamblesë së Përgjithshme të UK Peqin, është emëruar zj. M. A me detyrën likuidator i shoqërisë, aktualisht specialiste në Sektorin e Aseteve Tregtare, (Nënshkruar nga L.T).
2. Me vendimin nr.46, datë 03.05.2023, të Asamblesë së Përgjithshme të UK Belsh, është emëruar z. G.H me detyrën likuidator i shoqërisë, aktualisht specialist në sektorin task - forcës, (Nënshkruar nga A.T).
3. Me vendimin nr.8, datë 11.05.2023, të Asamblesë së Përgjithshme të UK Cerrik, është emëruar zj. I.Z me detyrën likuidator i shoqërisë, aktualisht specialist në menaxhimin e kontratave të departamentit tregtar (Nënshkruar nga A.S).

4. Me vendimin nr.3, datë 29.05.2023, të Asamblesë së Përgjithshme të UK Librazhd, është emëruar z. E. A me detyrën likuidator i shoqërisë, larguar ish specialist Task forcës Librazhd, (Nënshkruar nga K. G dhe N.B).

5. Me vendimin nr.2, datë 08.06.2023, të Asamblesë së Përgjithshme të UK Gramsh, është emëruar zj. M. B. me detyrën likuidator i shoqërisë, aktualisht Specialiste në sektorin Teknik Gramsh (Nënshkruar nga B.A)

6. Me vendimin nr.1145, datë 18.04.2023, të Asamblesë së Përgjithshme të UK Elbasan, është emëruar z. G.T me detyrën likuidator i shoqërisë, aktualisht specialist sektorin Teknik Elbasan (Nënshkruar nga G.LI).

Referuar listë pagesave konstatohet se personat të cilët janë caktuar me detyrën e likuidatorit kanë qenë punonjës të njësive dhe janë punonjës në strukturën e SHRUKË.

Për periudhën 8 mujore nga SHRUKË është paguar për likuidatorët e njësive shuma **3,606,215 lekë**.

Nga auditimi konstatohet se Likuidatorët nuk kanë kryer asnjë funksion në lidhje me transferimin e njësive si edhe veprimet që duhej të ndiqnin në zyrat e Drejtorive tatimore dhe QKB për çregjistrimin e aktivitetit të njësive.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, neni 216 “Bashkimi me përthithje i shoqërive”, neni 217 “Raporti i ekspertëve”, neni 197 “Të drejtat dhe detyrimet e likuiduesit”, neni 198 “Bilancet” , neni 202 “Përfundimi i likuidimit” si edhe Marrëveshjen e nënshkruar në datën 27.07.2023, neni 3 “Forma dhe emri i subjektit të kompetencave të përbashkëta” neni 6 “Kontributi i palëve” neni 7 “Procedurat e transferimit”.

➤ **Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.**

Për periudhën objekt auditimi, realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për punonjësit e SHRUKË dhe Njësive të UK, paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Nr	Artikulli	Viti 2022		%	Viti 2023		%
		Plan	Fakt		Plan	Fakt	
1.	Paga gjithsej	378,687	387,082	102	508,527	479,858	94%
2.	Sig. shoqërore	68,324	64,433	94	65,513	79,572	121
3.	Paga DR	1,610	1,447	90	117,577	108,476	92
4.	Sig shoq.	168	219	130	1,460	18,091	1239
5.	Paga rajonale Elbasan	213,170	215,361	101	204,222	197,026	96
6.	Sig shoq	35,981	36,007	100	33,996	32,614	96
7.	Paga rajonale Librazhd	32,000	31,342	98	22,958	20,714	90
8.	Sig shoq	5,340	5,154	97	3,440	3,439	100
9.	Paga rajonale Cerrik	29,368	39,001	133	46,706	45,552	98
10.	Sig shoq	9,800	6,380	65	7,571	7,570	100
11.	Paga rajonale Belsh	34,607	33,188	96	39,061	37,539	96
12.	Sig shoq	5,779	5,542	96	6,308	6,232	99
13.	Paga rajonale Gramsh	26,980	26,467	98	31,363	24,606	78
14.	Sig shoq	4,417	4,401	100	5,137	4,077	79
15.	Paga rajonale Peqin	40,952	40,276	98	46,640	45,945	99
16.	Sig shoq	6,839	6,730	98	7,601	7,549	99

-Shpenzimet për “paga & sigurime shoqërore” për vitin 2022 janë realizuar në shumën 451,515 mijë lekë, nga 447,011 mijë të planifikuara, ose realizuar në masën 101%, +1% nga planifikimi.

-Shpenzimet për “paga & sigurime shoqërore” për vitin 2023 janë realizuar në shumën 559,430 mijë lekë, nga 574,040 mijë të planifikuara, ose realizuar në masën 97.4%.

Referuar tabelës në lidhje me realizimin e fondit të pagave për vitin 2023 realizimi paraqitet në masën 94 %, ndërsa për vitin 2022 realizimi paraqitet në masën 102 %, ku ka dhënë ndikim rekrutimi i punonjësve të rinj nga njësitë në periudhën gusht-Dhjetor të vitit 2022.

Tejkalim i fondit të pagave për vitin 2022, paraqitet nga njësitë Cërrik në masën 133%, ose +33% nga planifikimi dhe Njësia UK Elbasan në masën 101%.

Po kështu me tejkalim paraqiten pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të SHRUK, Elbasan për vitin 2022 në masën 130%, ose +30% nga planifikimi.

Për vitin 2023, paraqiten me tejkalim kontributet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve në masën 121%, ose +21% nga fondi i planifikuar, si edhe pagesat e kontributeve nga SHRUK, Elbasan janë realizuar në masën 1239%, ose 12 herë më larta nga planifikimi. Planifikimi i treguesve të punës nuk është bazuar në numrin e punonjësve, fondin e pagave, etj, duke sjellë tejkalim të shpenzimeve nga planifikimi.

Për periudhën objekt auditimi, realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për punonjësit e Njësive të UK Elbasan, paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Nr	Artikulli	Viti 2020		%	Viti 2021		%
		Plan	Fakt		Plan	Fakt	
1.	Paga gjithsej	306,032	303,768	99	328,004	353,558	108
2.	Sig. shoqërore	56,993	50,229	88	57,780	58,983	102
3.	Paga rajonale Elbasan	164,036	158,293	96	177,792	192,381	108
4.	Sig shoq	27,394	26,307	96	29,691	32,152	108
5.	Paga rajonale Librazhd	30,000	28,057	94	29,000	28,909	100
6.	Sig shoq	7,849	4,616	59	4,800	4,753	99
7.	Paga rajonale Cërrik	22,472	29,780	133	22,472	37,411	166
8.	Sig shoq	6,800	4,667	69	6,800	6,248	92
9.	Paga rajonale Belsh	33,232	31,947	96	35,142	31,750	90
10.	Sig shoq	5,550	5,335	96	5,869	5,302	90
11.	Paga rajonale Gramsh	23,320	22,680	97	25,680	25,089	98
12.	Sig shoq	3,894	3,789	97	4,288	4,184	98
13.	Paga rajonale Peqin	32,972	33,011	100	37,918	38,018	100
14.	Sig shoq	5,506	5,515	100	6,332	6,344	100

-Shpenzimet për “paga & sigurime shoqërore” për vitin 2020 janë realizuar në shumën 353,997mijë lekë, nga 363,025 mijë të planifikuara, ose realizuar në masën 97.5%.

-Shpenzimet për “paga & sigurime shoqërore” për vitin 2021 janë realizuar në shumën 412,541 mijë lekë, nga 385,784 mijë të planifikuara, ose realizuar në masën 107%, +7% nga planifikimi.

Referuar tabelës në lidhje me realizimin e fondit të pagave për vitin 2021, realizimi paraqitet në masën 108 %, ose +8% nga planifikimi, ndërsa për vitin 2020 realizimi paraqitet në masën 99 %.

Tejkalim i fondit të pagave për vitin 2021, paraqitet nga Njësia UK Elbasan në masën 108%, ose +8% nga planifikimi dhe Njësia Cërrik në masën 166%, ose +66% nga fondi i planifikuar i pagave.

Po kështu me tejkalim paraqiten pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të Njësive UK, Elbasan për vitin 2021 në masën 102%, ose +2% nga planifikimi.

-Janë audituar me zgjedhje listë pagesat e punonjësve për periudhën Janar-mars 2023 dhe Tetor-Dhjetor 2023, nga ku rezulton se llogaritja e pagave dhe kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është kryer referuar legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të drejtorisë dhe Këshillit Drejtues për caktimin e pagave. Listë pagesat janë hartuar bazuar në listë prezencat mujore të

hartuara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe drejtoritë përkatëse. Nga dega e financës nuk është mbajtur regjistri i pagave në kundërshtim me ligjin nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 95 “Regjistri i pagave”.

Konstatohen diferencime në nivelin e pagave ku për të njëjtën emërtesë dhe pozicion pune janë caktuar paga të ndryshme, si:

- Pozicioni i punës “Përgjegjës jurist” me pagë 80,000 lekë/muaj dhe 60,000 lekë/muaj
- Pozicioni i punës “shofer me mjete të rënda” me pagë 40,000 lekë/muaj, 33,000lekë/muaj dhe 32,000 lekë/muaj
- Pozicioni i punës “Punëtorë” për 19 punonjës me page 32,000 lekë/muaj dhe 1 punonjës me pagë 24,000 lekë/muaj nën nivelin e pagës minimale në RSH.
- Pozicioni i punës “Specialist taskë force” me pagë 61,200lekë/muaj dhe 47,250 lekë/muaj
- Pozicioni i punës “Përgjegjës sektori juridik” me pagë 75,000 lekë/muaj
- Pozicioni i punës “Specialist prokurimesh” me pagë 75,000 lekë/muaj
- Pozicioni i punës “Elektropompist” me pagë 40,000 lekë/muaj dhe 42,000 lekë/muaj.
- Pozicioni i punës “Punëtorë” me pagë 40,000 lekë/muaj dhe 42, 000 lekë/muaj.
- Pozicioni i punës “Kordinatorë energjie” me pagë 65,000 lekë/muaj dhe 80,000 lekë/muaj
- Pozicioni i punës “Drejtor auditi” është miratuar në vlerën 120,000 lekë, ndërsa paga e specialistëve është miratuar 49,350 lekë diferencë në nivelin e pagave.

Në përcaktimin e nivelit të pagave ka diferencime pa u bazuar në legjislacionin në fuqi. Përcaktime të pagave jo sipas vërshtirësisë, ngarkesës dhe rëndësisë në vendin e punës si edhe diferenca midis pozicionit Drejtor dhe specialist. Diferencime në përcaktimin e nivelit të pagave për punë dhe vend pune të njëjtë, ku për pozicione të njëjta ka nivele të ndryshme page duke treguar sjellje preferenciale për njërin apo tjetrin punonjës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kodin e Punës, Neni 115, “Barazia në shpërblim” (*ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015*) dhe ngarkojnë me përgjegjësi z. L.T, me detyrë Administrator i shoqërisë zj. A.L, zj. A.J, zj. E.B, zj. A.Q, z. E.H (*Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës*) dhe zj.I.S me detyrë drejtor Juridik dhe Burimeve Njerëzore.

➤ **Proceset Gjyqësore.**

Për periudhën objekt auditimi u konstatua se kanë hapur procese gjyqësore 12 persona të cilët kanë qenë punonjës në UKE dhe njësi të ndryshme. Nga 13 procese gjyqësore me objekt “*Largim nga puna pa shkaqe të justifikuar*” janë kryer pagesat, si mëposhtë:

- Pagesa pjesore bazuar në vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr.1015, datë 23.12.2022 dhe vendimit nr.02-23, datë 02.05.2023, të përmbaruesit Gjyqësor, për punonjësen N. H në shumën 1,336,977 lekë, dhe vazhdon faza e Apelimit.

- Pagesa nga BKT date 26.03.2021, bazuar në vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr.410, datë 31.03.2015, për punonjësin N.H në shumën 111,400 lekë.

-Pagesa nga Raifeissen bank datë 18.06.2020, bazuar në vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr.87, datë 17.02.2020, për punonjësin N.Gj në shumën 361,300 lekë.

-Pagesa nga Raifeissen bank datë 18.06.2020, bazuar në vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr.87, datë 17.02.2020, për punonjësin N.Gj në shumën 361,300 lekë.

Detyrimi i paguar për periudhën objekt auditimi është **2,325,557 lekë**. Detyrimi i paguar, ndarë në vlerë detyrimi dhe tarifë përmbarimore (pjesore), për gjithë periudhën objekt auditimi, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Viti	Përshkrimi	Pagesë vendimi	Pagesë përmbarimi	TOTALI
2021	N.H	1,254,200	82,777	1,336,977
2022	J.D	Proces		
	A.K	Proces		
	Q.A	Proces		
	F.H	Proces		
	S.P	Proces		
2020	A.H	Proces		
2021	N.H	111,400		114,400
2020	N.Gj	325,300	36,000	361,300
	E.H	Proces		
	A.L	Proces		
2020	H.K	479,880	36,000	515,880
	A.Xh	Proces		
	TOTALI	2,170,780	154,777	2,325,557

Burimi: Drejtoria Juridike dhe Financës

Për 9 punonjësit e tjerë vazhdojnë proceset gjyqësore dhe nuk janë kryer pagesa nga SHRUKË. Nëse ekzekutimi i vendimit gjyqësor do të ishte kryer me ekzekutim vullnetar do të minimizoheshin kostot në buxhetin e SHRUKË.

➤ **Mbi organizimin dhe mbajtjen e dosjeve të personelit.**

Nga auditimi i ushtruar në 40 dosje personeli të SHRUKË për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin ligjor, konstatohet se: Dosjet e personelit nuk janë të plotësuara me dokumentet ligjore si kërkesa për punësim, çertifikata, vërtetime nga prokuroria, gjykata, librezën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; raport mjekësor për aftësimin në punë; Fletë pune të lëshuar nga Zyra e Punës; etj dokumente të nevojshme sipas kërkesave të pozicionit të punës. Po kështu u konstatua se dosjet e personelit nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin dhe renditjen e dokumentacionit, mungon inventari i dosjes si edhe mënyra e mbajtjes së tyre pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk plotëson kriteret e mbajtjes së dokumenteve shtetërore.

Nuk janë kërkuar për tu paraqitur dokumentet si: librezat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; Raport mjekësor për aftësimin në punë; Fletë pune të lëshuar nga Zyra e Punës dhe dokumente të tjerë sipas specifikës së vendit të punës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar neni 21, dhe ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, ngarkon me përgjegjësi zj. I.S me detyrë drejtor Juridik dhe Burimeve Njerëzore.

2.4. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).

Ekzekutim me përmbarim privat i detyrimeve të prapambetura të abonentëve.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ish Ujësjetës Kanalizime Elbasan SHA, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë paguar 5 përmbarues privat: z. E.Gj, znj. E.Z, znj. E.K, z. M. K dhe zyra e përmbarimit P (z. J.P), në vlerën **21,828,728 lekë**. Këto pagesa janë kryer

për mbledhjen e detyrimeve të klientëve debitorë ndaj ujësjellësit. Marrëveshja me përmbaruesin privat lidhet individualisht për çdo klient rast pas rasti, dhe shpenzimet përmbarimore janë paguar nga SHRUKË SHA, bazuar në nenin 7, pika 2, të kontratës tip “Vlera e tarifës fikse të shërbimit për fillimin e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm dhe kryerja e të gjitha veprimeve procedurale sipas Kodit të Procedurës Civile është vlerën xxx lekë + TVSH, sipas udhëzimit të përbashkët nr. 385/7, datë 28.06.2017 për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat, dhe do të paguhet nga kreditori në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit, përveç rastit kur kreditori është i përjashtuar me akt ligjor apo nënligjor, nga pagimi i tarifës fikse.

Në këtë rast, kreditori **nuk është** i përjashtuar me akt ligjor apo nënligjor nga pagesa e tarifës fikse.”

Sa më sipër, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, mes palëve janë lidhur **1019 kontrata**, për vlerën e debisë **88,717,490 lekë**, dhe rezulton se nga ana e përmbaruesit ligjor janë ekzekutuar tituj ekzekutivë në vlerën prej **5,288,873 lekë**, pra **5.9%** e vlerës të debisë, dhe i janë kthyer SHRUKË SHA **3,778,966 lekë**, pra **17.3%** e shpenzimeve përmbarimore (dhe në total 9,067,840 lekë).

Nga grupi i auditimit konstatohet se kontraktimi i përmbarimit privat ka rezultuar me humbje financiare për SHRUKË SHA, dhe se vlera e debisë të cilën duhet ta kishin arkëtuar, jo vetëm që nuk është ulur por nga **88,717,490 lekë** ka shkuar në vlerën **101,478,378 lekë**.

Nga grupi i auditimit konstatohet se kontraktimi i përmbarimit privat nuk ka rezultuar të jetë fitim prurës për SHRUKË SHA,

Po ashtu, duke analizuar rezultatin financiar të kësaj mase të marrë për të ulur detyrimet e palëve të tretë SHRUKË SHA, rezulton se kjo shoqëri është rënduar financiarisht në vlerën 12,760,888 lekë (diferenca midis pagesës ndaj përmbarimit privat dhe vlerave të kthyer nga debitorët për debinë dhe tarifën e përmbarimit privat).

Sa më sipër, vlera prej **18,760,888 lekë** që konsiderohet **efekt financiar negativ** në buxhetin e SHRUKË SHA dhe në buxhetin e shtetit.

Pasqyra nr. 1 Pagesat e përmbarimit dhe kthimi i vlerës të debisë nga klientët e ujësjellësit

Viti	Vlera e debisë e kërkuar me përmbarim privat	Tarifa e vlerës të përmbaruesit privat		Vlera totale e debisë për tu arkëtuar nga SHRUKË	Vlera e debisë e kthyer nga debitorët për faturat e ujit të pijshëm	Shuma e kthyer për tarifën e përmbarimit nga debitorët e Shruke	Vlera e mbledhur nga përmbarimi privat për llogari të shruke
		Për tu paguar	Pagesa fakt				
2021	44,073,567.84	9,484,800	8,606,400	52,679,967.84	2,577,039	439,666	11,644,879
2022	44,643,921.86	13,123,328	13,222,328	57,866,249.86	2,423,802	654,085	3,077,887
2023	0	0	0	0.00	288,033	2,685,215	2,973,248
Totali	88,717,489.70	22,608,128	21,828,728	110,546,217.70	5,288,874	3,778,966	9,067,840
	Në përqindje				5.9%	17.3%	
Vlera e mbetur për tu arkëtuar nga Shkruke 101,478,377.70 lekë				Rëndesa financiare në buxhetin e Shkruke si pasojë e kontraktimit të përmbarimit 12,760,888 lekë			

Burimi i të dhënave është gjeneruar nga SHKRUKE SHA

Nëse i referohemi Udhëzimit Nr. 1276/5, datë 27.7.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror”, pika III.2 dhe Udhëzimit të Përbashkët “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat”, pika III. 2, rezulton se nëse do të ishte kontraktuar përmbarimi shtetëror, tarifa fikse minimalisht do të ishte përgjysmuar, duke ulur në këtë mënyrë riskun dhe marzhin e humbjes të tarifës fikse, si shpjegohet në tabelën më poshtë:

Pasqyra nr. 2 Diferenca midis tarifës fikse të Përmbarrimit Gjyqësor Privat dhe atij Shtetëror

	Përmbarrimi Gjyqësor Privat	Përmbarrimi Gjyqësor Shtetëror	Diferenca (më pak) e shprehur në përqindje
Vlera e detyrimit nga ... ALL deri në ... ALL	Tarifa fikse (në lekë ose në përqindje mbi vlerën e detyrimit)	Tarifa fikse (në lekë ose në përqindje mbi vlerën e detyrimit)	
1 - 100,000	15,000 lekë	7,000 lekë	47%
100,001 - 300,000	22,000 lekë	11,000 lekë	50%
300,001 - 500,000	30,000 lekë	15,000 lekë	50%
500,001 – 2,000,000	10 %	4.5%	5.5%
2,000,001 – 5,000,000	8 %	4%	4%
5,000,001 – 10,000,000	7 %	3.5%	3.5%
10,000,001 - 30,000,000	6 %	3%	3%
30,000,001 – 90,000,000	4 %	2.5%	1.5%
mbi 90,000,000	3 %, por jo më shumë se 15 milionë lekë	2%, por jo më shumë se 5 milionë lekë	1%

Burimi i të dhënave është gjeneruar nga SHKRUKE SHA

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: ish - Administratorët L.K, Ç.L, Administratori L. T, ish – Drejtor Tregtare A.I, Drejtore Tregtare M. Ç, ish - shefe Finance E. M, E.P dhe Drejtor i Degës Juridike I. S.

Mos pagesa e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE Group SHA

Nga grupi i auditimit konstatohet llogaritë bankare të ish UKE janë sekuestruar disa herë nga përmbarruesi privat z. B.Sh, për shkak të mos pagesës të detyrimeve të energjisë elektrike ndaj OSHEE Group SHA, si më poshtë:

Pasqyra nr. 3: Urdhër Sekuestrot Konservative lidhur me detyrimin ndaj OSHEE Group SHA dhe Përmbarrimin Privat

Nr	Vendimi i Përmbarruesit Privat	Detyrimi ndaj OSHEE Group SHA (lekë)	Detyrim ndaj Përmbarruesit Privat (lekë)
1	Urdhër Sekuestro nr. 330/3 prot, datë 19.07.2021	17,663,866.91	1,271,798
2	Urdhër Sekuestro nr.331/3 prot, datë 19.07.2021	71,094,635.43	3,412,542
3	Urdhër Sekuestro nr.332/3 prot, datë 19.07.2021	70,894,166.02	3,403,100.4
4	Urdhër Sekuestro nr.333/3 prot, datë 19.07.2021	15,590,933.17	1,122,551.10
5	Urdhër Sekuestro nr. 460/3 prot, datë 14.09.2022	596,178.24	68,876.2
6	Urdhër Sekuestro nr. 463/7 prot, datë 31.03.2023	62,415,175.65	2,995,928.38
7	Urdhër Sekuestro nr. 464/3 prot, datë 14.09.2022	40,728,311.4	1,954,958.9
	Totali	278,983,266.82	14,229,755
	Shlyer nga SHRUKE SHA	115,772,422	14,224,576
	Diferenca	163,210,844.82	5,179

Burimi i të dhënave është gjeneruar nga SHKRUKE SHA

Nga administratori i Ujësjellës Kanalizime SHA Elbasan me shkresën nr. 2308 prot, datë 03.08.2021 “Letër angazhimi”, drejtuar përmbarruesit B. Sh, është kërkuar akt - marrëveshje duke marrë përsipër që çdo datë 5 të muajit pasardhës e deri në përfundim të detyrimit të shlyeje detyrimet e faturave korrente dhe 5,000,000 lekë detyrime të papambetura.

Nga grupi i auditimit konstatohet se sa më sipër nuk është zbatuar ky angazhim, dhe vlera totale e detyrimit ndaj OSHEE Group SHA, deri në periudhën e auditimit në terren, rezulton në vlerën **2,044,387,395 lekë**, nga ku detyrimi për energjinë elektrike ka arritur në vlerën 1,058,289,531 lekë dhe kamatëvonesat e këtij detyrimi në vlerën 986,097,863 lekë detyrim ky i cili përbën **efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë SHRUKE SHA, dhe buxhetin e shtetit.**

Për shkak të mosveprimeve lidhur me shlyerjen e këtyre detyrimeve janë paguar shpenzime përmbarrimore në vlerën 14,224,576 lekë, që konsiderohet **efekt financiar negativ** në buxhetin e SHRUKE SHA dhe buxhetin e shtetit.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: ish – Administratorët L.K, Ç. L, Administratori L.T, ish - Drejtore Tregtare A.I, Drejtore Tregtare M. Ç, ish – shefe Finance E. M, E. P, dhe Drejtor i Degës Juridike I.S.

Gjoha nga institucione të ndryshme

- Nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Qendror drejtuar Ujësjetës Kanalizime Peqin SHA, rezulton se janë urdhëruar tre “Urdhër Bllokim i Llogarive Bankare”, për llogaritë e Ujësjetës Kanalizime Peqin SHA, lidhur me detyrimet si më poshtë:

-Urdhër Bllokim i Llogarive Bankare nr. 7964 prot, datë 26.07.2021, për detyrimin e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, ku vlera e tatimit është 3,747,981 lekë, vlera e gjobës është 93,738 lekë, interesi është 23,112 lekë, dhe detyrimi total 3,846,831 lekë.

-Urdhër Bllokim i Llogarive Bankare nr. 13526 prot, datë 31.05.2022, për detyrimin e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, ku vlera e tatimit është 996,974 lekë, vlera e gjobës është 24,525 lekë, interesi është 6,093 lekë, dhe detyrimi total 1,027,592 lekë.

-Urdhër Bllokim i Llogarive Bankare nr. 34135 prot, datë 17.11.2022, për detyrimin e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, ku vlera e tatimit është 985,217 lekë, vlera e gjobës është 46 lekë.

Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, ku vlera e tatimit është 7,746,449 lekë, vlera e gjobës është 8,948,325 lekë.

Për Tatimin e Mbajtur në Burim, ku vlera e tatimit është 47,638 lekë.

Referuar “Detyrimeve në kohë reale” nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezulton se gjobat të papaguara janë në vlerën **9,476,713 lekë**.

-Nga grupi i auditimit u konstatua se lidhur vonesat e ndryshme në pagesa, SHRUKE SHA dhe njësitë, është gjobitur si më poshtë: me “Detyrimin për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale”, “Gjoha me DRSHTRR”, “Gjoha për likuidimin e vonuar të taksave të Bashkisë Elbasan”, “Gjoha nga QKB”, “Gjoha për ONE”, etj, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë paguar gjoha dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën **10,621,713 lekë**, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e SHRUKE SHA.

Gjithashtu edhe pse nuk është paguar ende vlera 9,476,713 lekë, e cila përfaqëson gjoha të pa paguara, kjo vlerë do të ketë efektet e saj negative në buxhetin e vitit të ardhshëm, me kryerjen e pagesës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: ish – Administratorët L.K, Ç. L, Administratori i SHRUKE L.T, Administratori i njësisë Peqin N.T., Administratori i njësisë Belsh E.P, Administratori i njësisë Gramsh T. B. Administratori i njësisë Librazhd - Përrenjas A. G, ish - Drejtore Tregtare A.I, Drejtore Tregtare M.Ç, ish – shefe Finance E.M, E.P, dhe Drejtor i Degës Juridike I.S.

Kontrata me ONE Albania SHA

Administratori i SHRUKE SHA, z. L.T ka lidhur kontratën me O. Albania SHA, për një periudhë prej 36 muajsh.

Nga grupi i auditimit konstatohet se në kontratën e lidhur midis palëve:

-nuk përcaktohet data e lidhjes të kontratës,

-nuk përcaktohet **saktësisht dhe është lënë evazive** për sa numra telefoni është lidhur kjo kontratë, dhe deri në cilën vlerë merret përsipër shlyerja e këtij detyrimi nga ana e SHRUKE SHA por referuar aneksit bashkëlidhur rezulton se: do të përvetësohen rreth 92 numra me shërbim të telefonisë dhe internetit, nga ku: për 87 numra kontrata është lidhur në vlerën 600 lekë/muaj, për 4 numra në vlerën 1,400 lekë në muaj dhe për 1 numër në vlerën 4,600 lekë në muaj.

Po ashtu, në kontratën e lidhur mes palëve rezulton se, në Aneksin nr. 3, pika 1.1, citohet se: “ONE Albania SHA do të ofrojë për pajtimtarin një buxhet me vlerë prej 711,600 lekë (me TVSH), të cilin do ta përfitojë në aparate celulare”.

-Sa më sipër konstatohet se bazuar në të dhënat e kontratës, vlera e parashikuar referuar listës bashkëlidhur kësaj kontrate, rezulton të jetë **62,400 lekë/muaj**.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, **nuk rezulton të jetë paguar kjo vlerë në asnjë rast**.

Pagesat lidhur me këtë kontratë paraqiten si në tabelën më poshtë:

Pasqyra nr. 4: Pagesat për ONE Albania SHA për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023

Muaji	Numri i punonjësve	Fatura Totale	Pagesë SHRUKE	Pagesë punonjësi	Muaji që është mbajtur
Janar		103,628	73,465	30,163	Dhjetor
Shkurt		97,086	70,035	27,051	Janar
Mars		147,187	148,587	-	Shkurt
Prill		161,781	155,781	6,000	Mars
Maj	186	123,400	116,200	6,600	Prill
Qershor	185	129,748	116,000	11,348	Maj
Korrik	185	145,920	131,540	12,579	Qershor
Gusht	184	128,319	114,839	13,480	Korrik
Shtator	184	131,115	114,000	17,116	Gusht
Tetor	184	125,910	114,000	11,911	Shtator
Nëntor	184	128,164	114,126	14,039	Tetor
Dhjetor	184	127,438	114,000	13,313	Nëntor
Totali		1,549,696	1,382,573	163,600	

Burimi i të dhënave është gjeneruar nga SHKRUKE SHA

-Njësia Ujësjetllës Kanalizime Librazhd - Prrrenjas

Administratori i Njesisë Ujësjetllës Kanalizime Librazhd - Prrrenjas z. A.G ka lidhur në datën 10.12.2020, kontratën me O.T. SHA, për një periudhë prej 24 muajsh.

Nga rezulton kjo kontratë rezulton se do të përvetësohen 44 numra me shërbim të telefonisë dhe internetit.

Po ashtu, në kontratën e lidhur mes palëve rezulton se, në Aneksin nr. 3, pika 2.1, citohet se: “O. T. do të ofrojë 96,000 lekë me TVSH, i cili do të përdoret për aparate celulare”.

Pasqyra nr. 4: Pagesat për ONE Albania SHA për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022

Viti	Fatura totale	Pagesa nga UK	Pagesë nga Punonjësit	Likuidimi në banke	Të pa likuiduara nga punonjësit/Institucioni
2020	249,910	3,480	234,011	237,491	12,419
2021	104,858.48	4,710.48	100,148	104,858.50	0.00
2022	25,645.41	25,645	0	24,445.41	1,200
Totali	380,414	33,835	334,159	366,795	13,619

Burimi i të dhënave është gjeneruar nga SHKRUKE SHA

-Njësia Ujësjetllës Kanalizime Peqin

Pasqyra nr. 5: Pagesat për ONE Albania SHA për periudhën 01.01.2022 – 31.08.2022

Viti	Fatura totale	Pagesa nga UK	Pagese nga Punonjësit	Likuidimi në banke	Të pa likuiduara nga Institucioni
2022	66,239	75,238	0	-	10,040
Totali	66,239	75,238	0	-	10,040

Burimi i të dhënave është gjeneruar nga SHKRUKE SHA

-Njësia Ujësjetllës Kanalizime Cërrik

-Përfaqësuesi i Njesisë Ujësjetllës Kanalizime Cërrik z. E. C ka lidhur në datën 30.04.2019,

kontratën me Telecom Albania, për një periudhë prej 24 muajsh.

Nga rezulton kjo kontratë rezulton se do të përvetësohen 66 numra me shërbim të telefonisë dhe internetit, me buxhet 200,000 lekë.

Po ashtu, në kontratën e lidhur mes palëve rezulton se, në Aneksin nr. 3, pika 21.1, citohet se: “Telecom Albania do të ofrojë 200,000 lekë me TVSH, i cili do të përdoret për aparate celulare”.

-Administratori i Njësisë Ujësjellës Kanalizime Cërrik z. E. T ka rinovuar në datën 30.04.2021, kontratën me T. A., për një periudhë prej 24 + 12 muajsh.

Nga rezulton kjo kontratë rezulton se do të përvetësohen 54 numra me shërbim të telefonisë dhe internetit me buxhet 150,000 lekë.

Po ashtu, në kontratën e lidhur mes palëve rezulton se, në Aneksin nr. 3, pika 1.1, citohet se: “T. A.do të ofrojë 150,000 lekë me TVSH, i cili do të përdoret për aparate celulare”.

Pasqyra nr. 5: Pagesat për ONE Albania SHA për periudhën 01.01.2022 – 31.08.2022

Viti	Fatura totale	Pagesa nga UK	Pagese nga Punonjësit	Likuidimi në banke	Të pa likuiduara nga punonjësit/Institucioni
2020	464,254	426,549	-	-	-
2021	355,682.00	289,606.00	-	-	-
2022	294,256.00	234,517	-	-	-
Totali	1,111,192	950,672	-	-	34,792

Burimi i të dhënave është gjeneruar nga SHKRUIKE SHA

-Lidhja e kontratës së shërbimit është kryer pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mire përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;” dhe neni 4, “Fusha e zbatimit”, si dhe VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”, i ndryshuar, VKM nr. 864 ...13. Drejtuesit e ndërmarrjes/shoqërisë tregtare me kapital 100 për qind shtetëror, që funksionojnë sipas ligjeve specifike përkatëse, kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe në varësi të mundësive financiare që kanë, të miratuar nga organet përkatëse, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo rast, jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve administrative, të miratuara në planin financiar përkatës.” Sa më sipër, vlera prej **3,932,878 lekë** që konsiderohet **efekt financiar negativ**.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Administratori i SHRUKE L.T, Administratori i njësisë Peqin N.T, Administratori i njësisë Cërrik E.T, Administratori i njësisë Librazhd - Prrenjas A.G.

Shpërndarja e karburantit pa dokumente justifikuese, në SHRUKE SHA

-Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e UK Kavajë SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nuk ka të bashkëlidhur një urdhër shërbimi për çdo mjet, nuk ka fletë udhëtimi të rregullta, por vetëm mujore, si dhe nuk ka programin e pune.

-Kartelat për tërheqjen e karburantit janë nënshkruar nga përgjegjësi i transportit dhe drejtuesi i mjetit.

-Automjetet e SHRUKE SHA, janë pjesërisht të pajisura me sistemin GPS, nuk kontrollohen km e përshkruar referuar normativave të harxhimit të përcaktuara nga patenta shoqëruese e mjeteve

dhe për mjetet e përdorura nuk janë të miratuara normativat e konsumit/100km për këtë qëllim, si dhe nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina.

- Nga verifikimi i gjendjes së karburantit sipas evidencës nga programi Alpha Platinum dhe të dhënave të dalës nga kartelat e shërbimit të transportit, në datën 04.04.2024, në zyrën e financës në SHRUK SHA për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 nuk rakordon sasia e dalës e karburantit midis drejtorisë të Financës dhe asaj të Transportit në SHUKRE SHA për vitin 2023, nuk dokumentohet me fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës në sasinë 647 litra (në drejtorinë e Financës paraqitet në sasinë 66,466 litra dhe në drejtorinë e Transportit në sasinë 67,113 litra).

-Pra rezulton se planifikimi i konsumit të karburantit nuk është i saktë dhe nuk është i mirë planifikuar. *Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Administratori L.T, ish - Drejtor Tregtare A.I, Drejtor Tregtare M.Ç, ish - shefe Finance, E.P, dhe Drejtor i Transportit E.L.*

Mbajtja e dokumentacionit të bankave

Nga grupi i auditimit konstatohet se mbajtja e dokumentacionit bankar në SHRUK SHA nuk është i saktë, i plotë, i besueshëm dhe nuk justifikon në mënyrë të plotë shpenzimet dhe të ardhurat. Sa më sipër bie në kundërshtim me:

Udhëzimin 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 34: *“Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike, si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.”*

-Pika 36: *“Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaku e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve.”*

- dhe pika 37: *“Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)”*.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Drejtor Tregtare M.Ç, ish - shefe Finance E.M, E.P.

Për sa më sipër është hartuar Projekt Raporti nr. 1044/8 prot, datë 29.05.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 880/85 prot, datë 26.06.2024, administruar në KLSH me nr. 1044/9 prot, datë 27.06.2024, z. L.T, znj. M.Ç, z. Ç. L, znj. I. S, znj. S.B, znj. N. Sh, znj. I.Z, z. G.H, z. G.T ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimet e subjektit të audituar: *1. Njësia Ujësjiellës Kanalizime Cërrrik ka lidhur kontratë në formë shkresore me kompaninë telefonike T. A., duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 864, datë 23.07.2010”Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë”, ku thuhet se “Njësitë e qeverisjes qendrore, vendore apo fondeve speciale, lidhin kontratat për këtë shërbim për cilindo prej operatorëve telefonikë, që veprojnë në vend, të cilët kanë epërsi në përmbushjen e këtyre kushteve: ofrojnë çmimin më të ulët, cilësinë më të mirë, shtrirjen me të gjerë të mbulimit me sinjal”. Është lidhur kjo kontratë me operatorin e mësipërm për shkak se ishte i vetmi operator që ofronte përmbushjen e këtyre kushteve.*

Qëndrimi i grupit të auditimit:*1. Argumenti i sipër përmendur nuk justifikon dhe nuk dokumenton përzgjedhjen e këtij operatori ekonomik, përmbushjen e këtyre kushteve, statusin e*

SHRUKË SHA, si dhe përfitimin e aparateve celulare nga ana juaj. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

➤ ***-Blerjet me vlera të vogla***

Nga grupi i auditimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të 46 procedurave të blerjeve me vlera të vogla u konstatuan parregullsi procedurale: në 10 procedura nuk janë lidhur kontratat mes palëve, në 14 procedura nuk janë ngritur komisionet e marrjes në dorëzim, në 17 procedura në dosje mungon fatura tatimore, në 2 procedura nuk janë përlogaritur vlerat i fondit limit, në 5 procedura nuk janë ngritur komisionet e kolaudimit, në 5 raste nuk janë hartuar specifikimet teknike dhe në 2 procedura të blerjes të hipokloritit të natriumit nuk janë planifikuar saktë sasi të nevojshme të blerjes dhe nuk është zbatuar plani i lëvrimit.

Këto veprime bien në kundërshtim me pikën 5 të Udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 të APP-së “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Po ashtu, këto veprime bien në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42 “Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruar”.

- Për gjithë periudhën objekt auditimi për procedurat me blerje të vogla nuk është bërë inventarizimi i dosjeve, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 19 si dhe me germën (g), të nenit 8 “Përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve të prapambetura”, të Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.

-Në Njësinë e Ujësjellës Kanalizime Gramsh për vitin 2022 janë kryer 5 procedura prokurimi me objekt të njëjte prokurimi, “Blerje materiale hidraulike” me vlerë totale 1,263,899 lekë pa TVSH. Nga auditimi i këtyre procedurave konstatohet se Autoriteti Kontraktor për vitin 2022 ka copëzuar fondin limit, në kundërshtim me neni 40, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Pika 8, Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit.”.

➤ ***Blerjet me vlera të vogla të Njësisë Ujësjellës Kanalizime Belsh***

Viti 2020

Me Urdhrin e Brendshëm të Administratorit, nr. 15/1, datë 14.01.2020, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlerat e vogla: G.K, A. H, dhe N.H.

1. “Blerje materiale të përgjithshme”

-Me Urdhrin e Administratorit, nr. 11 prot, datë 20.07.2020, është ngritur komisioni i përlogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, dhe grafikut të lëvrimeve të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje materiale të përgjithshme”, i përbërë nga: G. K, B. T dhe O.T.

-Me procesverbalin e datës 22.07.2020 nga komisioni sa më sipër, është përlogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit në vlerën 796,300 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

Në Procesverbalin nr. 1, datë 24.07.2020 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 26 ofertues, nga ku janë kualifikuar 25 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues operatori ekonomik N H me vlerë oferte 648,000 lekë pa TVSH.

Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata midis palëve, nuk është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim dhe nuk ka faturë tatimore.

2. “Blerje Kontatorë (matës uji)”

-Me Urdhrin e Administratorit, nr. 15 prot, datë 23.09.2020, është ngritur komisioni i përlogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, dhe grafikut të lëvrimeve të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje Kontatorë (matës uji)”, i përbërë nga: G.K, B. T dhe O.T.

-Me procesverbalin e mbajtur në datën 23.09.2020 nga komisioni sa më sipër, është përlogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit vlera 780,500 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

Në Procesverbalin nr. 1, datë 25.09.2020 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 21 ofertues, nga ku janë kualifikuar 21 operatorë ekonomikë dhe është shpallur fitues operatori ekonomik E– P me vlerë oferte 688,000 lekë pa TVSH.

-Me Urdhrin nr. 177/1 prot, datë 30.0.2020 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga: O. T, B. T, dhe G.K.

-Me procesverbalin e datës 01.10.2020 nga komisioni i marrjes në dorëzim janë marrë në dorëzim artikujt pas verifikimit dhe në prezencë të magazinierit z. F. B, duke bashkëlidhur faturën tatimore nr. 34, datë 01.10.2020.

Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata midis palëve.

Viti 2021

Me Urdhrin e Brendshëm të Administratorit, nr. 09 prot, datë 05.01.2021, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlerat e vogla: G.K, A. H, dhe E.C.

Me Urdhrin e Brendshëm të Administratorit, nr. 146 prot, datë 07.07.2021, është zëvendësuar anëtar i komisionit E. C me L.M.

1. “Blerje materiale elektrike dhe aparat ngjitës për bashkuese elektrofuzive”

-Me Urdhrin e Administratorit, nr. 15 prot, datë 30.04.2021, është ngritur komisioni i përlogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, dhe grafikut të lëvrimeve të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike dhe aparat ngjitës për bashkuese elektrofuzive”, i përbërë nga: G. K , O.T dhe B. T.

-Me procesverbalin nr. 15/1 prot, datë 05.05.2021 nga komisioni sa më sipër, është përlogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit në vlerën 590,000 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

Në Procesverbalin nr. 15/5 prot, datë 07.05.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 20 ofertues, nga ku janë kualifikuar 14 operatorë ekonomikë, dhe 2021 është shpallur fitues A.M.U me vlerë oferte 530,000 lekë pa TVSH.

-Me procesverbalin e datës 12.05.2021, nga komisioni i marrjes në dorëzim: B.T, P. S dhe Y.K janë kontrolluar sasitë dhe është konfirmuar përputhja me specifikimet teknike. Bashkëlidhur këtij procesverballi është paraqitur fatura elektronike. Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata midis palëve.

2. “Blerje vajra dhe graso”

-Me Urdhrin e Administratorit, nr. 21 prot, datë 13.10.2021, është ngritur komisioni i përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, dhe grafikut të lëvrimeve të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje vajra dhe graso”, i përbërë nga: G.K , O.T dhe B.T.

-Me procesverbalin nr. 21/1 prot, datë 15.10.2021 nga komisioni sa më sipër, është përlllogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit në vlerën 195,900 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvritimit.

Në Procesverbalin nr. 21/5 prot, datë 19.10.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 26 ofertues, nga ku janë kualifikuar 24 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues operatori ekonomik E. S .

Me Urdhrin nr. 21/8 prot, datë 25.10.2021 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga: A. T, B. T, dhe P. S.

-Me procesverbalin e datës 25.10.2021, nga komisioni i marrjes në dorëzim: B.T, P.S dhe Y. K janë kontrolluar artikujt dhe është konfirmuar përputhja me specifikimet teknike. Bashkëlidhur këtij procesverbal është paraqitur fatura elektronike. Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata midis palëve.

3. “Blerje materiale të përgjithshme”

-Me Urdhrin e Administratorit, nr. 20 prot, datë 15.09.2021, është ngritur komisioni i përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, dhe grafikut të lëvrimeve të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje materiale të përgjithshme”, i përbërë nga: G. K, O.T dhe B.T.

-Me procesverbalin nr. 20/1 prot, datë 15.09.2021 nga komisioni sa më sipër, është përlllogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit në vlerën 661,550 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvritimit.

Në Procesverbalin nr. 20/5 prot, datë 17.09.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 32 ofertues, nga ku janë kualifikuar 11 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues operatori ekonomik N.H.

Me Urdhrin nr. 20/8 prot, datë 23.09.2021 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga: A.T, B. T, dhe P. S.

-Me procesverbalin nr. 20/9 prot, 23.09.2021, nga komisioni i marrjes në dorëzim, janë kontrolluar artikujt dhe është konfirmuar përputhja me specifikimet teknike. Bashkëlidhur këtij procesverbal është paraqitur fatura elektronike. Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata midis palëve.

4. “Furnizim, vendosje goma makine”

-Me Urdhrin nr.11 prot, datë 17.02.2021, nga Administratori i është ngritur komisioni i përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, si dhe grafikut të lëvritimit të procedurës të prokurimit me objekt “Furnizim, vendosje goma makine”, i përbërë nga: G.K, A. T, dhe B. D.

-Me procesverbalin nr. 11/1 prot, datë 19.02.2021, nga komisioni sa më sipër, është përlllogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit vlerën 246,000 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvritimit.

Në Procesverbalin nr.11/5, datë 23.02.2021, nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 18 ofertues, nga ku janë kualifikuar 17 operatorë ekonomikë, dhe , është shpallur fitues operatori ekonomik E. S me vlerë oferte 182,000 lekë pa TVSH,

-Në Procesverbalin nr. 11/20 datë 04.03.2021, është administruar dokumentacioni i paraqitur nga firma fituese në prokurimin me objekt “Furnizim, vendosje goma makine”.

-Në datën 03.03.2021 dhe 20.12.2021, nga anëtarët e komisionit: Y. K, A. T dhe L. H, është mbajtur procesverbali e verifikimit të shërbimeve të kryera dhe vendosjes të mallrave. Bashkëlidhur këtij procesverbali është fletë hyrja me nr. 02/1, datë 03.03.2021, firmosur nga znj. L.M. Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata mes palëve.

5. “Blerje kancelari, shtypshkrime dhe tonera”

-Me Urdhrin nr.13 prot, datë 23.03.2021, nga Administratori i është ngritur komisioni i përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, si dhe grafikut të lëvrimit të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje kancelari, shtypshkrime dhe tonera”, i përbërë nga: A. H, G. K , dhe B. K.

-Me procesverbalin nr. 13/1 prot, datë 25.03.2021, nga komisioni sa më sipër, është përlllogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit vlerën 398,030 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

Në Procesverbalin nr.13/5, datë 29.03.2021, nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 18 ofertues, nga ku janë kualifikuar 17 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues operatori ekonomik IT Gj. K me vlerë oferte 295,000 lekë pa TVSH.

-Në Urdhrin nr. 13/29, datë 07.05.2021, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, si më poshtë: L. M , P. S , dhe G. K.

-Në datën 07.05.2021 dhe 20.12.2021, nga anëtarët e komisionit është mbajtur procesverbali e verifikimit të mallrave dhe vendosjes të mallrave sipas situacionit. Bashkëlidhur këtij procesverbali është fatura tatimore me nr. 42/2021, datë 07.05.2021. Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata mes palëve.

Viti 2022

Me Urdhrin e Brendshëm të Administratorit, nr. 16 prot, datë 03.02.2022, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlerat e vogla: G.K , A. H , dhe L. M.

1. “Rikonstruksion Depo ekzistuese Kosovë”

-Me Urdhër Prokurimi nr. 12 prot, datë 21.04.2022, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Rikonstruksion Depo ekzistuese Kosovë”.

-Me shkresën nr. 12/1 prot, datë 21.04.2022 është shpallur ftesa për rikonstruksionin e depos ekzistuese, Kosovë, në të cilën nuk është përcaktuar vlera e fondit limit.

-Me Procesverbalin nr. 12/2 prot, datë 21.04.2022 është hartuar “Procesverbal - Tip i kontratës - Pune”, për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

Në Procesverbalin nr. 12/4 prot, datë 26.04.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 11 ofertues, nga ku janë kualifikuar 5 operatorë ekonomikë.

Me procesverbalin nr. 12/6 prot, datë 2.04.2022 është shpallur fitues operatori ekonomik RR. - C me vlerë oferte 443,000 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 12/7, datë 23.04.2022 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjellës Kanalizime SHA Belsh, z. E. P dhe përfaqësuesit ligjor z. A. Rr, me objekt “Rikonstruksion Depo ekzistuese Kosovë”.

Sa më sipër, nuk është bërë përlllogaritja e fondit limit, nuk është përcaktuar fondi limit në ftesën për ofertë, nuk ka faturë tatimore në dosje dhe nuk ka koalidim dhe marrje në dorëzim.

2. “Shërbim interneti”

-Me Urdhrin e Administratorit, nr. 14 prot, datë 09.05.2022, është ngritur komisioni i përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, dhe grafikut të lëvrimeve të procedurës të prokurimit me objekt “Shërbim interneti”, i përbërë nga: A. Sh, P.T, dhe N. H.

-Me procesverbalin nr. 14/1 prot, datë 09.05.2022 nga komisioni sa më sipër, është përllogaritur fondi limit duke ju referuar përcaktimit në Buxhetin e institucionit, në vlerën 284,800 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimin.

Në Procesverbalin nr. 06/5 prot, datë 31.03.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 2 ofertues, nga ku është kualifikuar 1 operator ekonomik dhe është shpallur fitues F.K me vlerë oferte 278,000 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 14/8, datë 19.05.2022 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjellës Kanalizime SHA Belsh, z. E.P dhe përfaqësuesit ligjor z. F.K, me objekt “Shërbim interneti”. Sa më sipër u auditua kjo procedurë dhe nuk ka parregullsi.

3. “Blerje materiale dhe Shërbim i mjeteve të punës”

-Me Urdhër Prokurimi nr. 21 prot, datë 21.06.2022, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje materiale dhe Shërbim i mjeteve të punës”

-Me shkresën nr. 21/1 prot, datë 21.06.2022 është shpallur ftesa për blerje materiale dhe shërbim i mjeteve të punës, *në të cilën nuk është përcaktuar vlera e fondit limit.*

-Me Procesverbalin nr. 21/2 prot, datë 21.06.2022 është hartuar “Procesverbal - Tip i kontratës - Pune”, për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

Në Procesverbalin nr. 21/4 prot, datë 23.04.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 10 ofertues, nga ku janë kualifikuar 8 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues N.H me vlerë oferte 565,000 lekë pa TVSH.

- Me Urdhrin nr. 21/18 prot, datë 15.07.2022 nga Administratori është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga: A.T, N.H, dhe B.T.

- Me procesverbalin nr. 21/19 prot, datë 15.07.2022, është dakordësuar marrja në dorëzim e materialeve dhe shërbimit.

Sa më sipër, nuk është bërë përllogaritja e fondit limit, nuk është përcaktuar fondi limit në ftesën për ofertë, nuk ka faturë tatimore dhe kontratë mes palëve.

Mos planifikim i saktë i sasisë së nevojshme për blerjen e Hipokloritit të natriumit:

1. “Blerje Hipoklorit Natriumi” Me Urdhrin e Administratorit, nr. 06 prot, datë 13.04.2020, është ngritur komisioni i përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, dhe grafikut të lëvrimeve të procedurës, i përbërë nga: B.R, E. Q dhe O.T.

-Me procesverbalin e mbajtur në datën 14.04.2020 nga komisioni sa më sipër, është përllogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit për sasinë 16,600 litra në vlerën 796,800 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimin.

Në Procesverbalin nr. 1, datë 16.04.2020 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 13 ofertues, nga ku janë kualifikuar 6 operatorë ekonomikë dhe është shpallur fitues operatori ekonomik 2 AT.

-Me shkresën nr. 06/4, datë 17.04.2020 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjellës Kanalizime SHA Belsh, z. E.P dhe përfaqësuesit ligjor të OE 2 AT z. N.Sh, me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi”.

-Me Urdhrin nr. 06/5 prot, datë 15.05.2020 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga: Y. K, L.M, dhe B.F.

-Marrja në dorëzim është dokumentuar me 5 procesverbalë, të cilët kanë bashkëlidhur fletë hyrjet e magazinës me nga 2,000 litra, konkretisht në datat: 15.05.2020, 21.08.2020, 19.10.2020 dhe 28.12.2020. *Sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet se janë tërhequr vetëm 8,000 litra hipoklorit natriumi, krahasuar me kërkesën për 16,600 litra.*

2. **“Blerje Hipoklorit Natriumi”**. Me Urdhrin e Administratorit, nr. 06 prot, datë 28.03.2022, është ngritur komisioni i përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, dhe grafikut të lëvrimeve të procedurës të prokurimit, i përbërë nga: P.T, G.K, dhe L.H.

-Me procesverbalin nr. 06/1 prot, datë 29.03.2022 nga komisioni sa më sipër, është përllogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit për sasinë 10,000 litra në vlerën 600,000 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

Në Procesverbalin nr. 06/5 prot, datë 31.03.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 14 ofertues, nga ku janë kualifikuar 12 operatorë ekonomikë.

-Në këtë procesverbal është shpallur fitues operatori ekonomik 2 AT me vlerë oferte 480,000 lekë pa TVSH.

-Marrja në dorëzim është dokumentuar me 5 procesverbalë, të cilët kanë bashkëlidhur fletë hyrjet e magazinës me nga 2,000 litra, konkretisht në datat: 22.04.2022, 18.07.2022, 26.09.2022, 13.12.2022 dhe 27.12.2022.

Sa më sipër, në dosjen e kësaj procedure, nuk ka kontratë midis palëve, nuk ka faturë tatimore të shitjes, si dhe nuk është zbatuar plani i lëvrimit të hipokloritit të klorit.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: ish - Administratori E.P, dhe anëtarët e Komisioneve për Prokurimet me Vlera të Vogla: G. K, A. H, N. H, E.C dhe L.M.

Blerjet me vlera të vogla të Njësisë Ujësjellës Kanalizime Librazhd – Prrenjas

Viti 2020

1. “Blerje pjesë këmbimi për mjetet”

-Në datën 08.06.2020 është hartuar nga Drejtori i Degës Teknike në UK SHA Librazhd, kërkesa për kryerjen e shërbimeve dhe pjesë këmbimi për skrepin, dhe tre automjete tip Nisan, drejtuar Komisionit të Njësisë të Prokurimit të Blerjeve të Vogla.

-Me Urdhrin e Administratorit, nr. 16/2, datë 03.06.202, është ngritur komisioni i përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, kriterëve teknike kualifikuese, grafikun e punimeve, si dhe preventivit të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje pjesë këmbimi pëe mjetet e ndërmarrjes”, i përbërë nga: B.P (Kryetar), Sh.K (Anëtarë), dhe B. A.

Me procesverbalin e mbajtur nga komisioni sa më sipër, është përllogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit vlerën 354,200 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

-Me Urdhër Prokurimi nr. 6, datë 15.06.2020, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje pjesë këmbimi për mjetet e ndërmarrjes”, si dhe ka ngritur komisionin e përbërë nga: B.P (Kryetar), Sh. K (Anëtarë), dhe B.A.

Në Procesverbalin nr. 2, datë 19.06.2020 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 18 ofertues, nga ku janë kualifikuar 11 operatorë ekonomikë dhe është shpallur fitues me ofertën I.Q me vlerë oferte 338,000 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 6/2, datë 24.06.2020 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjellës Kanalizime SHA Librazhd - Prrenjas, z. A.G dhe përfaqësuesit ligjor z. I.Q, me objekt “Blerje pjesë këmbimi për mjetet e ndërmarrjes”.

-Në datat 03 - 06 - 08 - 10.07.2020, nga anëtarët e komisionit: B. A, K. N, I. Ç, A.B dhe Sh. B janë mbajtur procesverbalët e verifikimit të shërbimeve të kryera dhe vendosjes të pjesëve të këmbimit. Sa më sipër, në dosje nuk ka faturë tatimore të shitjes.

2. “Blerje materiale të ndryshme ndërtimi për riparime në ujësjellësa e kanalizime”

-Me Urdhrin e Administratorit, nr. 1, datë 19.02.2020, është ngritur komisioni i përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje materiale të ndryshme ndërtimi për riparime në ujësjellësa e kanalizime”, i përbërë nga: B.A (Kryetar), Sh.K (Anëtarë), dhe E.B.

Me procesverbalin e mbajtur nga komisioni sa më sipër, është përlllogaritur fondi limit duke ju referuar çmimit mesatar të tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit vlerën 366,650 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

Me Urdhër Prokurimi nr.111, datë 20.02.2020, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje materiale të ndryshme ndërtimi për riparime në ujësjellësa e kanalizime” me fond limit 363,550 lekë pa TVSH si dhe ka ngritur komisionin e përbërë nga: B.P (Kryetar), B.A (Anëtarë), dhe E.B.

Në Procesverbalin nr.2, datë 21.02.2020 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, ku rezulton se kanë marrë pjesë 22 ofertues, nga ku janë klasifikuar 11 operatorë ekonomik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik A.H.

-Me shkresën nr. 1/3, datë 06.03.2020 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjellës Kanalizime SHA Librazhd - Prrenjas, z. A.G dhe operatorit ekonomik z. A.H, me objekt “Blerje materiale të ndryshme ndërtimi për riparime në ujësjellësa e kanalizime”. Sa më sipër, rezulton se nuk ka komision për kolaudimin, në dosje nuk ka faturë tatimore të shitjes dhe as fletë hyrje në magazinë.

Viti 2021

1. “Blerje pjesë këmbimi, pjesë xhenerike, goma, etj për mjetet e ndërmarrjes”

-Në datën 27.09.2021 është hartuar nga shoferi (personi që ka në ngarkim) i UK SHA Librazhd, kërkesa për kryerjen e shërbimeve dhe pjesë këmbimi për sharrën prerëse të asfaltit, drejtuar Administratorit dhe Komisionit të Njësisë të Prokurimit të Blerjeve të Vogla.

-Në datën 27.09.2021 është hartuar nga shoferi i UK SHA Librazhd, kërkesa për kryerjen e shërbimeve dhe pjesë këmbimi për mjetin tip Nisan NAVARA 2,5, drejtuar Administratorit dhe Komisionit të Njësisë të Prokurimit të Blerjeve të Vogla.

-Në datën 29.09.2021 është hartuar nga shoferi i UK SHA Librazhd, kërkesa për kryerjen e shërbimeve dhe pjesë këmbimi për mjetin tip Nisan NAVARA 2,5, drejtuar Administratorit dhe Komisionit të Njësisë të Prokurimit të Blerjeve të Vogla.

- Me Urdhrin e Administratorit, nr.67, datë 04.10.2023, është ngritur komisioni i përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, si dhe grafikut të shërbimit të procedurës të prokurimit, i përbërë nga S.M (Kryetar), I.Ç (Anëtarë), dhe K.N.

Me procesverbalin e mbajtur nga komisioni sa më sipër, është përlllogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit vlerën 386,900 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

Në Procesverbalin nr.3, datë 20.09.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 19 ofertues dhe operatori ekonomik I.Q është paraqitur dhe për rrjedhojë është shpallur fitues me ofertën 379,000 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 489 prot, datë 03.11.2021 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjiellës Kanalizime SHA Librazhd - Prrrenjas, z. A.G dhe përfaqësuesit ligjor z. I.Q, me objekt “Blerje pjesë këmbimi, pjesë xhenerike, goma, etj për mjetet e ndërmarrjes”.

-Me Urdhrin e Administratorit nr. 489/1, datë 03.11.2021 “Për krijimin e komisionit për verifikimin e shërbimeve dhe vendosjes së pjesëve të këmbimit për mjetet e ndërmarrjes”, me anëtarë: K.N (Kryetar), I.Ç (Anëtarë), dhe Sh.B.

-Në datat 24.11.2021 dhe 20.12.2021, nga anëtarët e komisionit, janë mbajtur procesverbalët e verifikimit të shërbimeve të kryera dhe vendosjes të pjesëve të këmbimit. Sa më sipër, nuk ka faturë tatimore të shitjes.

2. “Blerje karburanti për automjetet”

Me Urdhrin e Administratorit, nr.1811, datë 06.05.2021, është ngritur komisioni i përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, kriterëve teknike kualifikuese, si dhe preventivit të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje karburanti për automjetet”, i përbërë nga: Sh.G (Kryetar), K.N (Anëtarë), dhe I.Ç.

Me Urdhër Prokurimi nr.1812, datë 12.05.2021, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje karburanti për automjetet”, me fond limit 783,333 lekë pa TVSH.

Në Procesverbalin nr.2, datë 14.05.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, ku rezulton se kanë marrë pjesë 4 ofertues dhe është shpallur fitues operatori ekonomik M- OIL, me ofertën me marzh fitimi 15,5%.

-Me shkresën nr. 25411, datë 08.06.2021 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjiellës Kanalizime SHA Librazhd – Prrrenjas, z. A.G dhe përfaqësuesit ligjor të M-O. z. E.G, me objekt “Blerje karburant për automjetet”, për 6035 litra karburant në vlerën 783,333 lekë pa TVSH. Sa më sipër, rezulton se nuk ka formular të përllogaritjes të fondit limit.

3. “Blerje kancelari, shtypshkrime e tonera për vitin 2021”

-Në datën 11.02.2021 është hartuar nga llogaritari i administratorit i UK SHA Librazhd, kërkesa për blerjen e kancelarive, shtypshkrimeve dhe tonerëve, drejtuar Administratorit dhe Komisionit të Njesisë të Prokurimit të Blerjeve të Vogla.

-Me Urdhrin e Administratorit, nr.13, datë 16.02.2021, është ngritur komisioni i përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, si dhe grafikut të shërbimit të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje kancelari, shtypshkrime e tonera për vitin 2021”, i përbërë nga: I.C (Kryetar), R.D (Anëtarë), dhe I.Ç.

Me procesverbalin e mbajtur nga komisioni sa më sipër, është përllogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit vlerën 363,550 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

Në Procesverbalin nr.2, datë 14.05.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, ku rezulton se kanë marrë pjesë 26 ofertues, nga ku janë klasifikuar 15 operatorë ekonomik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik A. K me vlerë oferte 334,400 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 1313, datë 19.03.2021 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjiellës Kanalizime SHA Librazhd - Prrrenjas, z. A.G dhe përfaqësuesit ligjor të

Operatorit Ekonomik A K, me objekt “Blerje kancelari, shtypshkrime e tonera për vitin 2021”, në vlerën 334,400 lekë pa TVSH.

-Në datat 24.11.2021 dhe 20.12.2021, nga anëtarët e komisionit, është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të kancelarive, shtypshkrimeve e tonerave. Sa më sipër, rezulton se nuk ka komision për kolaudimin, në dosje nuk ka faturë tatimore të shitjes dhe as fletë hyrje në magazinë.

4. Mbikëqyrje për objektin “Rikonstruksioni i rrjetit së Ujësjellësit në fshatin Zgosht”

-Me Vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 08, datë 26.03.2021 “Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2021”, të Regjistrisë të parashikimeve të prokurimeve publike të vitit 2021, është parashikuar “Rikonstruksioni i rrjetit së Ujësjellësit në fshatin Zgosht”, me zërat:

a) Mbikëqyrje punimesh në vlerën 754,728 lekë pa TVSH,

b) Kolaudim punimesh në vlerën 34,198 lekë pa TVSH.

-Me Urdhrin e Administratorit, nr.4/1, datë 06.04.2021, është ngritur komisioni i përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike për prokurimit me objekt Mbikëqyrje për objektin “Rikonstruksioni i rrjetit së Ujësjellësit në fshatin Zgosht”, i përbërë nga: B.P (Kryetar), B.A (Anëtarë), dhe L.M.

Me procesverbalin e mbajtur nga komisioni sa më sipër, është përllogaritur fondi limit minimal 695,382 lekë pa TVSH dhe maksimal në vlerën 745,725 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

-Në Procesverbalin nr.2, datë 09.04.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, rezulton se kanë marrë pjesë 10 ofertues, nga ku janë kualifikuar 4 operatorë ekonomikë, dhe rezulton se operatori ekonomik Z.K është paraqitur dhe shpallur fitues bazuar në dokumentacionin e paraqitur.

-Me shkresën nr. 123 prot, datë 12.04.2021 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjellës Kanalizime SHA Librazhd - Prrrenjas, z. A.G dhe përfaqësuesit ligjor të Z-K z. L. H, Mbikëqyrje për objektin “Rikonstruksioni i rrjetit së Ujësjellësit në fshatin Zgosht”, në vlerën 695,380 lekë pa TVSH.

Viti 2022

1. “Blerje karburanti për automjetet”

Me Urdhrin e Administratorit, nr.36, datë 13.09.2022, është ngritur komisioni i përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, kriterëve teknike kualifikuese, si dhe preventivit të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje karburanti për automjetet”, i përbërë nga: Sh. G (Kryetar), K. N (Anëtarë), dhe I. Ç.

Me procesverbalin e mbajtur nga komisioni sa më sipër, është përllogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit vlerën 833,294 lekë pa TVSH, për sasinë 4431 litra. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

Në Procesverbalin nr.2 dhe Procesverbalin nr. 3, datë 20.09.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 3 ofertues dhe është shpallur fitues operatori ekonomik M-OIL, me ofertën 833,000 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 154 prot, datë 18.10.2022 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjellës Kanalizime SHA Librazhd – Prrrenjas, z. A.G dhe përfaqësuesit ligjor të M-OIL z. E.G, me objekt “Blerje karburant për automjetet”. Sa më sipër, rezulton se nuk është ngritur komision për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallit, në dosje nuk ka faturë tatimore të shitjes dhe as fletë hyrje në magazinë.

2. “Ndërtimi i linjave të reja dhe kasetave të matësive në zonat rurale”

Me Urdhrin e Administratorit, nr.42, datë 23.09.2022, është ngritur komisioni i përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, kritereve teknike kualifikuese, si dhe grafikun e punimeve të prokurimit me objekt “Ndërtimi i linjave të reja dhe kasetave të matësave në zonat rurale”, i përbërë nga: L.T (Kryetar), Sh. G (Anëtarë), dhe B.Ç.

Me procesverbalin e mbajtur nga komisioni sa më sipër, është përlllogaritur fondi limit duke ju referuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” dhe VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, duke vendosur si fond limit vlerën 800,000 lekë pa TVSH, për sasinë 4431 litra. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

Me Procesverbalin nr.1, datë 28.09.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, janë ftuar operatorët ekonomikë: L. BL, S. J. - PO, M, H dhe E.

-Në Procesverbalin nr.2, datë 29.09.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, rezulton se kanë marrë pjesë 3 ofertues, nga ku janë kualifikuar 2 operatorë ekonomikë dhe është shpallur fitues operatori ekonomik R G-K me vlerë oferte 785,300 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 172 prot, datë 11.11.2022 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjetës Kanalizime SHA Librazhd - Prrenjas, z. A.G dhe përfaqësuesit ligjor të R G- K, z. T.K, me objekt “Ndërtimi i linjave të reja dhe kasetave të matësave në zonat rurale”.

2. “Blerje pjesë këmbimi, pjesë xhenerike, goma, etj për mjetet e ndërmarrjes”

-Me Urdhrin e Administratorit, nr.37, datë 21.09.2023, është ngritur komisioni i përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike, kritereve teknike kualifikuese, grafikun e punimeve, si dhe preventivit të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje pjesë këmbimi, pjesë xhenerike, goma, etj për mjetet e ndërmarrjes”, i përbërë nga: Sh.G (Kryetar), K.N (Anëtarë), dhe I.Ç.

Me procesverbalin e mbajtur nga komisioni sa më sipër, është përlllogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit vlerën 550,000 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

Servis 1 Tiranë, Servis 1 SHPK, AS - AG, dhe S- A.

Në Procesverbalin nr. 2, datë 29.09.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 12 ofertues, nga ku janë kualifikuar 10 operatorë ekonomikë,

-Me shkresën nr. 170, datë 09.11.2022 është lidhur kontrata publike për furnizim me mallra, midis Administratorit Ujësjetës Kanalizime SHA Librazhd - Prrenjas, z. A. G dhe përfaqësuesit ligjor z. I. Q, me objekt “Blerje pjesë këmbimi, pjesë xhenerike, goma, etj për mjetet e ndërmarrjes”.

-Me Urdhrin e Administratorit nr. 37/3, datë 09.11.2022 “Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të shërbimeve dhe vendosjes së pjesëve të këmbimit për mjetet e ndërmarrjes”, me anëtarë: L.T (Kryetar), I.Ç (Anëtarë), K.N, Sh. B, dhe Xh. C. Në datat 19 - 22.12.2022 dhe 23.12.2022, nga anëtarët e komisionit, janë mbajtur procesverbalët e verifikimit të shërbimeve të kryera dhe vendosjes të pjesëve të këmbimit. Sa më sipër, në dosje nuk ka faturë tatimore të shitjes.

Procedura jashtë regjistrit të parashikimit të prokurimeve

1. “Blerje pajisje zyre”

-Me Urdhrin e Prokurimit nr. 52/1 prot, datë 25.11.2022 është ngritur komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, për blerjen e një karrike rrotulluese direksionale, i përbërë nga:

B.P (Kryetar),

B.A,

R.D (Anëtarë).

-Me Proceverbalin e Prokurimeve me Vlerë nën 100,000 lekë, rezulton se kanë marrë pjesë tre ofertues dhe është përzgjedhur operatori ekonomik E.L me vlerë oferte 66,667 lekë pa TVSH.

-Në datën 06.12.2022 është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim, fletë hyrja nr. 9, dhe është bashkëlidhur fatura elektronike nr. 162/2022.

Sa më sipër bie në kundërshtim me nenin 10, të marreveshjes të lidhur në AKUM nr. 1650 prot, datë 27.07.2022 “Marrëveshje për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizimeve”, “Gjatë gjithë periudhës tranzitore të transferimit, Shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizimeve do të pezullojnë të gjitha planet e investimeve dhe procedurat e prokurimit që kanë aktualisht në proces, përveç mirëmbajtjeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë”.

2. “Blerje materiale aktive të qëndrueshme për zyrën e Administratorit”

-Me Urdhrin e Prokurimit nr. 12 prot, datë 11.12.2020 është ngritur komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, me objekt “Blerje materiale aktive të qëndrueshme për zyrën e Administratorit”, për blerjen me kolltuqeve të lëkurës, tavolinë mesi dhe etazher me kapak, i përbërë nga B.P (Kryetar), Sh. K dhe B.A (Anëtarë).

-Me Proceverbalin e Prokurimeve me Vlerë nën 100,000 lekë, rezulton se kanë marrë pjesë tre ofertues dhe është përzgjedhur operatori ekonomik J.Q me vlerë oferte 65,000 lekë pa TVSH. -Në datën 23.12.2020 është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim, fletë hyrja nr. 17, dhe është bashkëlidhur fatura e thjeshtë tatimore nr. 17, datë 23.12.2020.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Administratori A.G, dhe anëtarë e Komisioneve për Prokurimet me Vlera të Vogla: B. P, B.A, R. D, L.Malo, Sh. K, E.B dhe M.B.

Blerjet me vlera të vogla të Njësisë Ujësjetllës Kanalizime Gramsh

Parregullsi procedurale në procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Viti 2020

Me Urdhrin e Brendshëm të Administratorit, nr. 62, datë 24.01.2020, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlerat e vogla: S.T(Kryetar), A.Xh, dhe H. M(Anëtarë).

1. Mbikëqyrje punimesh për objektin “Rikonstruksioni i linjës kryesore të ujësjetllës fshati Mashan, njësia administrative Kodovjat dhe vendosje matësish në pallatet me kolonë të brendshme qyteti Gramsh”.

-Me procesverbalin nr. 492 prot, datë 17.06.2020, nga Përgjegjësi i Degës Teknike z. B.K është përlllogaritur fondi limit minimal 719,708 lekë pa TVSH dhe maksimal në vlerën 785,046 lekë pa TVSH. Në këtë procesverbal janë nuk hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

-Në datë 29.06.2020 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, rezulton se kanë marrë pjesë 8 ofertues, nga ku janë kualifikuar 5 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues në sistem ofertuesi G B C.E me vlerë oferte 719,708.26 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 504 prot, datë 22.06.2020 është lidhur kontrata publike, midis Administratorit Ujësjetllës Kanalizime SHA Gramsh, z. T.B. dhe përfaqësuesit ligjor të OE G B C E, z. G. B, me objekt Mbikëqyrje punimesh për objektin “Rikonstruksioni i linjës kryesore të ujësjetllës fshati Mashan, njësia administrative Kodovjat dhe vendosje matësish në pallatet me kolonë të brendshme qyteti Gramsh.

Sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet se nuk është ngritur komisioni i hartimit të specifikimeve teknike, nuk janë hartuar kriteret të cilat duhet të cilat duhet të përmbushë operatori

ekonomik fitues, nuk janë specifikuar afatet e mbikqyrjes, nuk ka komision dhe marrje në dorëzim, dhe në dosje nuk ka faturë tatimore shitje.

2. “Rikonstruksioni i stacioneve të pompave dhe dhomave të klorinimit”

-Me Urdhër Prokurimi nr. 32, datë 29.06.2020, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël objekt “Rikonstruksioni i stacioneve të pompave dhe dhomave të klorinimit”.

-Me Formularin nr. 3, datë 30.06.2020 është shpallur ftesa për “Rikonstruksioni i stacioneve të pompave dhe dhomave të klorinimit”.

-Në datë 03.07.2020 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, rezulton se kanë marrë pjesë 13 ofertues, nga ku janë kualifikuar 16 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues ofertuesi I.I. me vlerë oferte 575,000 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 547 prot, datë 08.07.2020 është lidhur kontrata e sipërmarrjes, midis Administratorit Ujësjiellës Kanalizime SHA Gramsh, z. T.B dhe operatorit ekonomik z. I.I, me objekt Mbikëqyrje punimesh për objektin “Rikonstruksioni i stacioneve të pompave dhe dhomave të klorinimit”.

3. Studim/projektim i objektit “Rikonstruksioni i ujësjellësit rajonal Skënderbegas, Bashkia Gramsh”

-Me procesverbalin nr. 781 prot, datë 16.10.2020, nga Përgjegjësi i Degës Teknike z. B. K është përllogaritur fondi limit minimal 658,631.34 lekë pa TVSH dhe maksimal në vlerën 773,356.1 lekë pa TVSH. Duke qenë se fondi limit në dispozicion është 750,000 lekë pa TVSH, vlera limit është 750,000 lekë pa TVSH. *Në këtë procesverbal janë nuk hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.*

-Me Urdhër Prokurimi nr. 56, datë 16.10.2020, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël objekt Mbikëqyrje punimesh për objektin “Studim/projektim i objektit “Rikonstruksioni i ujësjellësit rajonal Skënderbegas, bashkia Gramsh”.

-Me Formularin nr. 3, datë 16.10.2020 është shpallur ftesa Studim/projektim i objektit “Rikonstruksioni i ujësjellësit rajonal Skënderbegas, bashkia Gramsh”, *ku rezulton se vlera e fondit limit nuk është përcaktuar.*

-Me Formularin nr. 5, datë 19.10.2020, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. T.B është anuluar kjo procedurë prokurimi për shkak të hedhjes gabim të fondit limit.

-Në datë 21.10.2020 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, rezulton se kanë marrë pjesë 6 ofertues, nga ku janë kualifikuar 3 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues G B C E me vlerë oferte 685,631.34 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 790 prot, datë 22.10.2020 është lidhur kontrata publike, midis Administratorit Ujësjiellës Kanalizime SHA Gramsh, z. Tajar Bici dhe përfaqësuesit ligjor të OE G B CE, z. G.B., me objekt Mbikëqyrje punimesh për objektin “Studim/projektim i objektit “Rikonstruksioni i ujësjellësit rajonal Skënderbegas, bashkia Gramsh”.

Sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet se nuk është ngritur komisioni i hartimit të specifikimeve teknike, nuk janë hartuar kriteret të cilat duhet të cilat duhet të përmbushë operatori ekonomik fitues, nuk janë specifikuar afatet e mbikqyrjes, nuk ka komision dhe marrje në dorëzim, dhe në dosje nuk ka faturë tatimore shitje.

4. “Blerje karburanti e vaj motori”

-Me Preventivin nr. 590 prot, datë 22.07.2020, është përllogaritur fondi limit për blerje karburanti dhe vaj motori në sasi të Gazoil - 4,660 litra dhe vaj motori - 40 litra, në vlerën 602,000 lekë pa TVSH .

-Me Urdhër Prokurimi nr. 38 datë 22.07.2020, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël objekt “Blerje karburanti e vaj motori”.

-Me Formularin nr. 3, datë 24.07.2020 është shpallur ftesa, “Blerje karburanti e vaj motori”, ku rezulton se vlera e fondit limit nuk është përcaktuar.

-Me Formularin nr. 5, datë 27.07.2020, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. T.B është anuluar kjo procedurë prokurimi për shkak mos plotësimit të kriterëve nga ofertuesit.

-Me Formularin nr. 3, datë 27.07.2020 është shpallur ftesa “Blerje karburanti e vaj motori”, ku rezulton se vlera e fondit limit nuk është përcaktuar.

-Me Formularin nr. 5, datë 29.07.2020, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. T.B është anuluar kjo procedurë prokurimi për shkak mos plotësimit të kriterëve nga ofertuesit.

-Me Formularin nr. 3, datë 29.07.2020 është shpallur ftesa “Blerje karburanti e vaj motori”, ku rezulton se vlera e fondit limit nuk është përcaktuar.

Me Provesverbalin nr. 1, datë 04.08.2020 është shpallur fitues K-SHPK, me vlerë oferte 593,996 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 619 prot, datë 07.08.2020 është lidhur kontrata publike, midis Administratorit Ujësjetës Kanalizime SHA Gramsh, z. T.B dhe përfaqësuesit ligjor K-SHPK z. V.Z, me objekt “Blerje karburanti e vaj motori”.

5. “Blerje Hipoklorit Natriumi”

-Me Kërkesën nr. 210 prot, datë 17.03.2020, është përlogaritur sasia e kërkuar për blerje Hipoklorit Natriumi në sasinë 600 kilogram.

-Me Urdhër Prokurimi nr. 11 prot, datë 18.03.2020, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël objekt “Blerje hipoklorit natriumi”.

-Me Preventivin nr. 211 prot, datë 17.03.2020, është përlogaritur fondi limit për blerje hipoklorit natriumi në vlerën 875,880 lekë pa TVSH .

-Në datë 20.03.2020 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, rezulton se kanë marrë pjesë 15 ofertues, nga ku janë kualifikuar 14 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues ADC, me vlerë oferte 500,000 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 219 prot, datë 24.03.2020 është lidhur kontrata publike, midis Administratorit Ujësjetës Kanalizime SHA Gramsh, z. T.B dhe përfaqësuesit ligjor Albania D C z. J.M, me objekt “Blerje hipoklorit natriumi”.

- Fatura Tatimore është me nr. Fature 110, datë 27.03.2020, në vlerën 58,133 lekë. Nuk ka të dhëna për blerjet e tjera.

Viti 2021

Me Urdhër e Brendshëm të Administratorit, nr. 77, datë 10.02.2021, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlerat e vogla: S.T (Kryetar), A.Xh, dhe H.M (Anëtarë).

1. “Blerje materiale ndërtimi për nevojat e shoqërisë”

-Me preventivin për fondin limit nr. 216 prot, datë 13.04.202, nga Përgjegjësi i Degës Teknike z. B.K, specialisti. H.M, dhe miratuar nga Administratori z. T.B është përlogaritur fondi limit me vlerën 423,370 lekë pa TVSH. Në këtë procesverbal janë nuk hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

-Në datë 07.05.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, rezulton se kanë marrë pjesë 14 ofertues, nga ku janë kualifikuar 8 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues ofertuesi S.A me vlerë oferte 396,800 lekë pa TVSH.

-Fatura tatimore është me nr. 72, datë 13.05.2021.

Sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet se nuk është ngritur komisioni i hartimit të specifikimeve teknike, nuk janë hartuar kriteret të cilat duhet të përmbushë operatori ekonomik fitues, nuk janë specifikuar afatet e mbikqyrjes, nuk ka komision dhe marrje në dorëzim, dhe nuk është lidhur kontrata mes palëve.

2. “Blerje karburanti, vaj motori, etj”

-Me Preventivin nr. 391 prot, datë 05.07.2021, është përlogaritur fondi limit për blerje karburanti dhe vaj motori në sasi të Gazoil – 4,236 litra, vaj motori - 40 litra dhe ujë antifrizë – 15, në vlerën 630,000 lekë pa TVSH .

-Me Urdhër Prokurimi nr. 33, datë 06.07.2021, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël objekt “Blerje karburanti, vaj motori, etj”.

-Me Formularin nr. 3, datë 07.07.2021 është shpallur ftesa, “Blerje karburanti e vaj motori”, ku rezulton se vlera e fondit limit nuk është përcaktuar.

-Në datë 09.05.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, rezulton se kanë marrë pjesë 5 ofertues, nga ku janë kualifikuar 1 operator ekonomik, dhe është shpallur fitues K:

1. K- me vlerë oferte 627,422 lekë pa TVSH,

-Me shkresën nr. 446 prot, datë 15.07.2021 është lidhur kontrata publike, midis Administratorit Ujësjetës Kanalizime SHA Gramsh, z. T.B dhe përfaqësuesit ligjor K-SHPK z. V.Z, me objekt “Blerje karburanti, vaj motori, etj”.

3. “Blerje dhe instalim i pajisjeve të sistemit të ruajtjes me kamera dhe ndriçimit në depot e qytetit”

-Me Urdhër e Administratorit nr. 680 prot, datë 09.11.2021 është ngritur komisioni për testim tregu dhe përcaktim fondi limit, i përbërë nga: B.K, E.G, dhe H.Sh.

-Me Procesverbalin nr. 703 prot, datë 11.11.2021, pas marrjes të ofertave nga tre operatorë ekonomikë, është përlogaritur fondi limit për blerjen dhe instalimin i pajisjeve të sistemit të ruajtjes me kamera dhe ndriçimit në depot e qytetit në vlerën 641,500 lekë pa TVSH .

-Në datën 26.11.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, rezulton se kanë marrë pjesë 10 ofertues, nga ku janë kualifikuar 1 operator ekonomik, dhe është shpallur fitues K, me vlerë oferte 626,100 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 778 prot, datë 03.12.2021 është lidhur kontrata publike, midis Administratorit Ujësjetës Kanalizime SHA Gramsh, z. T.B dhe përfaqësuesit ligjor K, z. K.B, me objekt “Blerje dhe instalim i pajisjeve të sistemit të ruajtjes me kamera dhe ndriçimit në depot e qytetit”.

-Me Urdhër e Administratorit nr. 10 prot, datë 11.01.2022 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga: B.K, M.M, dhe A.B.

-Me shkresën nr. 25 prot, datë 07.01.2022 është hartuar “Akt - marrja në dorëzim e përkohshme me objekt “Blerje dhe instalim i pajisjeve të sistemit të ruajtjes me kamera dhe ndriçimit në depot e qytetit”.

-Me shkresën nr. 75 prot, datë 20.0.2022 është hartuar “Akt - marrja në dorëzim e përfundimtar me objekt “Blerje dhe instalim i pajisjeve të sistemit të ruajtjes me kamera dhe ndriçimit në depot e qytetit”.

4. “Blerje aparat ngjitje tuba plastikë me elektrofuzion”

-Me Urdhër e Administratorit nr. 41 prot, datë 10.12.2021 është ngritur komisioni për testim tregu dhe përcaktim fondi limit, i përbërë nga: B.K, H.M, dhe I.B.

-Me Procesverbalin nr. 796 prot, datë 13.12.2021, pas marrjes të ofertave nga katër operatorë ekonomikë, është përlogaritur fondi limit për blerje aparati ngjitje tuba plastikë me elektrofuzion në vlerën 250,000 lekë pa TVSH .

-Në datën 16.12.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, rezulton se kanë marrë pjesë 13 ofertues, nga ku janë kualifikuar 6 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues operatori ekonomik A.M.U me vlerë oferte 235,000 lekë pa TVSH.

-Fatura tatimore është me nr. 719/2021, datë 23.12.2021.Sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet nuk ka komision dhe marrje në dorëzim dhe kolaudimit.

Viti 2022

Me Urdhrin e Brendshëm të Administratorit, nr. 92 prot, datë 09.02.2022, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlera e vogla: S.T (Kryetar), A.Xh, dhe H.M (Anëtarë).

Me Urdhrin e Brendshëm të Administratorit, nr. 427 prot, datë 01.06.2022, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlerat e vogla: J.N (Kryetar), A. Xh, dhe H.M (Anëtarë).

Me Urdhrin e Brendshëm të Administratorit, nr. 783 prot, datë 05.12.2022, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlerat e vogla: N.H (Kryetar), A. Xh, dhe H.M(Anëtarë).

Me Urdhrin e Brendshëm të Administratorit, nr. 813 prot, datë 20.12.2022, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlerat e vogla: N.H (Kryetar), S.B, dhe H.M (Anëtarë).

Me Urdhrin e Brendshëm të Administratorit, nr. 825/1 prot, datë 23.12.2022, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlerat e vogla: B.K (Kryetar), S.B, dhe H.M(Anëtarë).

Copëzim i fondit limit në procedurat për blerjen e materialeve hidraulike.

- Për vitin 2022 janë kryer 5 procedura prokurimi me objekt të njëjte prokurimi, “Blerje materiale hidraulike” me vlerë totale 1,263,899 lekë pa TVSH. Nga auditimi i këtyre procedurave konstatohet se Autoriteti Kontraktor për vitin 2022 ka copëzuar fondin limit, në kundërshtim me nenin 28 pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e efikasitetit në përdorimin e këtyre fondeve. Po ashtu, sa më sipër bie në kundërshtim me neni 40, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“Pika 8, Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit.”*

Sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet për procedurat sa më sipër, nuk ka të dhëna lidhur me ofertuesit dhe mënyrën e përzgjedhjes. Po ashtu, rezulton se nuk është ngritur komisioni i hartimit të specifikimeve teknike, nuk janë hartuar kriteret të cilat duhet të cilat duhet të përmbushë operatori ekonomik fitues, nuk janë specifikuar afatet e mbikqyrjes, nuk ka komision dhe marrje në dorëzim, dhe nuk ka faturë tatimore shitje.

-Blerje me vlera të vogla të Njësisë Ujësjellës Kanalizime Cërrik.

Viti 2020

Me Urdhrin e Brendshëm të Administratorit, nr. 175/1, datë 21.03.2020, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet me vlera të vogla: F.Xh(Kryetar), P.Xh, dhe S.D (Anëtarë).

1. “Blerje tonera dhe kancelari”

-Me procesverbalin e mbajtur në datën 29.04.2020 nga komisioni sa më sipër, është përlogaritur fondi limit duke ju referuar shtatë ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit vlera 398,620 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimin.

-Me shkresën e datës 02.06.2020 është shpallur ftesa për blerjen e tonerave dhe kancelarive.

Në Procesverbalin nr. 1, datë 16.04.2020 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 26 ofertues, nga ku janë kualifikuar 24 operatorë ekonomikë dhe është shpallur fitues operatori ekonomik L D me vlerë oferte 254,999 lekë pa TVSH,

Sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet se nuk ka procesverbal të shpalljes të fituesit, nuk ka kontratë mes palëve, nuk ka komision dhe marrje në dorëzim, dhe nuk ka faturë tatimore shitje.

2. “Blerje materiale ndërtimi”

-Me procesverbalin e datës 20.10.2020 nga komisioni sa më sipër, është përlllogaritur fondi limit duke ju referuar pesë ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit në vlerën 399,954 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

-Me Urdhër Prokurimi nr. 509/1 prot, datë 20.10.2021 Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje materiale ndërtimi”.

Në Procesverbalin e datës 22.10.2020 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 26 ofertues, nga ku janë kualifikuar 24 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues operatori ekonomik D - 2020 & CO me vlerë oferte 262,500 lekë pa TVSH.

-Me procesverbalin e datës 26.10.2020 nga komisioni i marrjes në dorëzim, janë marrë në dorëzim artikujt pas verifikimit. Sa më sipër, nga grupi i auditimit konstatohet se nuk ka gjurmë të ngritjes të komisionit të marrjes në dorëzim, dhe nuk ka faturë tatimore shitje.

Viti 2021

Me Urdhër të Brendshëm të Administratorit, nr. 45/1, datë 04.02.2021, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlerat e vogla: F.Xh(Kryetar), P.Xh, dhe S.D(Anëtarë).

1. “Blerje matësish familjare dhe prodhimi”

-Me procesverbalin e mbajtur në datën 10.03.2021 nga komisioni sa më sipër, është përlllogaritur fondi limit duke ju referuar dy ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit vlera 780,00 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

-Me Urdhër Prokurimi nr. 90/1 prot, datë 10.03.2021, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje matësish familjare dhe prodhimi”.

-Në datën 12.03.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 18 ofertues, nga ku janë kualifikuar 18 operatorë ekonomikë dhe është shpallur fitues operatori ekonomik BOA SORTE me vlerë oferte 697,000 lekë pa TVSH. Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata midis palëve, nuk është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, dhe nuk ka faturë tatimore shitje.

2. “Blerje Hipoklorit Natriumi”

-Me procesverbalin e datës 11.10.2021 nga komisioni sa më sipër, është përlllogaritur *fondi limit pa studim tregu* dhe duke përzgjedhur si fond limit për sasinë 17,770 litra në vlerën 960,000 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

-Me Urdhër Prokurimi nr. 316/2 prot, datë 11.10.2021, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje Hipoklorit Natriumi”.

-Në Procesverbalin e datës 13.10.2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 15 ofertues, nga ku janë kualifikuar 14 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “2 AT” me vlerë oferte 746,340 lekë pa TVSH. Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata midis palëve, nuk është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, dhe nuk ka faturë tatimore shitje.

Viti 2022

Me Urdhër të Brendshëm të Administratorit, nr. 20, datë 24.01.2022, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet për vlerat e vogla: F.Xh (Kryetar), P.Xh, dhe D.Xh(Anëtarë).

1. Mbikëqyrje punimesh për objektin “Vendosje matësash në pallatet me kolonë të brendshme, Bashkia Cërrik”

-Me procesverbalin e datës 24.08.2022, nga komisioni sa më sipër, është përlogaritur fondi limit minimal 719,894 lekë pa TVSH dhe maksimal në vlerën 790,759 lekë pa TVSH. Në kontratën - tip janë caktuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

-Me Urdhër Prokurimi nr. 267, datë 24.08.2022, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël objekt Mbikëqyrje punimesh për objektin “Vendosje matësish në pallatet me kolonë të brendshme, Bashkia Cërrik”.

-Në datë 26.08.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, rezulton se kanë marrë pjesë 18 ofertues, nga ku janë kualifikuar 4 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues Z K me vlerë oferte 719,894 lekë pa TVSH,

-Me shkresën nr. 504 prot, datë 22.06.2020 është lidhur kontrata publike, midis Administratorit Ujësjetës Kanalizime SHA Cërrik, z. E.T dhe përfaqësuesit ligjor të Z K z. L. H, me objekt Mbikëqyrje punimesh për objektin “Vendosje matësash në pallatet me kolonë të brendshme, Bashkia Cërrik”. Sa më sipër, nuk ka komision dhe marrje në dorëzim, dhe në dosje nuk ka faturë tatimore shitje.

2. “Blerje Hipoklorit Natriumi”

-Me procesverbalin e mbajtur në datën 20.09.2020 nga komisioni sa më sipër, është përlogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit për sasinë 16,000 litra në vlerën 800,000 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

-Me Urdhër Prokurimi nr. 299 prot, datë 20.09.2022, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje Hipoklorit Natriumi”.

Në Procesverbalin e datës 22.09.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 9 ofertues, nga ku janë kualifikuar 5 operatorë ekonomikë, dhe është shpallur fitues 2 AT me vlerë oferte 768,000 lekë pa TVSH.

Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata midis palëve, nuk është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, dhe nuk ka faturë tatimore shitje.

3. “Blerje karburanti për nevojat e institucionit”

-Me procesverbalin e mbajtur në datën 19.09.2022 nga komisioni sa më sipër, është përlogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit për sasinë 4,560 litra në vlerën 1,000,000 lekë pa TVSH.

-Me Urdhër Prokurimi nr. 294 prot, datë 19.09.2022, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje karburanti për nevojat e institucionit”.

-Në datë, 20.09.2022 është shpallur ftesa për blerjen e karburanti për nevojat e institucionit. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

-Me Procesverbalin e datës 21.01.2022 2021 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, ku rezulton se kanë marrë pjesë 1 ofertues, i cili është shpallur fitues:

1. I- OIL me marzh fitimi 19%.

Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata midis palëve, nuk është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, dhe nuk ka faturë tatimore shitje.

4. “Blerje Hipoklorit Natriumi”

-Me procesverbalin e mbajtur në datën 20.09.202 nga komisioni sa më sipër, është përlogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke

përzgjedhur si fond limit për sasinë 16,000 litra në vlerën 800,000 lekë pa TVSH. Po ashtu, në këtë procesverbal janë hartuar specifikimet teknike, kapacitetet teknike, dhe afati i lëvrimit.

-Me Urdhër Prokurimi nr. 299 prot, datë 20.09.2022, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje Hipoklorit Natriumi”.

Në Procesverbalin e datës 22.09.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 9 ofertues, nga ku janë kualifikuar 5 operatorë ekonomikë dhe është shpallur fitues AT me vlerë oferte 768,000 lekë pa TVSH.

Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata midis palëve, nuk është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, dhe nuk ka faturë tatimore shitje.

5. “Blerje materiale ndërtimi”

-Me procesverbalin e mbajtur në datën 21.09.2022 nga komisioni sa më sipër, është përlogaritur fondi limit duke ju referuar tre ofertave ekonomike të marra nga studimi i tregut, dhe duke përzgjedhur si fond limit në vlerën 480,000 lekë pa TVSH.

-Me Urdhër Prokurimi nr. 302 prot, datë 21.09.2022, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Blerje materiale ndërtimi”.

-Me Procesverbalin e datës 23.01.2022 nga komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, ku rezulton se kanë marrë pjesë 10 ofertues, të cilët janë kualifikuar dhe është shpallur fitues operatori ekonomik Grein - T me vlerë oferte 390,000 lekë pa TVSH.

Sa më sipër, nuk është lidhur kontrata midis palëve, nuk është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, dhe nuk ka faturë tatimore shitje.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Administratori E. T., dhe anëtarë e Komisioneve për Prokurimet me Vlera të Vogla: F.Xh , P.Xh, S.D dhe D.Xh.

Për sa më sipër është hartuar Projekt Raporti nr. 1044/8 prot, datë 29.05.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 880/85 prot, datë 26.06.2024, administruar në KLSH me nr. 1044/9 prot, datë 27.06.2024, z. T.B, z. S.T, z. H.M, znj. N.H, z. S.B, z. B.K kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Prezantimet e subjektit të audituar: 1. Duke qenë se në procedurat e zhvilluara operatorët ekonomikë të shpallur fitues kanë ofertuar shumë më pak se fondi limit i shpallur për secilën procedurë, dhe diferenca nga fondi limit i mbetur nga procedura e parë i është shtuar procedurës pasardhëse, e me radhë, por gjithmonë duke mbetur brenda vlerës së miratuar dhe brenda fondit prej prej 1,000,000 lekë, pa TVSH për procedurat me vlerë të vogël.

Qëndrimi i grupit të auditimit:1. Ju nuk keni paraqitur fakte të reja, si dhe sa më sipër nëse i referohemi fakteve të reja, nëse blerja me vlerë të vogël është realizuar, atëherë lë vend për dyshim lidhur me shkaqet e realizimit të procedurave të tjera, Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër është hartuar Projekt Raporti nr. 1044/8 prot, datë 29.05.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 880/85 prot, datë 26.06.2024, administruar në KLSH me nr. 1044/9 prot, datë 27.06.2024, z. E.P, z. G. K, znj. A. H, z. N. H, znj. S.B, znj. L.M kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Prezantimet e subjektit të audituar: 1. Ujësjetës Kanalizime Belsh për procedurat e prokurimeve me vlera të vogla ka respektuar pikën 19, të udhëzimit nr. 03, datë 08.01.2028 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike", ku ndër të tjera cilësohet se: Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës të lidhur, kur palët nuk kanë mundur të nënshkruajnë një të tillë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: 1. Ky argument nuk qartëson arsyet pse nuk janë inventarizuar në asnjë rast dosjet e procedurave të blerjeve me vlera të vogla, si dhe nuk justifikon mungesën e dokumenteve të konstatuara nga grupi i auditimit gjatë fazës së auditimit në terren. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 9, datë 05.04.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 880/47 prot, datë 15.04.2024, administruar në KLSH me nr. 1044/3 prot, datë 18.04.2024, z. A. G, znj. B. A, znj. R. D, znj. M.B, znj. L.M, z. Sh.K, znj. E. B kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Prezantimet e subjektit të audituar: 1. Lidhur me këtë konstatim ju bëjmë me dije se ne përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“, me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik “ ky dokumentacion është bashkëngjitur tek hyrjet dhe tek banka ne momentin e likuidimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: 1. Ky argument nuk qartëson arsyet pse nuk janë inventarizuar në asnjë rast dosjet e procedurave të blerjeve me vlera të vogla, si dhe nuk justifikon mungesën e dokumenteve të konstatuara nga grupi i auditimit gjatë fazës së auditimit në terren. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

➤ ***Blerjet e vogla Ujësjiellës Kanalizime Elbasan Sh.a***

Ujësjiellës Kanalizime Elbasan Sh.a në vitin 2022 ka realizuar 10 procedura blerje me vlera të vogël, në shumën 7,599,767 lekë, për blerjen e artikujve dhe shërbimeve si dhe të grup artikujve dhe grup-shërbimeve. Nga auditimi për blerjet me vlera të vogla, sipas viteve objekt auditimi, rezultoi se janë zhvilluar sa vijon:

Vitet	Blerje të vogla		Seleksionuar për tu audituar bazuar në riskun e auditimit		
	Numër	vlerë	numër	vlerë	në % ndaj totalit
2022	10	7,599,767	5	4,514,705	60 %
Totali	10	7,599,767	5	4,514,705	

-Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2022

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje kancelari dhe letër për vitin 2022”.

Në ftesën për ofertën citohet se OE i renditur në vend të parë duhet të paraqesë në zyrat e “UKE” sh.a, dokumentacionin kualifikues të kërkuar në dokumentat e Ftesës për Ofertë brenda 1 dite nga njoftimi i renditjes në sistemin elektronik të prokurimit. Në process-verbalin me nr.179/3 prot., datë 24.01.2022 citohet se nga KBV është bërë vlerësimi në sistem dhe është shpallur fituesi më datë 17.01.2022. OE ka paraqitur në datë 24.01.2022 dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë.

Grupi i auditimit konstaton se, duke qënë se nuk është respektuar afati prej 1 dite siç është kërkuar në ftesën për ofertë, AK duhet të mbante një proces-verbal dhe të kalonte te OE i renditur në vend të dytë e kështu më rradhë sipas Udhëzimit të APP-së.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje shërbim interneti dhe intraneti”. Në dosjen e prokurimit nuk është dokumentuar proces-verbali i mbajtur nga ana e KBV për kalimin te operatori i rradhës. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin Nr.5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 18.

*Për sa më sipër grupi i auditimit konstatoi:-*Nga titullari i autoritetit kontraktor nuk është ngritur një komision për blerjet e vogla në fillim te vitit, por është ngritur komision i ndryshëm për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, veprime këto në kundërshtim më Udhëzimin Nr.5, datë

25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 2.

-Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi titullari i autoritetit kontraktor. Në të shumtën e rasteve nuk janë të dokumentuara proces-verbalet e kalimit tek operatori ekonomik i rradhës, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin Nr.5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 18. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet më përgjegjësi njësia e prokurimit. Sa më sipër është mbajtur Akt konstatimi nr.10, datë 05.04.2024.

-Blerjet e vogla Ujësjiellës Kanalizime Sh.a Peqin

- Ngritja dhe zgjedhja e komisionit BVV është bërë në fillim të vitit, sa më poshtë vijon:

Viti	Urdhëri	Komisioni i BVV
2020	nr.1, datë 09.01.2020	N.T. (kryetar), B. K.(anëtar) F. B. (anëtar)
2021	nr.4, datë 11.01.2021	N.T. (kryetar), B. K. (anëtar) F.B. (anëtar)
2022	nr.4, datë 12.01.2022	A. C. (kryetar), F.B. (anëtar) L. K.(anëtar)

Ujësjiellës Kanalizime Sh.a Peqin sipas viteve 2020-2022 ka realizuar 30 procedura blerje me vlera të vogël, në shumën 18,429,968 lekë, për blerjen e artikujve dhe shërbimeve si dhe të grup artikujve dhe grup-shërbimeve. Nga auditimi për blerjet me vlera të vogla, sipas viteve objekt auditimi, rezultoi se janë zhvilluar sa vijon:

Vitet	Blerje të vogla		Seleksionuar për tu audituar bazuar në riskun e auditimit		
	Numër	vlerë	numër	vlerë	në %
2020	12	7,459,450	4	2,900,000	39 %
2021	11	6,669,110	3	2,150,000	32 %
2022	7	4,301,408	4	2,750,000	64 %

➤ **Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2020**

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Kryerje riparime dhe shërbime servisi të automjeteve të UK Peqin”

Nuk janë dokumentuar në dosjen e prokurimit përmbushja e kriterëve nr.2 dhe 6 të kërkuara në Ftesën për Ofertë. Pika 2 “Licencë për veprimtaritë e autoriparimit të mjeteve rrugore” dhe Pika 6 “OE fitues duhet të ketë pikën e servisit ku do të kryhen shërbimet deri në 5 km largësi nga qyteti i Peqinit ose të ketë përfaqësues në qytetin e Peqinit të licencuar më objekt aktiviteti shërbimin e kërkuar.

Në Urdhërin e Prokurimit nuk është specifikuar fondi limit në kundërshtim më pikën 6 të Udhëzimit nr.3, datë 08.01.2018 të APP-së “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Avolzhim elektromotorri”

Nuk është dokumentuar në dosjen e prokurimit përmbushja e kriterit nr.5 të kërkuara në Ftesën për Ofertë. Pika 5 “Të paraqiten katalogët teknike të përdorimit të mallrave të kërkuar”.

➤ Në dosje nuk janë ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomik për pjesëmarrje në këtë procedurë në kundërshtim me pikën 7, 9 të Udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 të APP-së “Mbi

përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.
Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2021:

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje autoveture”:

Në Urdhrin e Prokurimit nuk është specifikuar fondi limit në kundërshtim me pikën 6 të Udhëzimit nr.3, datë 08.01.2018 të APP-së “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Nuk është mbajtur një procesverbal mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga ana e OE të shpallur fitues. Në dosjen e prokurimit nuk është kontrata e lidhur mes OE të shpallur fitues dhe AK.

➤ ***Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2022***

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje elektromotor”

Në dosjen e prokurimit është procesverbali për përlogaritjen e fondit limit por nuk është dokumentuar mënyra e përlogaritjes vetem duke specifikuar që janë bërë kërkime në 4 subjekte.

Në dosjen e prokurimit nuk janë të dokumentuara përmbushja e disa prej pikave të kërkuara nga ana e AK për OE i cili do të shpallet fitues. Konkretisht janë pikat 3 (Garancia për elektromotorin të jetë minimumi 1 vit nga momenti i vendosjes në punë), 4 (Elektromotori të jetë i prodhuar në vendet e BE-së), 7 (Formulari përmbledhës i vetdeklarimit) dhe 8 (Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike).

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje elektropompë zhytëse dhe panel elektrik”

Në dosjen e prokurimit nuk janë të dokumentuara përmbushja e disa prej pikave të kërkuara nga ana e AK për OE i cili do të shpallet fitues. Konkretisht janë pikat 3 (Garancia për elektromotorin të jetë minimumi 1 vit nga momenti i vendosjes në punë), 4 (Elektromotori të jetë i prodhuar në vendet e BE-së), 7 (Formulari përmbledhës i vetdeklarimit) dhe 8 (Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike).

Kjo procedurë prokurimi nuk duhej të zhvillohej pasi është në kundërshtim me Marrëveshjen e lidhur ndërmjet Bashkisë Elbasan, Bashkisë Librazhd, Bashkisë Gramsh, Bashkisë Cërrik, Bashkisë Belsh, Bashkisë Peqin dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 22.07.2022, Neni 10 ku citohet se: *Gjatë gjithë periudhës tranzitore të transferimit, Shoqëritë e Ujësjiellës Kanalizimeve do të pezullojnë të gjitha planet e investimeve dhe procedurave të prokurimit që kanë aktualisht në proces, përveç mirëmbajtjeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë.*

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje Gazoil D1”

Në ftesën për ofertë citohet se afati i lëvrimin të mallit/realizimit të shërbimit/punës do të jetë deri më 31.12.2022, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës me OE të shpallur fitues. Në kontratën e furnizimit me karburant të lidhur më datë 24.01.2022, ndërmjet AK dhe OE të shpallur fitues, në Nenin 5 “Afati, zbatimi dhe zgjatja e afatit”, pika 5.1 citohet se afati i kësaj kontrate fillon prej nënshkrimit deri në përfundim të sasisë. Kjo gjë është në kundërshtim me kërkesën e bërë në Ftesën për Ofertë.

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Kryerje riparime dhe shërbime servisi të automjeteve të UK Peqin”

Në dosjen e prokurimit nuk janë të dokumentuara përmbushja e disa prej pikave të kërkuara nga ana e AK për OE i cili do të shpallet fitues. Konkretisht janë pika 2 “OE duhet të ketë minimalisht, pajisje teknike të nevojshme bashkëkohore për realizimin e kontratës” dhe pika 6 “OE duhet të ketë licencë për veprimtaritë e autoriparimit të mjeteve rrugore”.

Për sa më sipër grupi i auditimit konstatoi:

-Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara në vitin 2020 dhe vitin 2021, në të gjitha rastet është konstatuar se nuk janë ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomik për pjesëmarrje në këtë procedurë në kundërshtim me pikën 7, 9 të Udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 të APP-së “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

-Nga auditimi u konstatua se në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël anëtarët nuk kanë firmosur deklaratat e pavarësisë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Neni 19 “Konflikti i Interesit”.

-Nga auditimi u konstatua se në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nuk është specifikuar përlllogaritja e fondit limit dhe nuk është specifikuar në urdhrin e prokurimit. Në urdhrin e prokurimit janë të specifikuara vetëm mallrat e kërkuar si dhe sasia e tyre. Veprime këto në kundërshtim me pikën 5 të Udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 të APP-së “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

- Nga auditimi u konstatua se në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara në vitin 2022, në dosjen e prokurimit është procesverbali për përlllogaritjen e fondit limit por nuk është dokumentuar mënyra e përlllogaritjes vetem duke specifikuar që janë bërë kërkime në subjektë të ndryshme.

-Nga auditimi u konstatua se në asnjë nga procedurat e prokurimit për të tre vitet 2020-2022 nuk janë ngritur urdhra për krijimin e komisionit të marrjes në dorëzim veprime këto në kundërshtim me Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Autoriteti Kontraktor. Në asnjë rast nuk është bërë inventarizimi i dosjes së prokurimit me vlerë të vogël, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 19 si dhe me germën (g), të nenit 8.

-Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara në Njësinë Peqin për vitin 2020 nuk janë lidhur kontratat e shërbimit mes OE të shpallur fitues dhe AK.

➤ **Blerjet e vogla Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan Sh.a**

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan Sh.a në vitin 2022-2023 ka realizuar 5 procedura blerje me vlera të vogël, në shumën 4,250,349.5 lekë, për blerjen e artikujve dhe shërbimeve si dhe të grup artikujve dhe grup-shërbimeve. Nga auditimi për blerjet me vlera të vogla, sipas viteve objekt auditimi, rezultoi se janë zhvilluar sa vijon:

Vitet	Blerje të vogla		Seleksionuar për tu audituar bazuar në riskun e auditimit		
	Numër	vlerë	numër	vlerë	në % ndaj totalit
2023	5	4,250,349	5	4,250,349	100%
Totali	5	4,250,349	5	4,250,349	100%

-Në asnjë rast të përdorimit të formës së prokurimit “Blerje me vlerë të vogël”, fondi limit nuk ka qenë mbi 1,000,000 lekë pa TVSH, pra mbi kufirin monetar të përcaktuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 56, “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël”.

-Në të gjitha rastet AK ka bërë përlllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në ofertat e marra në treg dhe të pasqyruara dokumentin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

-Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar në asnjë rast.

-Nuk ka copëzim fondi.

-Miratimi i kërkesës për prokurim në të gjitha rastet janë miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK.
-Shpallja elektronike në sistem e procedurës, është realizuar në kohën e përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në të gjitha rastet, pasi kanë krijuar në sistem dosjen e tenderit, u janë drejtuar nëpërmjet ftesës për ofertë (sipas formularit nr. 3), 5 operatorëve ekonomikë për një periudhë 1-2 ditë nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit.

-Në të gjitha rastet është zbatuar kriteri i çmimit më të ulët për klasifikimin përfundimtar.

-Në të gjitha rastet nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, është mbajtur procesverbal për shpalljen e OE fitues, mbi bazën e ofertës më të ulët të shpallur nga sistemi. (Në të gjitha rastet ishin printuar ofertat e gjeneruara nga sistemi).

-Në të gjitha rastet OE fitues është njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik. Në rastet e tërheqjes së ofertave të vendeve të para është dokumentuar me shkresat zyrtare nga operatorët ose printimit nga sistemi i emali^{ve} të kryera nga AK (njoftimi) dhe OE (përgjigja).

-Procesverbalet e mbajtura nga komisioni për kalimin tek operatori i radhës kanë qenë të firmosura nga komisioni.

-Për të gjitha rastet e blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga Nëpunësi Autorizues.

Nga auditimi u konstatuan shkelje të përbashkëta të dispozitave ligjore, si më poshtë:

- Nga titullari i autoritetit kontraktor nuk është ngritur një komision për blerjet e vogla në fillim të vitit, por është ngritur komision i ndryshëm për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, veprime këto në kundërshtim me *Udhëzimin Nr.5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 2.*

-Për gjithë periudhën objekt auditimi për procedurat me blerje te vogla nuk është bërë inventarizimi i dosjeve, veprime këto në kundërshtim me *Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 19 si dhe me germën (g), të nenit 8.*

-Nga auditimi u konstatua se në shumicën e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim nuk kanë firmosur deklaratat e pavarësisë, veprime këto në kundërshtim me *Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Neni 19 “Konflikti i Interesit”.*

2.5. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

Mbi mbajtjen e evidencës kontabël, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Dokumentacioni i pasqyrave financiare.

Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.

Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.

Dokumentacioni i mbajtur mbi përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale.

Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.

Dokumentacioni për menaxhimin e aktiveve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

“Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime” Sh. a Elbasan është Shoqëri aksionare, regjistruar në Degën e Tatimeve Elbasan me nipt M23322201V. Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare”, nga statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është a) Shërbimi i furnizimit me ujë të

pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij; b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të fumizimit me ujë të pijshëm; c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve; c) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura; d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujerave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Shoqëria administrohet nga Këshilli Administrativ me Administrator të shoqërisë z. L.T, i cili ka kompetenca për drejtimin e saj mbi bazën e statutit.

Deri në periudhën e auditimit shoqëria nuk kishte mbyllur procesin e hartimit të pasqyrave financiare.

-Në maj të vitit 2022, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 302 që synon ristrukturimin e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve në vend. Disa nga aspektet kryesore të Vendimit të Këshillit të Ministrave për ristrukturimin e sektorit janë si më poshtë:

-Riorganizimi i shoqërive të ujësjellës si Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta (SKPUK) bëhet nëpërmjet krijimit të shoqërive të reja aksionare, sipas sistemit me dy nivele administrimi në përputhje me përcaktimet në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, shoqëritë të cilave do t'u transferohet veprimtaria ekonomike e shoqërive të ujësjellësit në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore që dakordsohen për krijimin e SKPUK.

Në mbështetje të Vendimit Nr. 78 date 23.06.2022 të Këshillit Bashkiak Elbasan, Vendimit Nr. 58 date 30.06.2022 të Këshillit Bashkiak Librazhd, Vendimit Nr. 46 datë 31.05.2022 të Këshillit Bashkiak Gramsh, Vendimit Nr. 46 datë 28.06.2022 të Këshillit Bashkiak Cërrik, Vendimit Nr. 15 datë 22.02.2022 të Këshillit Bashkiak Belsh dhe Vendimit Nr.5 datë 25.02.2022 të Këshillit Bashkiak Peqin që autorizojnë Kryetarët e Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin të hyjnë në një marrëveshje specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin.

Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës Kanalizime Elbasan, është krijuar më datë 22.07.2022, si marrëveshje mes MIE përfaqësuar nga AKUM dhe përfaqësuesve të bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin, si bashkim i të gjithë shoqërive të mëparshme dhe AKUM në formën e shoqërive publike për ujësjellës. Kjo marrëveshje ka si qëllim krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës - Kanalizimeve (SKP-UK), i cili do të kryejë veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin të cilat janë palë e kësaj marrëveshjeje, pjesë e të cilës është edhe AKUM.

Kapitali fillestar për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a që është në masën 10.000.000 Leke. Në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me qëllim themelimin dhe regjistrimin e shoqërive të reja SKP-UK, MIE do të likuidojë vlerën e 51% të aksioneve që do të përfitojnë.

Pjesëmarrja në përqindje në asamblenë e aksionareve në shoqërinë e re ujësjellës-kanalizime (SKPUK) e Bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin, në pronësi të të cilave janë aktualisht shoqëritë ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, është përlllogaritur në përpjesëtim me numrin e abonentëve aktive që këto shoqëri kanë duke përfshirë edhe kontratat aktive aktuale që administrohen nga vetë Bashkitë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKPUK, vlera totale e të cilave përbën 49% të aksioneve të shoqërisë së re dhe përbëhet në

përqindje si vijon: Bashkia Elbasan 28.52%, Bashkia Librazhd 3.13%, Bashkia Gramsh 4.13%, Bashkia Cërrik 5.46%, Bashkia Belsh 4.42% dhe Bashkia Peqin 3.34%.

Përfaqësuesit ligjore të shoqërive UK Elbasan SHA, UK Librazhd SHA, UK Gramsh SHA, UK Cërrik SHA, UK Belsh sh.a dhe UK Peqin sh.a me propozimin dhe mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), kanë caktuar ekspertë të pavarur për të vlerësuar dhe asistuar në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, gjatë procedurave të transferimit të veprimtarisë për tek shoqëria e re SKP-UK. Bilanci i transferimit është konsideruar bilanci i datës 31.12.2021.

Në procesin e bashkimit u konstatuan parregullsi si vijon:

Asambletë e aksionareve të UK Elbasan, UK Librazhd, UK Gramsh, UK Peqin, UK Cërrik, dhe UK Belsh, kanë autorizuar administratorët z. L.K, z. A.G, z. T.B, z. N.T, z. E.T, O.T si përfaqësues të shoqërive në cilësinë e transferuesit dhe për nënshkrimin e aktit të transferimit. Në nenin 6 kontributi i palëve, pikat 3,4 të marrëveshjes mes palëve është përcaktuar se: “3. Pas themelimit të shoqërisë së re SKP-UK, Bashkitë Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin do të transferojnë tek SKP-UK të gjithë veprimtarinë e shoqërive të UK, që kryejnë aktualisht veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në territoret administrative respektive në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. 4. Në Bashkitë Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimin të ujërave të ndotura, të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, bashkia, brenda datës 31 dhjetor 2022, është përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe transferimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a.”

Në lidhje me pikën 4, nga të dhënat e vëna në dispozicion nuk rezultuan njësi që nuk ishin organizuar në formën e shoqërive aksionare.

Për sa i përket pikës 3, të nenit 6, kontributi i palëve, ish administratorët si përfaqësues për transferimin kanë faturuar të gjitha aktivet ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime” Sh. a Elbasan. Faturat janë përpiluar në përshkrimin e mallit me cilësimin si transferim inventarësh afatgjatë, afatshkurtër, inventar i imët etj., duke mos pasur përshkrimin e aktiveve të transferuara. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 101, “Përmbajtja e faturës, Fatura e lëshuar përpilohet në formën e caktuar nga Ministri i Financave dhe përmban informacionin e mëposhtëm: e) sasinë dhe përshkrimin e mallrave të shitura dhe përshkrimin e shërbimeve të kryera; g) çmimin për njësi, pa TVSH-në, për çdo lloj malli.”

Në veprimet e transferimit të aktivitetit tek shoqëria përhithëse nuk janë respektuar përcaktimet e Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Në pjesën për Dokumentimin e lëvizjes së aktiveve përcaktohet:

34. **Veprimet ekonomike** që kryhen në njësitë publike, si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, **pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse** dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a) **Dokumente autorizuese** - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat,

urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b) **Dokumente vërtetuese** - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë **fletëhyrjet**, faturat, situacionet e shpenzimeve, **fletëdaljet**, mandat arkëtimet, mandat pagesat, **procesverbalet**, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

36. Dokumentacioni quhet **i rregullt kur përshkruan** me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, **treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative**. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve.

Grupit të auditimit nuk i'u paraqitën dokumente për veprimet e marra nga ish titullarët e UK rajonale, në lidhje me dhënien në dorëzim të aktiveve sipas përcaktimeve sa më sipër.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish administratorët e UK rajonale, siç përcaktohet në pikën 5: *“Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.”*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish Administratorët:

Për ish UK Belsh SHA, z. O.T

Për ish UK Librazhd SHA z. A.G

Për ish UK Gramsh SHA z. T.B

Për ish UK Cërrik SHA z. E.T

Për ish UK Peqin SHA z. N.T

Për ish UK Elbasan SHA z. L.K dhe z. Ç.L

Në lidhje me detyrimin për njoftimin në Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave, për procesin e bashkimit ky është kryer nga administratori i “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime” Sh. a Elbasan.

Për afatet e hartimit dhe dorëzimit të pasqyrave financiare nga ish shoqëritë rajonale u konstatuan vonesa në hartimin, miratimin dhe dorëzimin në afat në sistemin tatimor si dhe në regjistrin e QKB-së.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 29, 33 si dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46.

Mos zbatimi i SNK në hartimin e pasqyrave financiare

Gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare ish shoqëritë UK Belsh, Cërrik, Gramsh, Librazhd, dhe Peqin, janë mbështetur në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, duke mos zbatuar SNRF-të. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, në nenin 3, Përkufizimet citohet:” 6. *“Njësi ekonomike” janë personat juridikë dhe fizikë, publikë dhe privatë, me dhe pa qëllime fitimprurëse, që kryejnë veprimtari dhe kanë seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë...*” Neni 5 Standardet kontabël që zbatohen për hartimin e pasqyrave financiare, citon: *“...2. Njësitë ekonomike me interes publik, si dhe rregullatorët e njësisë ekonomike me interes publik që veprojnë në fushën e kreditimit dhe sigurimeve, duhet të zbatojnë SNRF-të për hartimin e pasqyrave financiare...”*, gjithashtu në nenin 26 Inventari, llogaritë vjetore, të Vendimit nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, citohet: *1. Mbajtja e kontabilitetit dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore bëhet në*

përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar. 2. Në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, shoqëria i harton pasqyrat financiare vjetore në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar. 3. Administratori përgatit, në datën e pasqyrave financiare, raportin e administrimit për gjendjen dhe performancën e shoqërisë gjatë ushtrimit kontabël.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Administratorët dhe Drejtorët Tregtar të shoqërive.

-Shoqëritë UK Elbasan sh. a, UK Librazhd sh. a, UK Gramsh sh. a, UK Cërrik SHA, UK Belsh sh.a dhe UK Peqin SHA, nuk ka kryer zhvlerësimin e aktiveve financiare të shoqërisë. Në zërin kërkesa të arkëtueshme klientë, përveç detyrimeve të cilat po ndiqen me veprime administrative dhe ligjore, ka dhe zëra debitorë të tjerë për të cilët nuk disponohen dokumente të mjaftueshëm justifikues për ndjekje ligjore. Gjithashtu në këtë zë ka dhe vlera materialisht të vogla për të cilat nuk është efektive për ndjekje në organet gjyqësore.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me SKK3, "Instrumentet Financiare", pika 22 ku citohet: "Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësia duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje."

Mos kryerja e zhvlerësimeve të aktiveve financiare sjell mos paraqitje të besueshme të situatës ekonomike të institucionit.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Administratorët dhe Drejtorët Tregtar të shoqërive:

Për ish UK Belsh SHA, z. E.P, z. O.T dhe znj. F.B,

Për ish UK Librazhd SHA z. A.G, znj. A.S dhe znj. B.A

Për ish UK Gramsh SHA z. T.B., z. S.T dhe znj. J.N

Për ish UK Cërrik SHA z. E.T dhe znj. F.Xh

Për ish UK Peqin SHA z. N.T dhe znj. A.K

Për ish UK Elbasan SHA z. L.K, z. Ç.L, znj. E.Z dhe znj. E.M

-Shkelje të procedurave tatimore

Nga verifikimi i gjendjes debitorë në sistemin tatimor më datë 31.12.2023 u konstatua se:

Ish Uk Librazhd-Prrenjas ka detyrime në vlerën 89,416 lekë nga të cilat 79,435 lekë janë për tatimin mbi fitimin dhe 9,981 lekë janë për tatimin e mbajtur në burim. Ish UK Peqin ka detyrime në vlerën 9,219,307 lekë për tatimin mbi vlerën e shtuar si pasojë e mos-regjistrimeve të kryera në periudhën përkatëse. Ish UK Belsh ka detyrime në vlerën 10,000 lekë për tatimin e mbajtur në burim.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Administratorët dhe Drejtorët Tregtar të shoqërive.

Për ish UK Librazhd SHA z. A.G, znj. A.S. dhe znj. B.A

Për ish UK Peqin SHA z. N.T dhe znj. A.K

Për ish UK Belsh SHA, z. E.P, z. O.T dhe znj. F.B.

-Mos dhënia e shpjegimeve lidhur me jetën e dobishme të AAM

Në hartimin e pasqyrave financiare shoqëritë kanë përlllogaritur shpenzime nga amortizimi i aktiveve afatgjata. Në shënimet shpjeguese nga drejtimi i shoqërive nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme të AAM-ve, pra për normat e amortizimit të aplikuara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore.

-Duke mos përdorur norma menaxheriale të mirë-argumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, rritet risku për të mos kryer me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet: *“Përcaktimin e sistemeve dhe procedurave për zëvendësimin apo shtimin e aktiveve afatgjata. Planifikimi në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të jetës është një tjetër mënyre për parandalimin e mosfunksionimit dhe papritur të ndonjë aktivi. Jetëgjatësia standarde që jepet në regjistrin e aktiveve afatgjata nëpërmjet normave të amortizimit është një tregues se kur një aktiv duhet të zëvendësohet. Është e rëndësishme që jetëgjatësia standarde të mos ndiqet verbazi, pasi aktivi mund të vazhdojë të jete në gjendje pune dhe njëkohësisht i nevojshëm ose i dobishëm për plotësimin e objektivave të njësisë. Dobishmëria e çdo aktivi duhet vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, i cili ngrihet dhe funksionon sipas kriterëve të këtij udhëzimi.”*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Administratorët dhe Drejtorët Tregtar të shoqërive.

Për ish UK Belsh SHA, z. E.P, z. O.T dhe znj. F.B,

Për ish UK Librazhd SHA z. A.G, znj. A.S dhe znj. B.A

Për ish UK Gramsh SHA z. T.B, z. S.T dhe znj. J.N

Për ish UK Cërrik SHA z. E.T dhe znj. F.Xh

Për ish UK Peqin SHA z. N.T dhe znj. A.K

Për ish UK Elbasan SHA z. L.K, z. Ç.L, znj. E.Z dhe znj. E.M

-Shoqëritë UK Elbasan sh. a, UK Librazhd sh. a, UK Gramsh SHA, UK Cërrik SHA, UK Belsh sh.a dhe UK Peqin SHA, nuk kanë plotësuar regjistrin e aktiveve që kanë në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër. Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se institucioni nuk ka mbajtur regjistrin e aktiveve në përputhje me pikën 30 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30, ku përcaktohet: “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e bërjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.

Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivitetet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj.

Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Administratorët dhe Drejtorët Tregtar të shoqërive.

Për ish UK Belsh SHA, z. E.P z. O.T dhe znj. F.B,

Për ish UK Librazhd SHA z. A. G, znj. A.S dhe znj. B.A

Për ish UK Gramsh SHA z. T.B, z. S.T dhe znj. J.N

Për ish UK Cërrik SHA z. E. T dhe znj. F.Xh

Për ish UK Peqin SHA z. N.T dhe znj. A.K

Për ish UK Elbasan SHA z. L.K, z. Ç.L, znj. E.Z dhe znj. E.M.

-Nga verifikimi i pagesave të furnitorëve u konstatua se nga Departamentet Ekonomik dhe të Financës nuk janë ngritur dhe miratuar procedura e monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë si dhe për të dokumentuar që pagesat kryhen sipas skadencave kronologjike.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 1, ku citohet:

*Objekti i ligjit. Ky ligj përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Neni 2. Qëllimi i ligjit. **Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë. Neni 3, Fusha, e zbatimit të ligjit. Ky ligj zbatohet në njësitë e sektorit publik, ku, sipas këtij ligji, përfshihen: 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme. 2. Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme.***

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ku citohet:

“Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues 2. Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së: gj) garantimin që të gjithë kreditorët të paguhesh në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t’ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues.”

dhe nenin 16, pika 2, detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit ku citohet:

2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësive dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Pajisja me sistem të monitorimit të skadencave të detyrimeve të pagueshme, ul riskun e shoqërisë për krijimin e penaliteteve për mos pagesa në afat.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Administratorët dhe Drejtorët Tregtar të shoqërive.

Për ish UK Belsh SHA, z. E.P, z. O. T dhe znj. F.B,

Për ish UK Librazhd SHA z. A.G, znj. A.S dhe znj. B.A

Për ish UK Gramsh SHA z. T. B, z. S.T dhe znj. J.N

Për ish UK Cërrik SHA z. E. T dhe znj. F. XH

Për ish UK Peqin SHA z. N.T dhe znj. A.K

Për ish UK Elbasan SHA z. L.K, z. Ç.L, znj. E.Z dhe znj. E.M.

- Shoqëritë UK Elbasan sh. a, UK Librazhd sh. a, UK Gramsh sh. a, UK Cërrik sh. a, UK Belsh sh. a dhe UK Peqin sh. a, kanë në zotërim objekte, troje, ndërtesa, depo uji, ujësjellës etj, për të cilat nuk disponojnë certifikatat e pronësisë. Drejtuesit dhe personat përgjegjës për certifikimin e pasurive të Shoqërisë Shoqëritë UK Elbasan sh. a, UK Librazhd sh. a, UK Gramsh sh. a, UK Cërrik sh. a, UK Belsh sh. a dhe UK Peqin sh. a, duket se kanë vepruar në mënyrë formale dhe janë mjaftuar vetëm me përgatitje shkresash apo aplikime në ZVRPP-të përkatëse dhe nuk e kanë ndjekur këtë çështje të rëndësishme në mënyrë këmbëngulëse. Veprimet e mësipërme bien në

kundërshtim me Nenin 158/dh i Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

Veprimet dhe mosveprimet në përputhje me ligjin rrisin riskun për humbjet në aktivet e shoqërisë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Administratorët dhe Drejtorët Tregtar të shoqërive.

Për ish UK Belsh SHA, z. E.P, z. O.T dhe znj. F.B,

Për ish UK Librazhd SHA z. A. G, znj. A. S dhe znj. B.A

Për ish UK Gramsh SHA z. T.B, z. S.T dhe znj. J.N

Për ish UK Cërrik SHA z. E.T dhe znj. F.Xh

Për ish UK Peqin SHA z. N.T dhe znj. A.K

Për ish UK Elbasan SHA z. L.K, z. Ç.L, znj. E.Z dhe znj. E.M

Nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se:

Gjendja llogarive të arkëtueshme, klientët më 31.12.2023 është 480,579,000 lekë dhe në krahasim me gjendjen më 31.12.2022 e cila ishte 523,317,000 lekë, rezulton të jetë zvogëluar në vlerën 42,738,000 lekë.

Ulja e detyrimeve të klientëve ka ardhur si rezultat i masave të marra nga drejtimi i shoqërisë, si identifikimi dhe ndjekja e debitorëve me shoqëritë përmbarese, njoftimet përkatëse, dhe ndërprerje të shërbimit.

Situata e llogarive të pagueshme paraqitet e rënduar, me detyrime për furnitorë në vlerën 1,174,224,406 lekë, ku 996,730,000 lek janë detyrime ndaj FSHU, të mbartura nga ish UK rajonale, si dhe një pjesë të madhe furnitorë të mbartur. Vlera e detyrimit ndaj FSHU përmban vetëm principalin si detyrim. Shoqëria nuk ka përfshirë dhe vlerën prej 986,097,000 lekë kamatëvonesa në zërin e detyrimeve. Në llogaritë për tu paguar rezultojnë detyrime për të tretë që mbulohen me fonde të Buxhetit të Shtetit, në vlerën 375,635,000 lek, ku vlerën më të madhe e ka Strabag AG me 312,299,000 lekë. Në llogarinë 467 me vlerë 176,358,368 lekë, shoqëria ka kontabilizuar detyrimet ndaj bashkive për taksën që mbledh për llogari të tyre, vlera këto të mbartura në bilanc nga ish UK rajonale.

Situata ekonomiko financiare e shoqërisë nuk është e mirë. Shoqëria e re e krijuar ka bartur nga ish UK rajonale vlera të konsiderueshme detyrimesh, të cilat tejkalojnë shumë herë llogaritë e arkëtueshme.

2.6. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

➤ Mbi zbatimin e kontratave të punimeve

1. Për objektin “Ujësjiellësi i fshatit Bishqem xhami dhe ndërtim pusi”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) *Dosja teknike e zbatimit:*

- *Kontrata e zbatimit të punimeve midis Sh. a Ujësjiellësi Peqin dhe BOE “ASI-2A CO” sh.p. k & “Sh.” sh.p. k me Nr.19 Prot. datë 08.02.2021.*
- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);*
- *Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;*
- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;*

2) *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis Sh. A Ujësjiellësi Peqin dhe BOE “A-S” sh.p. k & “I.” sh.p. k me Nr.20Prot. datë 08.02.2021.*

- *Korrespondencat mes Sh. A Ujësjiellësi Peqin dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin BOE “AS” sh.p. k & “I” sh.p.k.*

Kontratat

Punimet janë kryer sipas kontratës, për punë publike me Nr.19 Prot. datë 08.02.2021 me objekt “Ujësjiellësi i fshatit Bishqem xhami dhe ndërtim pusi” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Sh. a Ujësjiellësi Peqin, të përfaqësuar nga Administratori z. N.T. dhe BOE “A.” sh.p. k & “Sh” sh.p. k të përfaqësuar nga administratori z. AGj me licenca profesionale NZ.4947/9. Vlera e kontratës është 48,485,976 lekë pa TVSH ose 56,663,071 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.20 Prot. datë 08.02.2021 me BOE “AS” sh.p. k & “I” sh.p. k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2692/3, si dhe me vlerë të kontratës 991,682.88 lekë pa TVSH ose 1,190,019.46 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.65Prot. datë 12.10.2021 me OE “NG” sh.p. k me licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3101/10 dhe me vlerë të kontratës 185,246.7 lekë me TVSH.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 10.02.2021.

Me shkresën pa nr. dhe pa datë sipërmarrësi i punimeve ka kërkuar korrigjime në projektin, vizatimin ose specififikimet e punëve; korrigjime në materiale; korrigjime në sasi këto të shoqëruara me: Preventivin e ripunuar brenda vlerës s kontratës; Tabelën e krahasueshmërisë dhe Volumet metrike. Propozimet e sipërmarrësit të punimeve janë miratuar me procesverbalin përkatës të firmosur nga të gjitha palët: sipërmarrës, mbikëqyrës dhe Autoriteti Kontraktor.

Referuar ndryshimeve në preventiv i volumeve (+/-) si dhe përdorimi i fondit rezervë vlera e preventivit të rishikuar është sa vlera e kontratës. Sipas relacionit përfundimtar punimesh të hartuar nga mbikëqyrësi i punimeve është 56,531,167 lekë më TVSH ose 131,904 lekë më pakë.

Me shkresat datë 10.08.2021 sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi njoftojnë përfundimin e punimeve të shoqëruar me procesverbalin përkatës të mbajtur po në datën 10.08.2021.

Kolaudimi i punimeve është kryer sipas aktit datë 15.10.2021 dhe janë marrë në dorëzim të përkohshëm me aktin e administruar me Nr.44Prot. datë 27.08.2021.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ujësjiellësi i fshatit Bishqem xhami dhe ndërtim pusi”.			
Lidhja e kontratës Nr.19 Prot. datë 08.02.2021	Vlera e kontratës (me tvsh) 56,663,071 lekë BOE “A.” & “Sh” sh.p.k		Likuiduar deri dt
Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 56,633,071 lekë -Vlera pa TVSH 48,485,976 lekë	Afati i kontratës në dite Parashikuar 6 muaj, Zbatuar 6 muaj Fillimi punimeve: 10.02.2021 Përfundimi punimeve: 10.08.2021		Zgjatja e kontratës
Mbikëqyrësi i punimeve BOE “AS” sh.p.k & “I” sh.p.k	Licenca Nr: MK.2692/3	Kontrata Nr.20Prot. datë 08.02.2021	
Kolaudatori i punimeve “NS” sh.p.k	Licenca Nr: MK.3101/10	Kontrata Nr.1972/10Prot. datë 25.05.2020	
Akt Kolaudimi datë 15.10.2021	Akt i marrjes në dorëzim Nr.44Prot. datë27.08.2021		

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve, të dukshme, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe shoqërisë në vlerën 372,350 lekë pa TVSH. Verifikimi u krye në rezervuarin 100 m³, Bishqem. Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

- Në kategorinë Rezervuari 100 m³ Nr.16, zërat: Suvatim muresh nga jashtë me llac çimento në situacionit përfundimtar pasqyrohet volum 117 m² dhe i likuiduar; Hidroizolim muret e jashtme me dy duar bitum në situacionit përfundimtar pasqyrohet volum 85.6 m² dhe i likuiduar; Hidroizolim solete me dy duar bitum në situacionit përfundimtar pasqyrohet volum 47.6 m² dhe i likuiduar. Nga vizita në terren u konstatua se zërat e punimeve të mësipërm nuk ishin realizuar, kështu që sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumet e punimeve të tyre, konkretisht 117 m² në zërin Suvatim muresh nga jashtë me llac çimento e kjo në vlerën 87,750 lekë pa TVSH (117 m² x 750 lekë/m²); 85.6 m² në zërin Hidroizolim muret e jashtme me dy duar bitum e kjo në vlerën 51,360 lekë pa TVSH (85.6 m² x 600 lekë/m²); 47.6 m² në zërin Hidroizolim solete me dy duar bitum e kjo në vlerën 19,040 lekë pa TVSH (47.6 m² x 400 lekë/m²).

- Në kategorinë Rezervuari 100 m³ Nr.16, zëri Rrethim territori me H=1.8 m në situacionit përfundimtar pasqyrohet volum 396 m² dhe i likuiduar. Nga vizita në terren u konstatua se rrethimi ishte kryer në volumin prej 270 m² dhe jo sa ishte likuiduar, kështu që sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin e punimeve prej 126 m² në zërin Rrethim territori me H=1.8 m, kjo në vlerën 214,200 lekë pa TVSH (126 m² x 1700 lekë/m²).

Gjithashtu në këtë kategori zëri Mbushje me dhe në situacionit përfundimtar pasqyrohet volum 200 m³ dhe i likuiduar. Nga vizita në terren u konstatua se mbushja me dhe rreth rezervuarit nuk ishte kryer, kështu që sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin e punimeve prej 200 m³ në zërin Mbushje me dhe, kjo në vlerën 44,000 lekë pa TVSH (200 m³ x 220 lekë/m³).

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i mbikëqyrësit BOE "A.-S." sh.p.k & "I." sh.p.k z. A. T. ku mospasqyrimi i saktë i volumeve të kryera në librezën e masave është në kundërshtim me:

- Kontratën e shërbimit Nr.20Prot. datë 08.02.2021 me objekt: "Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Ujësjellësi i fshatit Bishqem xhami dhe ndërtim pusi", konkretisht:

• Neni7, "Detyrimet e Mbikëqyrësit të Punimeve".

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: "Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit"

- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, ku përcaktohet se:

Pika 8.1: "Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi të, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës"

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

"3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet

nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;

2. Për objektin **“Instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengel-Samurr-Golodesh, (për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve)”**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis UK Elbasan dhe OE “BN” sh.p. k me Nr.1872/8 Prot. datë 08.11.20219.

- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);

- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;

- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;

2) Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis UK Elbasan dhe OE “I.-A.” sh.p.k me Nr.2520/23Prot. datë 05.12.2019.

- Korrespondencat mes UK Elbasan dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “I D-A.” sh.p.k.

Kontratat

Punimet janë kryer sipas kontratës, për punë publike, me Nr.1872/8 Prot. datë 08.11.20219me objekt **“Instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengel-Samurr-Golodesh, (për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve)”** të lidhur mes Autoritetit Kontraktor UK Elbasan, të përfaqësuar nga Administratori z. L.D dhe OE “B-N” sh.p. k me licenca profesionale NZ.3625/19. Vlera e kontratës është 61,797,051.1 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 45 ditë nga data e lidhjes së kontratës, kjo e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Afati i përfundimit të kontratës është ndryshuar me Amendim Kontrate Nr.2959/2Prot. datë19.12.2029, ku me urdhrin Nr.173/1 datë 19.12.2019 është bërë pezullimi i punimeve nga data 19.12.2019 deri më 28.02.2020 dhe rifillimi i tyre 02.03.2020 deri 17.04.2020. Arsyeja e pezullimit të punimeve janë kushtet e motit të pa përshtatshme për instalimin e pompave, pajisjeve elektrike si dhe vështirësia e realizimit të saldimit sipas kushteve teknike në temperatura të ulta.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.2520/23Prot. datë 05.12.2019me OE “I.” sh.p. k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 919/9, si dhe me vlerë të kontratës 1,033,885 lekë pa TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.1972/10Prot. datë 25.05.2020 me OE “DN C S” sh.p. k me licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2010/5.

Hartimi i projektit

Projekti është hartuar nga OE “A.-S.” sh.p.k. Në këtë projekt janë parashikuar të kryhen punime: ndërtohet linja e rrjetit të jashtëm me tub çeliku Ø 1433mmx7mm me gjatësi afërsisht 2700 ml; rehabilitimi i godinave të stacioneve të pompimit Mengel, Byshek, Golodesh; vendosja e pompave

të reja së bashku me rrjetin elektrik (transformator dhe panele të reja elektrike); sistem klorinimi në stacionet e pompimit si dhe vendosja e matësve elektronik me pajisje për transmetimin e të dhënave në distancë.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 05.12.2019 dhe administruar në UK Elbasan sh. a me Nr.2883Prot. datë 05.12.2019.

Me shkresën Nr.138 prot. datë 19.12.2019 sipërmarrësi i punimeve ka paraqitur azhurnimet faktike të shoqëruar me preventivin e rishikuar, tabelat e ndryshimeve (+/-) si dhe përdorimin e fondit rezervë për mbulimin e ndryshimeve por pa e kaluar vlerën fillestare të kontratës. Sipas preventivit të rishikuar referuar volumeve faktike vlera e kontratës është 61,680,800 lekë ose 116,251 lekë më pak se ajo e ofertuar, ku këto ndryshime janë miratuar me procesverbalin përkatës.

Referuar shkresës së sipërmarrësit Nr.32prot. datë 17.04.2020 dhe nr. extra. prot datë 17.04.2020 të mbikëqyrësit të punimeve njoftohet përfundimi i punimeve ku është mbajtur edhe procesverbali përkatës.

Kolaudimi i punimeve është kryer sipas aktit datë 28.05.2020 dhe janë marrë në dorëzim të përkohshëm me aktin e administruar në bashki me Nr.1320/2Prot. datë 07.07.2022.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve“Instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengel-Samurr-Golodesh, (përzëvendësimin e pompave dhe pajisjeve)”.			
14.Lidhja e kontratës Nr.1872/8 Prot. datë 08.11.20219	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 61,797,051lekë OE “B N” sh.p.k		16.Likuiduar deri dt
17-Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 61,680,800 lekë -Vlera pa TVSH 51,400,666.66 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 45ditë, Zbatuar 60 ditë Fillimi punimeve: 05.12.2019 Përfundimi punimeve: 17.04.2020		19. Zgjatja e kontratës Amendim kontrate Nr.2959/2Prot. datë 19.12.2029
20. Mbikëqyrësi i punimeve “I.D A” sh.p.k	Licenca Nr: MK. 919/9	Kontrata Nr.2520/23Prot. datë 05.12.2019	
21. Kolaudatori i punimeve “DN CS” sh.p.k	Licenca Nr: MK.2010/5	Kontrata Nr.1972/10Prot. datë 25.05.2020	
22.Akt Kolaudimi datë 07.07.2022	23.Akt i marrjes në dorëzim Nr.1872/14Prot. datë10.06.2021		

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, të dukshme, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe shoqërisë në vlerën **449,198 lekë pa TVSH**. Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

-Në kategorinë Linja e dërgimi të ujit në tubacion çeliku për fshatrat Godolesh, është shtruar tub çeliku Ø (1433mmx7mm) me gjatësi 2794.5 m. Për shtrimin e tubit, sipas librezës së masave, janë kryer punime për zërat; Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2m, tokë e zak, kategoria III me shkarkim në tokë në volum 7479.16 m³, Nga vizita në terren u konstatua se nga seksioni CS-17 deri CS-29 tubi është shtruar përgjatë rrugëve të lagjes dhe nuk ka pasur nevojë për hapje rrugë aksesi. Në seksionin CS-29 deri CS-34 në gjatësi prej 100 ml tubi i çelikut, për kalimin e rrugës nacionale është kaluar brenda një tombino box (katrore) dhe është e dukshme

dhe nuk ka pasur nevojë për hapje rrugë aksesi. Pra për seksionin CS-17 deri CS-34 nuk ka pasur nevojë për rrugë aksesi. Referuar librezës së masave nga CS-17 deri CS-34 është kryer volum gërmimi 1592.9 m³ për rrugë aksesi e cila është përfituar më tepër nga sipërmarrësi në zërin Gërmim dhe me ekskavator me goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2m, tokë e zak, kategoria III me shkarkim në tokë kjo në vlerën 449,198 lekë pa TVSH (1592.9 m³ x 282 lekë/m³).

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i mbikëqyrësit OE "Instituti D.A." sh.p.k z. D. H. ku mospasqyrimi i saktë i volumeve të kryera në librezën e masave është në kundërshtim me:

- Kontratën e shërbimit Nr.2520/23Prot. datë 05.12.2019 me objekt: "Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengel-Samurr-Golodesh, (për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve)", konkretisht:

- Neni 8, "Detyrimet e Kontraktuesit".

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: "Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit"

-Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, ku përcaktohet se:

Pika 8.1: "Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës".

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

"3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3. Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".

3. Për objektin "KUZ Belsh Lagjia Hysë", u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis Sh. a Ujësjellës Kanalizime Belsh BOE "M" sh.p.k & "AK" sh.p.k me Nr.10/17 Prot. datë 19.04.2021.
- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;

2) *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis Sh. A Ujësjetllës Kanalizime Belsh dhe OE "H-AI" sh.p. k me Nr.12/19Prot. datë 12.04.2021.*

- *Korrespondencat mes Sh. A Ujësjetllës Kanalizime Belsh dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE "H-AI" sh.p.k.*

Kontratat

Punimet janë kryer sipas kontratës, për punë publike me Nr.10/17 Prot. datë 19.04.2021 me objekt "KUZ Belsh Lagjia Hysë" të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Sh. a Ujësjetllës Kanalizime Belsh, të përfaqësuar nga Administratori z. O. T. dhe BOE "M." sh.p.k & "A K" sh.p.k të përfaqësuar nga administratorët z. E.B dhe A.K me licenca profesionale NZ.6803/6. Vlera e kontratës është 65,771,020 lekë pa TVSH ose 78,925,224 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës kjo e përcaktuar në DST dhe punimet do të fillojnë kur të vendoset leja në dispozicion.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.12/19Prot. datë 01.04.2021 me OE "H.-A." sh.p. k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2191/3, si dhe me vlerë të kontratës 1,297,879 lekë pa TVSH ose 1,557,455 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.09/7Prot. datë 15.04.2022 me OE "A.MK" sh.p. k me licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2892/6 dhe me vlerë të kontratës 234,938 lekë me TVSH.

Hartimi i Projektit

Projekt zbatimi është hartuar nga BOE "H-A" sh.p. k & "SRP" sh.p.k me kërkesë të Autoritetit Kontraktor SHA Ujësjetllës Kanalizime Belsh. Projekt ka patur si synim përmirësimin e kushteve ekzistuese të rrjetit të kanalizimeve në Lagjen "Hysaj" Bashkia Belsh dhe krijimin e një rrjeti të ri KUZ pranë Liqenit të Belshit nëpërmjet krijimit të linjave të reja. Projekt parashikon F.V tuba C HDPE me dimension DN 200 – 400 mm, së bashku me elementët përkatës si, puseta, kapakë dhe lidhjet me shtëpitë (sistemi tercial). Gjithashtu është parashikuar dhe ndërtimi i dy stacioneve pompimi të cilët do të do të dërgojnë ujin e kanalizimeve me presion, në sistemin që funksionon me vetërrjedhje.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve është data 18.05.2021, kjo sipas njoftimit përkatës të bërë nga sipërmarrësi me shkresën Nr.107 Prot. datë 18.05.2021.

Referuar kërkesës së banorëve, të administruar me Nr.65Prot. datë 19.07.2021, për pezullim punimesh me arsyen se sezoni turistik dhe kthimi i emigrantëve e bën të pa mundur lëvizjen e tyre në zonë gjatë kryerjes së punimeve dhe ky pezullim të jetë për një periudhë dy mujore. Pezullimi i punimeve është bërë me procesverbalin e mbajtur më datë 19.07.2021. Pezullimi i punimeve është shoqëruar me Amendim Kontrate nr.1, me Nr. 107/3 prot. datë 19.07.2021 ku sipas nenit 3 "Afati i amendamentit të kontratës" punimet do të rifillojnë më datë 01.10.2021 dhe do të përfundojnë më datë 27.10.2021.

Banorët e zonës me kërkesën e administruar në Sh. A UK Belsh Nr.76 Prot. datë 08.10.2021 kanë kërkuar rishikimin e projektit në një zonë pasi sistemi ekzistues i kanalizimeve bllokohet dhe ti jepet një zgjidhje. Për zgjidhjen e kërkesës së banorëve punimet janë pezulluar më datë 11.10.2021 dhe është shoqëruar me Amendim Kontrate Nr.2 me Nr.107/7 Prot. datë 11.10.2021 ku sipas nenit 3 "Afati i amendamentit të kontratës" punimet do të rifillojnë më datë 22.11.2021 dhe do të përfundojnë më 07.12.2021.

Më datë 07.12.2021 është mbajtur procesverbali për shtyrjen e përfundimit të punës vetëm për lidhjen e energjisë elektrike nga OSHEE në stacionet e pompimit të ndërtuara në këtë projekt.

Pas rishikimit të projektit me procesverbalin e administruar në Sh. A UK Belsh me Nr.107/10 Prot. datë 22.1.2021 janë miratuar volumet e punimeve (+/-) të shoqëruar me tabelën e punimeve dhe preventivi i rishikuar i cili është 273,565 lekë me TVSH më pakë se ai i ofertuar.

Me shkresat Nr. 92 Prot. datë 07.01.2022 sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi me shkresën Nr.107/11Prot. datë 07.01.2022 njoftojnë përfundimin e punimeve të shoqëruar me procesverbalin përkatës me Nr.107/12Prot. datë 07.01.2022.

Kolaudimi i punimeve është kryer sipas aktit të administruar në Sh. A Ujësjiellës Kanalizime Belsh me Nr. 107/13 prot. datë 21.04.2022. Janë marrë në dorëzim të përkohshëm me aktin e administruar me Nr.107/15 Prot. datë 04.05.2022 dhe të përhershme me Nr.1986 Prot. datë 07.08.2023.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “KUZ Belsh Lagjja Hysë”.		
14.Lidhja e kontratës Nr.10/17 Prot. datë 19.04.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 78,925,224 lekë BOE “M” sh.p.k & “AK” sh.p.k	
17-Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 78,651,659 lekë -Vlera pa TVSH 65,543,049 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 234 ditë Fillimi punimeve: 18.05.2021 Përfundimi punimeve: 07.01.2022	
20. Mbikëqyrësi i punimeve “H.-A.” sh.p.k	Licenca Nr: MK.2191/3	Kontrata Nr.12/19Prot. datë 01.04.2021
21. Kolaudatori i punimeve “A MK” sh.p.k	Licenca Nr: MK.2892/6	Kontrata Nr.09/7 Prot. datë 15.04.2022
22.Akt Kolaudimi Nr. 107/13 prot. datë 21.04.2022	23.Akt i marrjes në dorëzim Nr.107/15 Prot. datë 04.05.2022 dhe Nr.1986Prot. datë 07.08.2023	
16.Likuiduar deri dt		
19. Zgjatja e kontratës Amendim Kontrate nr.1, me Nr. 107/3 prot. datë 19.07.2021. Amendim Kontrate Nr.2 me Nr.107/7 Prot. datë 11.10.2021		

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, të dukshme, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe shoqërisë në vlerën 391,990 lekë pa TVSH. Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

- Në projekt janë parashikuar që rrugët ku kryhen punimet do të kthehen në gjendjen fillestare dhe shtresat e sipërme të tyre janë parashikuar të prishen dhe të rehabilitohen me zë të veçantë në preventiv sipas An. BO1 për trotuaret e shtruara me pllaka; BO2 për rrugët e shtruara me beton; BO3 për rrugët e pa shtruara dhe BO4 për rrugët e shtruara me asfalt. Nga auditimi i librezës së masave të zërit Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale me gjerësi deri 2m, kategoria III, me shk. në mjet konstatohet se llogaritja e thellësisë së gërmimit ka përfshirë edhe trashësinë e shtresave të rrugës që janë parashikuar në analizën BO. Kështu që sipërmarrësi ka përfituar dy herë volumin e gërmimit për shtresat e rrugëve që do të kthehen në gjendjen fillestare. Konkretisht: për zërin Prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare i trotuareve me pllaka trashësia e shtresave është 0.16 m e për sipërfaqen e realizuar 400 m² volumi i tyre është 64 m³; për zërin Prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare i sipërfaqeve me beton trashësia e shtresave është 0.21 m e për sipërfaqen e realizuar 90 m² volumi i tyre është 18.9 m³; për zërin Prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare i rrugëve të pa shtruara trashësia e shtresës është 0.15 m e për sipërfaqen e realizuar 2292 m² volumi i tyre është 343.8 m³, pra në total 426.7 m³. Për sa më sipër sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin e punimeve prej 426.7 m³ në zërin Gërmim dheu me

ekskavator goma 0.25 m³, në kanale me gjerësi deri 2m, kategoria III, me shk. në mjet në vlerën 145,075 lekë pa TVSH (426.7 m³ x 340 lekë/m³).

Mbushja e kanaleve është kryer me rërë, material të dalë nga gjermimi, material të importuar dhe kthimi i shtresave të prishura në gjendjen fillestare. Referuar librezës së masave konstatohet se mbushja e kanalit me rërë, material të dalë nga gjermimi dhe material të importuar është sa volumi i gjermimit pa zbritur volumin e shtresave që janë prishur e kthyer në gjendjen fillestare. volumi i shtresave të prishura dhe të kthyer në gjendjen fillestare në total është 446.7 m³, kështu që sipërmarrësi ka përfutur më tepër volumin e shtresave në zërin Mbushje me material të dalë nga gjermimi, pasi kjo shtresë është variabël sipas thellësisë së gjermimit, në vlerën 201,015 lekë pa TVSH (446.7 m³ x 450 lekë/m³)

-Në kategorinë Lidhjet e shtëpive, është realizuar volum punimesh 900 m² për zërin Prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare i rrugëve të pa shtruara me trashësi 0.15 m me volum të tyre 135 m³ (900 m x 0.15 m x 1 m) ku sipas librezës së masave është e llogaritur edhe në zërin Gjermim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale me gjerësi deri 2m, kategoria III, me shk. në mjet. Pra volumi i gjermimit të shtresave që kthehen në gjendjen fillestare prej 135 m³ duhet të zbritet nga volumi total i gjermimit të cilin sipërmarrësi e ka përfutur në zërin Gjermim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale me gjerësi deri 2m, kategoria III, me shk. në mjet kjo në vlerën 45,900 lekë pa TVSH (135 m³ x 340 lekë/m³).

4. Mbi auditimin e kontratës së punimeve civile “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit në Fshatin Zgosht, Bashkia Librazhd”.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike dhe verifikimi i punimeve në objekt konstatohet: Kontrata e punimeve civile “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit në Fshatin Zgosht, Bashkia Librazhd”, është nënshkruar me nr. 166 prot., datë 04.05.2021, ndërmjet Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” Librazhd dhe OE “K.” SHPK, me vlerë 31,101,010 lekë me TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 53 ditë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria “ZK” SHPK. Kontrata është amenduar me nr. 166/1 prot., datë 30.06.2021, sa i takon afatit. Në këtë amendim përcaktohet se në rast të pezullimit të punimeve, afati i realizimit zgjatet me periudhën e pezullimit.

Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, punimet kanë filluar me datë 05.05.2021. Leja e infrastrukturës është lëshuar nga Bashkia Librazhd me nr. 467, datë 03.02.2022, pas fillimit të zbatimit të kontratës.

Pas azhurnimit të volumit të punimeve, kanë rezultuar diferenca të volumeve të parashikuara nga ato të rezultuar në fakt me shtesa dhe pakësime, për të cilat janë hartuar procesverbalet përkatëse si dhe është miratuar preventivi i rishikuar i punimeve. Po ashtu, është autorizuar përdorimi i fondit rezervë. Ndryshimi i volumeve është shoqëruar edhe me shtesë të një zëri të ri të punimeve konkretisht “F.V Tub PE 20 mm”, për të cilin çmimi i aplikuar është bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2025 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Gjatë zbatimit të kontratës, punimet janë pezulluar si pasojë e vonesës në marrjen e lejes nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për ndërhyrjet në rrugën nacionale, për shtrirjen e tubacionit si dhe leje ndërtimi për ndërtimin e dhomës së manovrimit. Për këtë arsye, bazuar në procesverbalin përkatës, punimet janë pezulluar me datë 28.06.2021. Autoriteti Rrugor Shqiptar ka dhënë autorizimin për kryerjen e punimeve të projektit, me shkresë me nr. 4034/1 prot., datë 28.03.2022. Pas marrjes së lejes përkatëse, bazuar në shkresën e Kontraktorit nr. 6/4 prot., datë 06.04.2022, punimet kanë rifilluar në këtë datë.

Nga auditimi konstatohet se, si pasojë e mos marrjes së masave në kohën e duhur për marrjen e lejeve përkatëse, zbatimi i kontratës dhe investimit në tërësi është vonuar për një periudhë 10 muajore.


Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur me datë 05.05.2022. Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë me shkresë nr. 7 prot., datë 05.05.2022. Kolaudimi i punimeve është bërë me datë 18.10.2022, nga Shoqëria “N - G” SHPK. Certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm të punimeve është lëshuar me datë 27.10.2022, nga komisioni i përbërë nga znj. M. B, z. I.Ç dhe z. G.Xh.

Nga auditimi i dosjes teknike, konkretisht librit të masave, u konstatua se për punimet sipas zërit “F.V tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=20 mm, PN 10”, nuk është detajuar sasia e raportuar sipas lidhjeve të shtëpive, por është paraqitur vetëm sasia totale në masën 2370 ml, duke krijuar vështirësi për identifikimin e sasisë së vendosur sipas lidhjeve përkatëse. Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu III, pika 4, ku përcaktohet: *“Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre”*. Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria “Z.K.” SHPK.

Me datë 02.04.2024, me prezencën e z.L.H përfaqësues i Shoqërisë “Z” SHPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, u verifikuan disa zëra të punimeve të realizuara në objekt. Verifikimi u realizua kryesisht për punime të cilat janë të dukshme, siç janë punimet në ndërtimin e dhomes së komandimit, punimet për realizimin e rrethimit të depos, punime për ndërtimin e pusetave, punime për realizimin e shtresës së betonit në trotuar, disa pika lidhje shtëpiake etj., nga ku u konstatuan mangësi si më poshtë:

Sipas zërit I.4.5 “F.V portë metalike, profili tub (40 mm x 40 mm x 2mm)”, u konstatua se porta është ndërtuar me profile hekuri ndërtimi, pa respektuar asnjë kusht teknik, si dhe pa respektuar specifikimet teknike. Vlera për këtë zë punimi në shumën **50,600 lekë**, është certifikuar padrejtësisht.

Më poshtë paraqitet projekti i ndërtimit të portës, si dhe realizimi në fakt.



Sipas zërit II.3.7 “Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm, me makineri është certifikuar sasia 25 m², me çmim 1,550 lekë/m². Nga verifikimi i punimeve në objekt, kjo shtresë rezulton e pa realizuar. Vlera **38,750lekë** (25 m² x 1,550 lekë/m²), është certifikuar padrejtësisht.

Sipas zërit II.3.8 “Shtresë asfaltbetoni me granil gur kave, 4 cm, me makineri”, është certifikuar sasia 25 m², me çmim 1,350 lekë/m². Nga verifikimi i punimeve në objekt, kjo shtresë rezulton e pa realizuar. Vlera **33,750 lekë** (25 m² x 1,350 lekë/m²), është certifikuar padrejtësisht.

Sipas zërit I.4.2 “Struktura monolite betoni C 20/25, kolonat + themeli”, u konstatua se kolonat e rrethimit nuk janë vendosur me dimension 10 cm x 10 cm, por 7 cm x 7 cm. Vendosja e kolonave jo në dimensionet e përcaktuara, ndikon në qëndrueshmërinë e vetë rrethimit.

Më poshtë paraqitet, mungesa e këtyre shtresave.



Sa i përket shtresave asfaltike, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve theksohet se është bërë realizimi i tyre, por ato janë dëmtuar nga lëvizja e automjeteve të tonazhit të madh në segmentet rrugore përkatëse. Sqarojmë se, në rastin e realizimit të tyre sipas kushteve teknike të zbatimit, specifikimeve teknike përkatëse, shtresat duhet të ishin të qëndrueshme, pasi janë parashikuar në përputhje me shtresat e rrugës, në të cilën është bërë ndërhyrja për vendosjen e tubacioneve.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, ku përcaktohet: “...Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit...”.

- Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. Në lidhje me mangësitë e konstatuara, theksojmë se, mos ndërtimi i kolonave të rrethimit në dimensionet e duhura ndikon në qëndrueshmërinë e vetë rrethimit.

Mos realizimi i shtresave të asfaltobetonit krijon vështirësi për përdoruesit e rrugës dhe ndikon në dëmtimin e mëtejshëm të shtresave asfaltike në trupin e rrugës ku është bërë ndërhyrja për vendosjen e tubacionit.

Mos ndërtimi i portës së hyrjes sipas specifikimeve teknike, krijon problematika në hyrjen e daljen e automjeteve dhe ul sigurinë e veprës.

Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria “ZK” SHPK.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Asambletë e aksionareve të UK Elbasan, UK Librazhd, UK Gramsh, UK Peqin, UK Cërrik, dhe UK Belsh, kanë autorizuar administratorët përkatës, si përfaqësues të shoqërive në cilësinë e transferuesit dhe për nënshkrimin e aktit të transferimit të plotë të veprimtarisë së ujësjellësve rajonalë në shoqërinë e re të krijuar, bazuar në bilancin e datës 31.12.2021 si dhe duke reflektuar ndryshimet respektive të datës efektive të transferimit.

Në procedurat e ndjekura për transferimin e aktiveve, të drejtave, detyrimeve, etj., të ish shoqërive UK Elbasan, UK Librazhd, UK Gramsh, UK Peqin, UK Cërrik, dhe UK Belsh, te shoqëria e re që

ka përthithur këto ish shoqëri, dokumentet vërtetuese të këtij procesi janë me mangësi, pasi nuk kanë të dhëna të plota e të sakta për të përshkruar me vërtetësi treguesit sasior dhe të vlerës, fletëdaljet, proces verbalët e dorëzimit etj.

Faturat janë përpiluar në përshkrimin e mallit në përgjithësi, me përshkrimin si transferim inventarësh afatgjatë, afatshkurtër, inventar i imët etj., duke mos pasur lista analitike të aktiveve me përshkrim të saktë të vendndodhjes, gjendjes të kushteve të punës, datës së hyrjes si aktiv, vlerës fillestare, riparimeve të ndryshme, vlerës së mbetur, rivlerësime të kryera.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 101.

Grupit të auditimit nuk ju paraqitën dokumente për veprimet e marra nga ish titullarët e UK rajonale, në lidhje dorëzimin e aktiveve të SHRUKË. Gjithashtu shoqëria e re e krijuar SHRUK Elbasan nuk paraqiti dokumente që të vërtetojë se ka marrë në dorëzim aktivet nga ish shoqëritë e UK rajonale. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, rubrika “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, pikat 34 deri 41, rubrika “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, pikat 42 deri 50 dhe 52 deri 60. Veprimet sa më sipër rrisin riskun e menaxhimit të aktiveve nga shoqëria mëmë, sepse mungojnë të dhënat e sakta për objektet në pronësi, pajisjet teknologjike, linjat e ujësjellësve, etj (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-80, të Raportit të Auditimit*)

1.1. Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë, të marrin masa për vlerësimin e gjendjes së aktiveve si ndërtesa, linja ujësjellësi, pajisje teknologjike, etj., duke plotësuar informacionet për to në lidhje me vendndodhjen, datën e hyrjes, vlerën fillestare, riparimet e kryera, vlerën aktuale, mirëmbajtjet e kërkuara, dhe investimet e nevojshme kërkuara me qëllim përmirësimin e strukturës së tyre, duke plotësuar me besueshmëri dhe saktësi regjistrin e aktiveve të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare ish shoqëritë UK Belsh, Cërrik, Gramsh, Librazhd, dhe Peqin, janë mbështetur në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, duke mos zbatuar SNRF-të. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, në nenin 3, neni 5 gjithashtu në nenin 26 Inventari, llogaritë vjetore, të Vendimit nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-80, të Raportit të Auditimit*)

2.1. Rekomandim: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, pasqyrat financiare të hartohen duke zbatuar standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, duke bërë të mundur që informacionet të jenë të krahasueshme me shoqëritë e tjera të sektorit, si dhe në përputhje me formatet e palëve të treta.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Shoqëritë UK Elbasan SHA, UK Librazhd SHA, UK Gramsh SHA, UK Cërrik SHA, UK Belsh SHA dhe UK Peqin SHA, nuk kanë kryer zhvlerësimin e aktiveve financiare të shoqërisë. Në fund të çdo periudhe raportimi, çdo shoqëri duhet të vlerësonte nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, shoqëritë duhet të njohin menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje. Mos kryerja e zhvlerësime të aktiveve financiare sjell paraqitje jo të besueshme të situatës ekonomike të institucionit.

Në zërin kërkesa të arkëtueshme, klientë të SHRUK Elbasan SHA, përveç detyrimeve të cilat po ndiqen me veprime administrative dhe ligjore, ka dhe zëra debitorë të tjerë për të cilët nuk disponohen dokumente të mjaftueshëm justifikues për ndjekje ligjore. Gjithashtu në këtë zë ka dhe vlera materialisht të vogla për të cilat nuk është efektive për ndjekje në organet gjyqësore. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit, të aplikuar nga shoqëria, SKK3, “Instrumentet Financiare”, pika 22 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-80, të Raportit të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë të marrin masa që sektori i financës gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe të pasqyrojë njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i gjendjes debitorë në sistemin tatimor më datë 31.12.2023 u konstatua se ish shoqëritë UK Librazhd-Prrenjas, UK Peqin, UK Belsh, edhe pse sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët e shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, rubrika e bashkimit të shoqërive, nenet nga 216 deri më 226, e kanë mbyllur veprimtarinë e tyre, përpara mbylljes nuk kanë shlyer të gjitha detyrimet ndaj drejtorive rajonale tatimore përkatëse. Ish UK Librazhd-Prrenjas ka detyrime në vlerën 89,416 lekë nga të cilat 79,435 lekë janë për tatimin mbi fitimin dhe 9,981 lekë janë për tatimin e mbajtur në burim. Ish UK Peqin ka detyrime në vlerën 9,219,307 lekë për tatimin mbi vlerën e shtuar si pasojë e mos regjistrimeve të kryera në periudhën përkatëse. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët e shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-80, të Raportit të Auditimit*)

4.1. Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë të marrin masa për vlerësimin e detyrimeve të vendosura nga organet tatimore, duke gjykuar nëse vlerësimet e lëna nga inspektorët janë të drejta apo apeluese, si dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse, për detyrimet që ekzistojnë ndaj organeve tatimore. Nëse detyrimet janë të pa apeluese, të merren masa për pagesat e detyrueshme ndaj organeve tatimore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në hartimin e pasqyrave financiare ish shoqëritë UK Belsh, Cërrik, Gramsh, Librazhd, dhe Peqin, kanë përllogaritur shpenzime nga amortizimi i aktiveve afatgjata. Në shënimet shpjeguese nga drejtimi i shoqërive nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme së AAM-ve, pra-normat e amortizimit të aplikuar në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore.

-Duke mos përdorur norma menaxheriale amortizimi të mirë-argumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, rritet risku për të mos kryer me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja e kanalizime të reja, dhe impiante, nga shoqëritë nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-80, të Raportit të Auditimit*)

5.1. Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë të marrin masa që në të ardhmen, hartimi i pasqyrave financiare të kryhet me përgjegjshmëri dhe besueshmëri. Drejtimi i shoqërisë të marrë masa në të ardhmen, për përcaktimin e sistemeve dhe procedurave për zëvendësimin/shtimin e aktiveve afatgjata. Jetëgjatësia e aktiveve të përcaktohet mbështetur në manualët përkatëse, ekspertiza të specialistëve të fushës, me përgjegjshmëri dhe besueshmëri dhe bazuar në aktivet që disponon shoqëria.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Shoqëritë UK Elbasan SHA, UK Librazhd SHA, UK Gramsh SHA, UK Cërrik SHA, UK Belsh SHA, dhe UK Peqin SHA, nuk kanë plotësuar regjistrin e aktiveve që kanë në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër. Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se institucioni nuk ka mbajtur regjistrin e aktiveve, duke vepruar në kundërshtim me pikën 30 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Mos plotësimi i regjistrin të aktiveve sjell risk i lartë për ekzistencën e tyre, nga keqpërdorimi, humbja, vjedhja, shkatërrimi dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-80, të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë si dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për plotësimin e regjistrin të aktiveve që zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i pagesave të furnitorëve u konstatua se nga departamentet Ekonomik dhe të Financës nuk ishin likuiduar faturat e Furnizuesit të Shërbimit U SHA, për energjinë elektrike. Nëpunësi Zbatues nuk kishte plotësuar relacionet e shpjegimet përkatëse për rrethanat e mos pagesave. Nga Nëpunësi Autorizues nuk janë ngritur dhe miratuar procedura të monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të pasur gjurmën e auditimit, garancinë për pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë si dhe për të dokumentuar që pagesat kryhen sipas skadencave kronologjike. Pajisja me sistem të monitorimit të skadencave të detyrimeve të pagueshme, ul riskun e shoqërisë për krijimin e penaliteteve për mos pagesa në afat. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nenet 1 e 12 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-80, të Raportit të Auditimit)*

7.1. Rekomandim: Nga administratori i shoqërisë të merren masa për të ngritur dhe miratuar procedura mbi monitorimin e afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve sipas kontratave përkatëse. Ky sistem do të shërbej për uljen e riskut të shoqërisë për krijimin e penaliteteve, për mos pagesa në afat dhe vlerësimin e gjurmës së auditimit për korrektësinë e veprimeve të Nëpunësit Zbatues.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Shoqëritë UK Elbasan sh. a, UK Librazhd SHA, UK Gramsh SHA, UK Cërrik SHA, UK Belsh SHA dhe UK Peqin SHA, kanë në zotërim objekte, troje, ndërtesa, depo uji, ujësjellës etj, për të cilat nuk disponojnë certifikatat e pronësisë.

Drejtuesit dhe personat përgjegjës për regjistrimin e pasurive të këtyre ish shoqërive, nuk kanë marrë masa konkluduese për përfundimin e procesit të marrjes së certifikatave të pronësisë në ASHK (ISH ZRPP).

Kjo ka bërë që llogaritë përkatëse të AAGJ në pasqyrat financiare, të mos pasqyrojnë vlerën e saktë të pasurisë së shoqërive, pasi asetet e pa regjistruara nuk pasqyrohen në këto pasqyra, në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr. SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, i përmirësuar, pika 8, shkronja a.

Mungesa e veprimeve për regjistrimin e pasurive të paluajtshme rrit riskun për humbjet në aktivet e shoqërisë dhe është në kundërshtim me pikën 5 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar,

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-80, të Raportit të Auditimit)

8.1. Rekomandim: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë të ndërmerren hapa konkretë për regjistrimin dhe certifikimin e pronave të paluajtshme dhe investimeve të kryera, duke ndikuar në uljen e riskut të humbjeve të aktiveve të shoqërisë.

Brenda 31.12.2024

9. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e vëna në dispozicion për llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme konstatohet se: Situata e llogarive të pagueshme paraqitet e rënduar, me detyrime për furnitorë në vlerën 1,174,224,406 lekë, ku 996,730,000 lek janë detyrime ndaj FSHU, të mbartura nga ish UK rajonale, si dhe një pjesë të madhe furnitorë të mbartur. Vlera e detyrimit ndaj FSHU përmban vetëm principalin si detyrim. Shoqëria nuk ka përfshirë dhe vlerën prej 986,097,000 lekë kamatë-vonesa në zërin e detyrimeve. Në llogaritë për tu paguar rezultojnë detyrime për të tretë që mbulohen me fonde të Buxhetit të Shtetit, në vlerën 375,635,000 lek, ku vlerën më të madhe e ka S.AG me 312,299,000 lekë. Në llogarinë 467 me vlerë 176,358,368 lekë, shoqëria ka kontabilizuar detyrimet ndaj bashkive për taksën që mbledh për llogari të tyre, vlera këto të mbartura në bilanc nga ish UK rajonale.

Situata ekonomiko financiare e shoqërisë nuk është e mirë. Shoqëria e re e krijuar ka mbartur nga ish UK rajonale vlera të konsiderueshme detyrimesh, të cilat tejkalojnë shumë herë llogaritë e arkëtueshme *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-80, të Raportit të Auditimit)*

9.1. Rekomandim: Këshilli i Mbikëqyrjes dhe administratori i SHRUK Elbasan SHA,, të vlerësojnë me prioritet situatën e llogarive të arkëtueshme të shoqërisë, të kryejë një analizë objektive të të gjithë abonentëve debitorë, të ri-konfirmojë ekzistencën e tyre, të specifikohen grupet kryesore dhe të ndërmarrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA nuk ka mbajtur regjistër të pjesëmarrjes së anëtarëve në mbledhjet e organizuara prej tij, i cili mbahet dhe duhet të nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e pranishëm, veprime në kundërshtim me *Statutin e Shoqërisë Neni 14, pika 6.*

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të SHRUKE SHA nuk kanë nënshkruar kontratë pune me shoqërinë, në të cilën duhet të parashikohen ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit në terma vjetor, në kundërshtim me *Statutin e Shoqërisë Neni 12, pika 3.* Në procesverbalet e mbajtura nga Sekretari i Këshillit Mbikëqyrës për mbledhjet e organizuara, mungon përshkrimi për çështjet e diskutuara prej anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje, veprime në kundërshtim me *Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Neni 161, pika 1 (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 13-16, të Raportit të Auditimit).*

10.1. Rekomandim: Sekretari i Këshillit Mbikëqyrës i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA të marrë masa për mbajtjen e regjistrit të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili të nënshkruhet nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Të pajisen të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës me kontrata pune ku të jenë të parashikuara kriteret e performancës që pritet të arrijë

anëtari i Këshillit në terma vjetor, si edhe të dokumentohen në procesverbal të gjitha diskutimet që bëhen nga secili anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, me qëllim sigurimin e transparencës së vendimmarrjeve.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara në vitet 2020 - 2021, në të gjitha rastet është konstatuar se nuk mungojnë ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomik për pjesëmarrje në procedurë në kundërshtim me pikat 7,9 të Udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 të APP-së “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël anëtarët e komisioneve nuk kanë firmosur deklaratat e pavarësisë, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Neni 19 “Konflikti i Interesit”.

- në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nuk është evidentuar përllogaritja e fondit limit, në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara në vitin 2022, në dosjen e prokurimit është procesverbali për përllogaritjen e fondit limit por nuk është dokumentuar mënyra e përllogaritjes. Nga auditimi u konstatua se në asnjë nga procedurat e prokurimit për të tre vitet 2020-2022 nuk janë nxjerrë urdhra për krijimin e komisionit të marrjes në dorëzim, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42. Në asnjë rast nuk është bërë inventarizimi i dosjes së prokurimit me vlerë të vogël, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 19 si dhe me germën (g), të nenit 8. Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara në Njësinë Peqin për vitin 2020 nuk janë lidhur kontratat e shërbimit mes OE të shpallur fitues dhe AK (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 44-73, të Raportit të Auditimit).

11.1. Rekomandim: Shoqëria Rajonale e Ujësjetës Kanalizime Elbasan SHA, të analizojë mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në njësitë e UK, në lidhje me procedurat e kryera për “Blerjet me vlera të vogla” duke filluar me kërkesat për blerje dhe shërbime nga njësitë dhe degët, llogaritjen e vlerës së kontratës, hartimin e dokumentacionit dhe specifikimeve teknike, me qëllim arritjen e prokurimit me efektivitet, cilësi dhe në funksion të kryerjes së punëve dhe shërbimeve.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e SHRUKE SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr me dokumentacion justifikues, mungojnë urdhër shërbimet si edhe programet e punës.

-Automjetet e SHRUKE SHA, janë pjesërisht të pajisura me sistemin GPS, nuk kontrollohen km e përshkuar referuar normativave të harxhimit të përcaktuara nga patenta shoqëruese e mjeteve dhe për mjetet e përdorura nuk janë të miratuara normativat e konsumit/100km.

- Nga verifikimi i gjendjes së karburantit sipas evidencës nga programi “Alpha Platinum” dhe të dhënave nga kartelat e shërbimit të transportit, në datën 04.04.2024, në zyrën e financës në SHRUK SHA për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 nuk rakordon sasia e karburantit midis drejtorisë Tregtare dhe asaj të Transportit në SHUKRE SHA për vitin 2023, nuk dokumentohet me fletë-kërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës sasia prej 647 litra, (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 44-73, të Raportit të Auditimit).

12.1. Rekomandim: Administratori i Shoqërisë të marrë masa për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë mjete në ngarkim) i cili të kryejë ekzaminimet teknike

dhe të përcaktojë gjendjen teknike të mjeteve dhe të caktojë normativat mbi konsumin e karburantit për mjetet që ushtrojnë aktivitetin në Shoqëri pa normativa të miratuara.

12.2. Rekomandim: Drejtoria Tregtare dhe Drejtoria e Transportit të hartojnë kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

12.3. Rekomandim: Drejtoria Tregtare dhe Drejtoria e Transportit të marrë masa të menjëhershme për hartimin e rregullave në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet, makineritë - pajisjet e shoqërisë si dhe të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas njësive, pajisjen e gjithë automjeteve me GPS.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Dokumentacioni bankar në SHRUKE SHA nuk është e saktë, i plotë, i besueshëm dhe nuk justifikon në mënyrë të plotë shpenzimet dhe të ardhurat, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 34, pika 36, dhe pika 37 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 44-73, të Raportit të Auditimit*).

13.1. Rekomandim: Drejtoria Tregtare të marrë lidhur me plotësimin e dokumentacionit të plotë bankar për çdo shpenzim të kryer dhe çdo të ardhur, në mënyrë të plotë, të saktë dhe të besueshme.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të 46 procedurave të blerjeve me vlera të vogla u konstatuan parregullsi procedurale, në 10 procedura nuk janë lidhur kontratat mes palëve, në 14 procedura nuk janë ngritur komisionet e marrjes në dorëzim, në 17 procedura në dosje mungon fatura tatimore, në 2 procedura nuk janë përlllogaritur vlerat i fondit limit, në 5 procedura nuk janë ngritur komisionet e kolaudimit, në 5 raste nuk janë hartuar specifikimet teknike dhe në 2 procedura të blerjes të hipokloritit të natriumit nuk janë planifikuar saktë sasitë e nevojshme të blerjes dhe nuk është zbatuar plani i lëvrimin, në kundërshtim me pikën 5, të Udhëzimit nr.3, datë 08.01.2018 të APP-së “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42.

-Në Njësinë e Ujësjellës Kanalizime Gramsh për vitin 2022 janë kryer 5 procedura prokurimi me objekt të njëjte prokurimi, “Blerje materiale hidraulike” me vlerë totale 1,263,899 lekë pa TVSH. Nga auditimi i këtyre procedurave konstatohet se Autoriteti Kontraktor për vitin 2022 ka copëzuar fondin limit, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e efijencës në përdorimin e këtyre fondeve, në kundërshtim me nenin 97, 98, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 12, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 44-73, të Raportit të Auditimit*).

14.1. Rekomandim: Administratori i shoqërisë të analizojë situatën e krijuar të marrë masa që në të ardhmen, blerjet e vogla të hartohen e të kryhen sipas kërkesave dhe nevojave të veprimtarisë së saj duke shmangur kostot shtesë që mund të rëndojnë në buxhetin e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në njësitë e Ujësjellës Kanalizime Elbasan, Peqin, Gramsh, Belsh, Librazhd dhe Cërrik, për hartimin dhe realizimin e programit ekonomik, konstatohet se për vitet 2020-2022 shoqëritë me të ardhurat e realizuara nuk kanë mbuluar koston duke rritur humbjet çdo vit. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura, shoqëritë kanë performuar dobët në nivelin 80%, si UK Gramsh 76%, UK Peqin 39%, UK Belsh 53%, UK

Cërrik 22% dhe UK Elbasan 68%. Janë konstatuar tejkalime të theksuara të disa zërave të shpenzimeve dhe mosrealizim të të ardhurave me tregues negativ në rritje nga njëri vit në tjetrin. Mungojnë kërkesat nga degët si për shpenzime karburanti, kosto e punës, kosto të tjera, kosto e riparimit, etj., nga shoqëria UK Cërrik nuk janë planifikuar shpenzimet për energjinë elektrike, si një nga zërat kryesor të shpenzimeve shpenzim i cili nga viti në vit ka ardhur në rritje.

-Programet e zhvillimit të shoqërisë pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës nuk janë miratuar nga Ministria përgjegjëse për ekonominë.

-Shoqëritë e UK kanë përfituar subvencion nga shteti për mbulimin e shpenzimeve të energjisë dhe nuk kanë marrë mendimin e Ministrisë përkatëse për vazhdimin e procedurave të miratimit të programeve ekonomikë.

-Zërat e shpenzimeve nuk janë planifikuar bazuar në rezultatet e vitit paraardhës dhe mungon analiza ekonomike për rezultatet e arritura. Në hartimin dhe miratimin e programeve ekonomikë të shoqërive nuk janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 dhe 4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 16-30, të Raportit të Auditimit*).

15.1.Rekomandim: Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës Kanalizime Elbasan, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria Tregtare, të analizojnë treguesit ekonomik - financiar, rezultatet e arritura nga Njësitë e Ujësjiellës Kanalizime Elbasan, Peqin, Gramsh, Belsh, Librazhd dhe Cërrik, të evidentojnë mangësitë në tejkalimin e disa zërave të shpenzimeve, për të hartuar programe ekonomik sa më real me qëllim uljen e koston dhe rritjen e të ardhurave.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Për hartimin e programit ekonomik të vitit 2023, nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime, Elbasan (SHRUK) nuk është ngritur grup pune për vlerësimin e rezultateve pozitive/negative nga 6 njësitë e UK me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara nga organet drejtuese dhe minimizimin e humbjeve, pra mungon analiza ekonomike për rezultatet e arritura. Në lidhje me realizimin Plan - Fakt të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, të ardhurat janë realizuar në masën 98 % të planit dhe shpenzimet në masën 100% të planit. Megjithëse të ardhurat janë realizuar në masën 98%, niveli i mbulimit të koston është tejet i ulët krahasuar edhe me kërkesat e përcaktuara në “Strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitet 2022-2030”, ku për vitin 2023 ky tregues parashikohet në nivelin 90%. Kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 68% nga të ardhurat e vitit 2023, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 60%, pra, shoqëria paraqet një performancë të dobët të aktivitetit të saj.

Referuar plan - biznesit të zhvillimit të shoqërisë për vitet 2023-2027, efikasiteti i personelit parashikon ulje të vazhdueshme nga viti në vit të numrit të personelit arritjen e numrit të punonjësve 6/1000 lidhje aktive, tregues i cili nuk është arritur. Për vitin 2023 konstatohet se kosto e personelit zë 62% të koston totale. Uji pa të ardhura është në nivelin 72%, ka një normë në rritje krahasuar me rezultatet e 6 njësive për vitet 2020, 2021 dhe 2022 si edhe me kërkesat e përcaktuara në “Strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitet 2022-2030” ku për vitin 2023 ky tregues parashikohet në nivelin 60%.

-Të ardhurat (faturim) janë parashikuar me rritje 14.7% në raport me vitin 2022 - 2023 në nivelin prej 637,4 milion lekë. Fakti i vitit 2023 është 564.3 milion pra në masën 89% e parashikimit ose në vlerën (- 73.1) milion lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Kreu III, Udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6,

Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 16-30, të Raportit të Auditimit).

16.1. Rekomandim: Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Elbasan, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria Tregtare, të analizojnë treguesit ekonomik - financiar dhe rezultatet e arritura në vitin 2023, për të hartuar programe ekonomik referuar mundësive dhe shfrytëzimin e kapaciteteve të shoqërisë duke synuar uljen e kostos, minimizimin e humbjeve, rritjen e të ardhurave me qëllim përmirësimin e performances së saj, arritjen e objektivave të përcaktuara nga organet drejtuese si edhe kërkesat e përcaktuara në “Strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitet 2022-2030”.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Shoqëritë e Ujësjellës kanalizime në planifikimin e nevojave për punonjës nuk kanë mbajtur në konsideratë treguesit e një viti më parë por çdo vit numri punonjësve është planifikuar me rritje krahasuar me planin dhe faktin e vitit paraardhës, pa shoqëruar me një analizë për nevojat në rritje me burime njerëzore në kushtet kur shoqëritë e UK paraqiten me humbje të theksuara dhe subvencionim nga shteti. Për vitin 2021, numri i punonjësve është planifikuar 765 persona, ndërsa fakti i vitit 2020 është 684, për vitin 2022, numri i punonjësve është planifikuar 811 persona, ndërsa fakti i vitit 2021 është 746 dhe për vitin 2023, numri i punonjësve është planifikuar 824 persona, ndërsa fakti i vitit 2022 është 806 punonjës. Planifikimi i nevojave për punonjës nuk është kryer bazuar në strukturën sipas nevojave dhe mundësive financiare të shoqërisë. Nga viti në vit numri i punonjësve të miratuar ka ardhur në rritje me mesatarisht +40 punonjës dhe për këtë nuk jepen argumente ekonomikë për faktorët që kanë ndikuar në rritjen e numrit të punonjësve.

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Elbasan, është e organizuar me 6 Njësi, 3 Departamente, 9 drejtori dhe 26 sektorë.

Megjithëse është rritur numri i shërbimeve, konstatohet rritje e numrit të punonjësve si në përbërje të Kabinetit ashtu edhe në Njësi, Drejtori dhe Sektorë.

-Në vendimet e Këshillit Mbikëqyrës për miratimin e strukturës dhe organigramës është përcaktuar struktura sipas drejtorive, sektorëve, etj, por nuk është caktuar niveli i arsimimit dhe profesioni që duhet të ketë punonjësi sipas vendit të punës.

-Në përcaktimin e nivelit të pagave ka diferencime pa u bazuar në legjislacionin në fuqi. Përcaktime të pagave jo sipas vërshtirësisë, ngarkesës dhe rëndësisë në vendin e punës si edhe diferenca midis pozicionit Drejtor dhe specialist. Diferencime në përcaktimin e nivelit të pagave për punë dhe vend pune të njejtë, ku për pozicione të njëjta ka nivele të ndryshme page duke treguar sjellje preferenciale për njërin apo tjetrin punonjës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kodin e Punës, Neni 115, “Barazia në shpërblim”(ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015)

-Nuk është ngritur grup pune nga shoqëria ku ti propozohet Këshillit niveli i pagave dhe pagat për çdo pozicion pune, për elementët që përbëjnë pagën si niveli arsimor, vjetërsia në punë, vështirësia, etj, por pagat janë caktuar apriori dhe janë miratuar në Këshillin Mbikëqyrës. Nga sektori financës nuk është mbajtur libri i pagave të punonjësve. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 21 “Forma e kontratës së punës” (Elementët përbërës të pagës), neni 109/1 “Paga”, neni 119 “Përlllogaritja e pagës” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-44, të Raportit të Auditimit).

17.1.Rekomandim: Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Elbasan, Këshilli Mbikëqyrës, Drejtoria Tregtare dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në planifikimin e nevojave për punonjës të analizojnë dhe hartojnë strukturën sipas nivelit të arsimimit dhe profesionit që duhet të ketë punonjësi me vendin e punës, të marrë masa për shkurtrimin e numrit të punonjësve, rritjen e

efikasitetit të burimeve njerëzore si edhe përcaktimin e nivelit të pagave referuar legjislacionit në fuqi dhe mundësive financiare të shoqërisë, në kushtet ku shoqëria paraqitet me humbje të theksuara dhe subvencionim nga shteti.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Rekrutimi i punonjësve nuk është kryer sipas procedurave të përcaktuara që nga njoftimet, aplikimet, paraqitja e dokumentacionit dhe vlerësimi nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Nga SHRUKE, nuk janë përcaktuar kriteret dhe hapat e nevojshëm për rekrutimin e punonjësve. Mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Evidentohet mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Elbasan, si edhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-44, të Raportit të Auditimit*).

18.1. Rekomandim: Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Elbasan, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ngritjen e komisionit për rekrutimin e punonjësve të rinj dhe të miratojë procedurat për rekrutimet e punonjësve duke përcaktuar nevojat për punonjës, kriteret, profesionin, arsimin, afatet, etj, si edhe të bashkëpunojnë me Zyrën e Punësimit Elbasan, me qëllim punësimin e specialistëve për rritjen e cilësisë së shërbimit.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave në 2 raste konstatohet se ka mospërputhje të datës së emërimit me datën e paraqitur në listë prezencën nga drejtoria përkatëse, si psh. në sektorin e taskë forcës në listë prezencën e UK Elbasan për muajin Maj dhe Qershor të vitit 2022, evidentohet se 1 punonjës është shtuar në listë prezencën e 2 muajve me shkrim dore dhe jo nga shefi i taskë forcës, i cili ka paraqitur prezencën mujore për 7 punonjës.

-Referuar urdhrin nr. extra, datë 09.05.2022, të Administratorit “Për emërim në detyrë” është emëruar znj. G.Ç në detyrën “Përgjegjëse Auditit”, marrëdhëniet financiare fillojnë më 10.05.2022, me urdhrin nr.180, datë 16.08.2022, ka kaluar nga përgjegjës auditit - përgjegjës në Sektorin e Taskë Forcës me urdhrin nr.188, datë 07.09.2022, znj. G.Ç ka kaluar nga përgjegjës në Sektorin e Taskë Forcës në specialist në sektorin e taskë forcës me page 45,000 lekë. Ky vendim është marrë në studim të performancës në punë, me urdhrin nr.223, datë 03.10.2022, ka kaluar nga specialist në sektorin e taskë forcës në përgjegjëse financës me pagë 67,000 lekë. Në listë prezencën e muajit Maj, Qershor dhe Gusht, emri i saj është shtuar me shkrim dore 2 muaj në pozicionin “Përgj sektori auditit”, muaji gusht në pozicionin “jurist” në drejtorinë juridike. Në të dy drejtoritë nga Drejtueset përkatëse konfirmohet se nuk është pjesë e listë prezencës së drejtorisë ku është shtuar emri i kësaj punonjëse. Për periudhën Maj-Tetor të vitit 2022, znj. G.Ç nuk ka kryer detyrën funksionale në asnjë prej drejtorive ku është emëruar dhe nuk ka qenë pjesë e listë prezencës së nëshkruar nga drejtorët përkatës, znj. G.Ç është klasifikuar “Nëpunës i lartë në Administratën Shtetërore” ndërsa është specialist në UK Elbasan, këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, pika 2/b, c. “Punësimi i Audituesit të brendshëm”, VKM nr.514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve”, grupi 11,12 dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 69,70 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-44, të Raportit të Auditimit*).

19.1. Rekomandim: Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Elbasan, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Auditit, të analizojë procedurën e punësimit dhe angazhimin në punë në

Drejtoritë në të cilat është emëruar të zj. G.Ç, referuar listë prezencave dhe të kryejnë llogaritjet e pagesave si edhe ndalesën e shumës për periudhën Maj-Tetor të vitit 2022, duke ndjekur procedurat ligjore.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në 40 dosje personeli të SHRUKË për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin ligjor, konstatohet se: Dosjet e personelit nuk janë të plotësuara me dokumentet ligjore si kërkesa për punësim, çertifikata, vërtetime nga prokuroria, gjykata, librezën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; raport mjekësor për aftësimin në punë; Fletë pune të lëshuar nga Zyra e Punës; etj dokumente të nevojshme sipas kërkesave të pozicionit të punës. Po kështu u konstatua se dosjet e personelit nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin dhe renditjen e dokumentacionit, mungon inventari i dosjes si edhe mënyra e mbajtjes së tyre pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk plotëson kriteret e mbajtjes së dokumenteve shtetërore, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 21, dhe ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-44, të Raportit të Auditimit*).

20.1.Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për emërimin e punonjësve sipas nivelit arsimor dhe profesional referuar kërkesave të miratuara për çdo vend pune si edhe plotësimin dhe arkivimin e dosjeve me dokumentacionin ligjor-profesional me qëllim rritjen e nivelit profesional dhe realizimin e objektivave të shoqërisë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë" nenet 98-102, nga Titullari i Njësies Publike në bashkëpunim me Njësiesin Zbatues, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën **4,941,853 lekë**, sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “Ujësjetësi i fshatit Bishqem xhami dhe ndërtim pusi” sipas kontratës të lidhur midis Ujësjetësit Peqin SHA dhe BOE “A2A CO” SHPK & “Sh” SHPK me Nr.19 Prot. datë 08.02.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 56,663,071 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 6 muaj nga data e fillimit të tyre, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 5 (pesë) zëra punimesh në shumën 372,350 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe shoqërisë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin

Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit e lidhur midis Ujësjetllësit Peqin Sh. A dhe BOE "AS" SHPK & "I" SHPK me Nr.20 Prot. datë 08.02.2021 me objekt: "Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Ujësjetllësi i fshatit Bishqem xhami dhe ndërtim pusi", Neni 7, "Detyrimet e Mbikëqyrësit të Punimeve" (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 80-90, të Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan të marri masa, për arkëtimin e shumës **372,350 lekë pa TVSH**, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe shoqërisë, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE "A2A CO" SHPK & "Sh" SHPK sipas kontratës së lidhur me Nr.19, Prot. datë 08.02.2021 për realizimin e punimeve civile.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Në objektin "Instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengel-Samurr-Golodesh, (për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve" sipas kontratës të lidhur midis Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA dhe OE "B-N" me Nr.1872/8 Prot. datë 08.11.20219 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 61,797,051lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 45 ditë nga data e lidhjes së kontratës, e ndryshuar me Amendim Kontrate Nr.2959/2Prot. datë 19.12.2019, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit SHRUK Elbasan rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 1 (një) zë punimesh në shumën 449,198 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe shoqërisë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; Kontrata e shërbimit e lidhur midis Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA dhe OE "I D Alb" SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 80-90, të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan të marrë masa, për arkëtimin e shumës **449,198 Lekë pa TVSH**, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe shoqërisë, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga OE "B-N" SHPK, sipas kontratës së lidhur me Nr.1872/8 Prot. datë 08.11.20219 për realizimin e punimeve civile.

Menjëherë

3. Gjetje nga Auditimi: Në objektin "KUZ Belsh Lagjia Hysë" sipas kontratës të lidhur midis Ujësjetllës Kanalizime Belsh SHA dhe BOE "M" SHPK & "A K" SHPK me Nr.10/17 Prot. datë 19.04.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 78,925,224 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës, e ndryshuar me Amendim Kontrate nr.1, me Nr. 107/3 Prot. datë 19.07.2021 dhe Amendim Kontrate Nr.2 me Nr.107/7 Prot. datë 11.10.2021, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 2 (dy) zëra punimesh në shumën 391,990 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe shoqërisë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, Pika 8.1,

Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit e lidhur midis SHA Ujësjiellës Kanalizime Belsh dhe OE “H-Al” sh.p.k Nr.12/19Prot. datë 01.04.2021 me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për objektin, KUZ Lagjia Hysë”, Neni 7, “Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit” dhe Neni 8, “Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit”(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 80-90, të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan të marrë masa, për arkëtimin e shumës **391,990 Lekë pa TVSH**, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe shoqërisë, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “M” SHPK & “Al K” SHPK sipas kontratës së lidhur me Nr.10/17 Prot. datë 19.04.2021 për realizimin e punimeve civile.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjiellës në Fshatin Zgosht, Bashkia Librazhd”, sipas zërit “F.V tuba e rakorderi ujësjiellësi PE d=20 mm, PN 10”, rezulton se nuk është detajuar sasia e raportuar sipas lidhjeve të shtëpive, por është paraqitur vetëm sasia totale në masën 2370 ml, duke krijuar vështirësi për identifikimin e sasisë së vendosur sipas lidhjeve përkatëse.

Sipas zërit I.4.5 “F.V portë metalike, profili tub (40 mm x 40 mm x 2mm)”, u konstatua se porta është ndërtuar me profile hekuri ndërtimi, pa respektuar asnjë kusht teknik, si dhe pa respektuar specifikimet teknike. Vlera për këtë zë punimi në shumën **50,600 lekë**, është certifikuar padrejtësisht.

Sipas zërit II.3.7 “Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm, me makineri është certifikuar sasia 25 m², me çmim 1,550 lekë/m². Nga verifikimi i punimeve në objekt, kjo shtresë rezulton e pa realizuar. Vlera **38,750lekë** është certifikuar padrejtësisht.

Sipas zërit II.3.8 “Shtresë asfaltbetoni me granil gur kave, 4 cm, me makineri”, është certifikuar sasia 25 m², me çmim 1,350 lekë/m². Nga verifikimi i punimeve në objekt, kjo shtresë rezulton e pa realizuar. Vlera **33,750 lekë** është certifikuar padrejtësisht.

Sipas zërit I.4.2 “Struktura monolite betoni C 20/25, kolonat + themeli”, u konstatua se kolonat e rrethimit nuk janë vendosur me dimensionet e përcaktuara në vizatime.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu III, pika 4(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 80-90, të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Nga ana e SHRUK Elbasan të marren masa duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e shumës **122,100 lekë** pa TVSH, nga OE “K” SHPK, për zëra punimesh të pa kryera si dhe pa respektuar specifikimet teknike sipas kontratës së lidhur me nr. 166 prot., datë 04.05.2021 “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjiellës në Fshatin Zgosht, Bashkia Librazhd”.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Bazuar në Marrëveshjen e nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 22.07.2022 me objekt “Krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjiellës kanalizimeve” i cili do të kryej veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin, është transferuar

tërësisht veprimtaria ekonomike e shoqërive ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve të cilat kanë qenë në pronësi të bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin.

Në këtë Marrëveshje janë përcaktuar procedurat që duhen ndjekur për transferimin e njësive, por konstatohet se personat të cilët janë caktuar me detyrën e likuidatorit kanë qenë punonjës të njësive dhe janë punonjës në strukturën e SHRUKË. Për periudhën 8 mujore nga SHRUKË është paguar për likuidatorët e njësive shuma **3,606,215 lekë**. Nga auditimi konstatohet se Likuidatorët nuk kanë kryer asnjë funksion në lidhje me transferimin e njësive si edhe veprimet që duhej të ndiqnin në zyrat e Drejtorive tatimore dhe QKB për çregjistrimin e aktivitetit të njësive si edhe këto shoqëri të UK nuk janë shoqëri në likuidim, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, neni 216 “Bashkimi me përrthithje i shoqërive”, neni 217 “Raporti i ekspertëve”, neni 197 “Të drejtat dhe detyrimet e likuiduesit”, neni 198 “Bilancet” neni 202 “Përfundimi i likuidimit” si edhe Marrëveshjen e nënshkruar në datën 27.07.2023, neni 3 “Forma dhe emri i subjektit të kompetencave të përbashkëta” neni 6 “Kontributi i palëve” neni 7 “Procedurat e transferimit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-44, të Raportit të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime dhe Drejtoria e Financës të marrë masa për arkëtimin e shumës **3,606,215 lekë**, nga likuidatorët e 6 shoqërive të UK përfituar padrejtësisht nga procesi i bashkimit të shoqërive (sipas listës në aneksin nr.1).

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Qendror drejtuar Ujësjellës Kanalizime Peqin SHA, rezulton se janë urdhëruar tre “Urdhër Bllokim i Llogarive Bankare”, për llogaritë e Ujësjellës Kanalizime Peqin SHA, lidhur me detyrimet si më poshtë:

-Urdhër Bllokim i Llogarive Bankare nr. 7964 prot, datë 26.07.2021, për detyrimin e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, ku vlera e tatimit është 3,747,981 lekë, vlera e gjobës është 93,738 lekë, interesi është 23,112 lekë, dhe detyrimi total 3,846,831 lekë.

-Urdhër Bllokim i Llogarive Bankare nr. 13526 prot, datë 31.05.2022, për detyrimin e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, ku vlera e tatimit është 996,974 lekë, vlera e gjobës është 24,525 lekë, interesi është 6,093 lekë, dhe detyrimi total 1,027,592 lekë.

-Urdhër Bllokim i Llogarive Bankare nr. 34135 prot, datë 17.11.2022, për detyrimin e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, ku vlera e tatimit është 985,217 lekë, vlera e gjobës është 46 lekë.

Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, ku vlera e tatimit është 7,746,449 lekë, vlera e gjobës është 8,948,325 lekë.

Për Tatimin e Mbajtur në Burim, ku vlera e tatimit është 47,638 lekë.

Referuar “Detyrimeve në kohë reale” nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezulton se gjobat të papaguara janë në vlerën **9,476,713 lekë**.

-Nga grupi i auditimit u konstatua se lidhur vonesat e ndryshme në pagesa, SHRUKË SHA dhe njësitë, është gjobitur si më poshtë: me “Detyrimin për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale”, “Gjoba me DRSHTRR”, “Gjoba për likuidimin e vonuar të taksave të Bashkisë Elbasan”, “Gjoba nga QKB”, “Gjoba për O”, etj, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë paguar gjoba dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën **10,621,713 lekë**, e cila konsiderohet *efekt financiar negativ* në buxhetin e SHRUKË SHA.

Gjithashtu edhe pse nuk është paguar ende vlera 9,476,713 lekë, e cila përfaqëson gjoba të pa paguara, kjo vlerë do të ketë efektet e saj negative në buxhetin e vitit të ardhshëm, me kryerjen e pagesës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8, pika 1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 44-73, të Raportit të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të analizojnë **efektin negativ financiar** me vlerë **10,621,713 lekë**, të nxjerrë përgjegjësitë dhe shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë, si dhe të merren masa për likuidimin e detyrimeve për gjobat në vlerën **9,476,713 lekë**, të cilat janë krijuar për mos pagesën në kohë të detyrimeve nga ish Ujësjiellës Kanalizime Peqin SHA, mospagesa të cilat sjellin **si pasojë urdhër sekuestro të llogarive bankare të Shoqërisë Rajonale të Ujësjiellës Kanalizime Elbasan dhe njësitë e saj**.

1.2 Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për likuidimin në kohë të detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin në burim, e të tjera, me qëllim eliminimin e efekteve negative financiare në buxhet, për shkak të pagesave të gjobave dhe të interesave që lindin nga mos kryerja e pagesës.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ish Ujësjiellës Kanalizime Elbasan rezulton se për periudhën objekt auditimi janë paguar 5 përmbarues privat në vlerën **21,828,728 lekë**. Këto pagesa janë kryer për mbledhjen e detyrimeve të klientëve debitorë ndaj ujësjiellësit. Marrëveshja me përmbaruesin privat lidhet individualisht për çdo klient rast pas rasti dhe shpenzimet përmbarimore janë paguar nga SHRUKE SHA, bazuar në nenin 7, pika 2, të kontratës tip, sipas udhëzimit të përbashkët nr. 385/7, datë 28.06.2017 për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat, dhe do të paguhet nga kreditori në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit, përveç rastit kur kreditori është i përjashtuar me akt ligjor apo nënligjor, nga pagimi i tarifës fikse. Në këtë rast, kreditori **nuk është** i përjashtuar me akt ligjor apo nënligjor nga pagimi i tarifës fikse.

Nga auditimi konstatohet se kontraktimi i përmbarimit privat, deri në përfundimin e auditimit në teren, ka rezultuar të jetë me humbje financiare për SHRUKE SHA, pasi përpara kontraktimit të përmbaruesve privat, shoqëria kishte një humbje financiare për shkak të debitorëve në vlerën 88,717,489 lekë, ndërsa pas kryerjes së pagesës së shërbimit përmbarimor edhe në kushtet e mos kryerjes së arkëtimit të plotë të debisë nga përmbaruesit privat, SHRUKE SHA ka një humbje financiare prej 101,478,377 lekë, e cila përbëhet nga debia aktuale e pa arkëtuar prej 83,428,616 dhe pagesat e pa kryera prej 18,049,762 lekë, për shërbimin përmbarimor, të cilat duhet të paguhet nga kreditorët nëpërmjet përmbarimit, për llogari të SHRUKE SHA. Pra, duke analizuar rezultatin financiar të kësaj mase të marrë për të ulur detyrimet e palëve të treta nëpërmjet përmbarimit privat, situata financiare e SHRUKE SHA është rënduar, përkeqësuar financiarisht me vlerën 12,760,888 lekë.

Për sa më sipër përmbaruesit privat kanë ndaj SHRUKE SHA dy detyrime:

- a) arkëtimin e debisë nga debitorët e ujit në vlerën 83,428,616 lekë;
- b) arkëtimin e shpenzimeve përmbarimore të paguara paradhënie nga ish Ujësjiellës Kanalizime Elbasan, në vlerën 18,049,762 lekë, të cilat duhet të paguhet nga debitorët nëpërmjet përmbarimit, për llogari të SHRUKE SHA.

Sa më sipër, vlera prej 18,049,762 lekë konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e SHRUKE SHA dhe buxhetin e shtetit.

SHRUKE SHA pas lidhjes së kontratës me përmbaruesit privat dhe pas kryerjes së pagesës prej 21,828,728 lekë për shërbimin që do të kryhet prej tyre, nuk ka marrë asnjë masë për të kërkuar

nga përbarimi privat zbatimin e plotë të detyrimeve kontraktuale, pra mbledhjen e diferencës së detyrimit prej 83,428,616 lekë. Gjithashtu subjekti i audituar për mbledhjen e detyrimeve prej 88,717,489 lekë, përderisa ka gjykuar se duhet të bëhej nëpërmjet përbarimit, duhet të kishte lidhur kontratë me zyrën përbarimore shtetërore e cila ka tarifa më të ulëta se përbarimi privat, duke ulur në këtë mënyrë kostot financiare të shërbimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 44-73, të Raportit të Auditimit*).

2.1 Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të kërkojë prej përbaruesve privat me të cilët ka lidhur 1019 kontrata, zbatimin prej tyre të detyrimeve kontraktuale, pra arkëtimin e debisë në vlerën 83,428,616 lekë, si dhe të vlerës së shërbimit prej 18,049,762 lekë.

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë në të ardhmen të lidh kontratë shërbimi me zyrën përbarimore shtetërore dhe jo me përbarues privat.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se përgjatë periudhës kohore 2021-2022, për arsye të mos pagesës së detyrimeve të energjisë elektrike nga Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA, përbaruesi privat ka vendosur 7 herë masën sekuestro konservative për llogaritë bankare të këtij institucioni për llogari të FSHU SHA. Nga administratori i Ujësjetllës Kanalizime SHA Elbasan me shkresën nr. 2308 prot, datë 03.08.2021 “Letër angazhimi”, drejtuar përbaruesit B. Sh, është kërkuar akt - marrëveshje, duke marrë përsipër që çdo datë 5 të muajit pasardhës e deri në përfundim të detyrimit, të shlyej detyrimet e faturave korrente si dhe 5,000,000 lekë detyrime të prapambetura. Grupit të auditimit nuk ju vendosën në dispozicion shkresa të cilat të vërtetonin korrespondencën vijuese për lidhjen e kësaj akt - marrëveshje. Referuar akt - rakordimit midis SHRUKË dhe FSHU të muajit mars 2024, rezulton se SHRUKË ka një detyrim total për energjinë elektrike në vlerën 2,044,387,395 lekë, nga e cila vlera e detyrimit për energjinë elektrike të konsumuar është 1,058,289,531 lekë, ndërsa vlera prej 986,097,863 lekë është kamatëvonesë, e cila nuk është përfshirë në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Po ashtu, përveç aktit të rakordimit midis SHRUKË dhe FSHU, Drejtoria Tregtare nuk dispononte evidenca lidhur me këtë detyrim të ndarë në vite. Për shkak se shitësi i energjisë elektrike FSHU SHA, për arkëtimin e detyrimeve që Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA ka ndaj tij, ka angazhuar përbaruesin privat, shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Elbasan ka paguar edhe shpenzimet përbarimore në vlerën 14,224,576 lekë, vlerë e cila ashtu si edhe interesat, ka rënduar edhe më shumë buxhetin e shoqërisë. Vlera e kamatëvonesave prej 986,097,863 lekë, si dhe vlera për shpenzimet përbarimore prej 14,224,576 lekë, pra në total shuma e vlerave të mësipërme prej 1,000,322,439 lekë, e paguar pa përfituar asgjë, por për shkak të mos pagesave të detyrimeve për energjinë elektrike, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shoqërisë, si dhe keq përdorim i fondeve publike. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me detyrimet që rrjedhin nga kontrata dypalëshe për energjinë elektrike dhe me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8, pika 1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 44-73, të Raportit të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të marrin masa të menjëhershme për hartimin e një plani për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike, duke i dhënë përparësi këtij zëri në planifikimin e buxhetin vjetor. Të kërkohej ndryshim i zërave buxhetor sipas procedurave ligjore, me qëllim që zëri i shpenzimeve për energjinë elektrike të mbulohet me buxhet në vlera më të larta se ato të parashikuara në buxhetin fillestar vjetor. Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të analizojnë situatën e krijuar, të nxjerrin përgjegjësitë, si dhe arsyet e mos pagesave të detyrimeve.

3.2. Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të marrin masa për arritjen e një aktmarrëveshje me FSHU lidhur me shlyerjen e detyrimit prej 2,044,387,395 lekë, në mënyrë që të shmanget vendosja e masës “*sekuestro konservative*” nga përmbarimi privat dhe krijimi i kamatëvonesave të tjera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në gjashtë njësitë e SHRUKE SHA janë lidhur kontrata për shërbimin e telefonisë celulare, si më poshtë:

Administratori i SHRUKE SHA ka lidhur kontratën me O Albania SHA, për një periudhë prej 36 muajsh, në të cilën nuk përcaktohet data e lidhjes të kontratës, nuk përcaktohet **saktësisht dhe është lënë evazive** për sa numra telefoni është lidhur kjo kontratë, dhe deri në cilën vlerë merret përsipër shlyerja e këtij detyrimi nga ana e SHRUKE.

Po ashtu, në kontratën e lidhur mes palëve rezulton se në Aneksin nr. 3, pika 1.1, citohet se: “*O Albania SHA do të ofrojë për pajtimtarin një buxhet me vlerë prej 711,600 lekë (me TVSH), të cilin do ta përfitojë në aparate celulare*”.

Pagesat lidhur me këtë kontratë janë kryer nga SHRUKE SHA në vlerën 1,382,573 lekë dhe nga punonjësit në vlerën 163,000 lekë.

-Administratori i Njësisë Ujësjetllës Kanalizime Librazhd - Përrenjas ka lidhur në datën 10.12.2020, kontratën me O T. SHA, për një periudhë prej 24 muajsh. Po ashtu, në kontratën e lidhur mes palëve rezulton se në Aneksin nr. 3, pika 2.1, citohet se: “*One Teleco do të ofrojë 96,000 lekë me TVSH, i cili do të përdoret për aparate celulare*”.

Pagesat lidhur me këtë kontratë, për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022, janë kryer nga njësia Librazhd - Përrenjas në vlerën 366,795 lekë dhe nga punonjësit në vlerën 334,157 lekë.

-Njësia Ujësjetllës Kanalizime Peqin, për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë kryer nga njësia Peqin në vlerën 75,238 lekë dhe të pa likuiduara në vlerën 10,040 lekë.

-Përfaqësuesi i Njësisë Ujësjetllës Kanalizime Cërrik ka lidhur në datën 30.04.2019, kontratën me Telecom Albania, për një periudhë 24 muaj, ku rezulton se, në Aneksin nr. 3, pika 21.1, citohet se: “*Telecom Albania do të ofrojë 200,000 lekë me TVSH, i cili do të përdoret për aparate celulare*”.

Kontrata është rinovuar në datën 30.04.2021, për një periudhë prej 24 + 12 muaj. Nga kjo kontratë rezulton se do të përvetësohen 54 numra me shërbim të telefonisë dhe internetit me buxhet 150,000 lekë. Pagesat lidhur me këtë kontratë, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, janë kryer nga njësia Cërrik në vlerën 950,672 lekë dhe të pa likuiduara në vlerën 34,792 lekë.

-Nga auditimi rezulton se aparatet celulare të përfituar nga këto kontrata nuk janë inventarizuar në asnjë rast në regjistrat e aseteve të këtyre shoqërive.

-Lidhja e kontratës së shërbimit është kryer pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2.

Sa më sipër, vlera prej **3,932,878 lekë** që konsiderohet **efekt financiar negativ** në buxhetin e SHRUKE SHA (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 44-73, të Raportit të Auditimit*).

4.1 Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të analizojë **efekt financiar negativ** me vlerë **3,932,878 lekë**, shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të merren masa lidhur me pajisjen e punonjësve me numra telefoni sipas detyrave të tyre. Po ashtu, të merren masa të menjëhershme lidhur me inventarizimin e aparateve celulare në regjistrat e aseteve të shoqërisë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se nga njësitë e UK Cërrik, Elbasan, Belsh, Peqin dhe Gramsh, janë rekrutuar punonjës të rinj mbas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkimin e tyre në Shoqërinë Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime Elbasan, duke sjellë rritje të numrit të punonjësve shoqëruar me efekt negativ për shoqërinë në shumën **6,756,344 lekë**. Veprimet e mësipërme janë

në kundërshtim me nenin 10 të Marrëveshjes së nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 22.07.2022 me objekt “Krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-44, të Raportit të Auditimit).

5.1.Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për punësimin e punonjësve të rinj për periudhën gusht-dhjetor 2022, periudhë pas datës së krijimit të Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Elbasan. Të marrë masa për rishikimin e kësaj vendimmarrje e cila është në kundërshtim me nenin 10, të Marrëveshjes së nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 22.07.2022, me qëllim uljen e numrit të punonjësve, pasi kosto e pagave zë 62% të totalit të shpenzimeve.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

D.I.PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

Mbështetur në nenin 36, të ligjit nr. 153/2013 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 16 të Kontratës Individuale të Punës miratuar me vendimin nr.7, datë 06.12.2023, të Këshillit Mbikëqyrës, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim për përjashtim nga puna” për:

- **z. L.T**, me detyrë Administrator i SHRUKË SHA, shtator 2022-e në vazhdim:

-Nuk ka marrë masa lidhur me detyrimin financiar në vlerën 2,044,387,395 lekë, midis SHRUKË dhe FSHU, nga e cila vlera e detyrimit për energjinë elektrike të konsumuar është 1,058,289,531 lekë, për kamatëvonesën në vlerën prej 986,097,863 lekë dhe shpenzimet përmbartimore në vlerën 14,224,576 lekë.

- Nuk ka marrë masa lidhur me mbledhjen e detyrimeve që debitorët e ujësjellësit kanë ndaj SHRUKË SHA në vlerën 83,428,616 lekë dhe ndaj përmbartuesve privatë të cilët kanë detyrimin 18,049,762 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 1276/5, datë 27.7.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor shtetëror”.

- Nuk ka marrë masa lidhur me vonesat e ndryshme në pagesa(gjoha) në vlerën 10,621,713 lekë, si dhe për vlerën 9,476,713 lekë, e cila përfaqëson gjoha të pa paguara.

-Për lidhjen e kontratës me O Albania SHA, në mënyrë evazive dhe të papërcaktuar, pa datë lidhje kontrate, pagesa e së cilës rezulton në vlerën 1,382,573 lekë. Në këtë kontratë rezulton përfitim i një buxheti me vlerë prej 711,600 lekë (me TVSH), i cili është përfituar në aparate celulare”, lidhja e kontratës së shërbimit është kryer pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2.

-Nuk ka marrë masa për riorganizimin e strukturës së shoqërisë dhe uljen e numrit të punonjësve.

-Nuk ka marrë masat e nevojshme për uljen e humbjeve, të cilat janë në nivelin 72%, ka një normë në rritje krahasuar me kërkesat e përcaktuara në “Strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitet 2022-2030” ku për vitin 2023 ky tregues parashikohet në nivelin 60%.

- ka lejuar diferencime në përcaktimin e nivelit të pagave pa u bazuar në legjislacionin në fuqi, përcaktime të pagave jo sipas vërshtirësisë, ngarkesës dhe rëndësisë në vendin e punës si edhe diferenca midis pozicionit Drejtor dhe specialist, në kundërshtim me Kodin e Punës, Neni 115, “Barazia në shpërbllim”(ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015)

-z. N.T, me detyrë Administrator i njësisë të Ujësjellës Kanalizime Peqin SHA, për periudhën objekt auditimi janar 2020-dhjetor 2023:

-Për mos marrjen e masave lidhur me vonesat e ndryshme në pagesa në vlerën 10,621,713 lekë, si dhe për vlerën 9,476,713 lekë, e cila përfaqëson gjoha të pa paguara.

-për transferimin e aktivitetit të ish shoqërive UK tek shoqëria mëmë “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime” Sh. a Elbasan, ku faturat janë përpiluar në përshkrimin e mallit me cilësimin si “*transferim inventarësh afatgjatë, afatshkurtër, inventar i imët etj.*,” duke mos pasur përshkrimin e aktiveve të transferuara, në kundërshtim me ligjin Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 101.

-për vitet 2020-2022 shoqëria me të ardhurat e realizuara nuk ka mbuluar koston duke rritur humbjet çdo vit. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura, shoqëria ka performuar dobët nën nivelin 80%, UK Peqin 39%.

-Ka punësuar 2 punonjës në kundërshtim me nenin 10 të Marrëveshjes së nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 22.07.2022 me objekt “*Krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve*”.

- Në hartimin dhe miratimin e programeve ekonomike, nuk ka zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 dhe 4.

-z. A.G, me detyrë Administrator i njësisë të Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas SHA, për periudhën objekt auditimi janar 2020-dhjetor 2023:

- Për lidhjen e kontratës me O Telec SHA, për 24 muaj, pagesa e së cilës rezulton në vlerën 334,157 lekë Në këtë kontratë rezulton përfitim i *një buxheti në 96,000 lekë me TVSH, i cili do të përdoret për aparate celulare*”, lidhja e kontratës së shërbimit është kryer pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2.

-për transferimin e aktivitetit të ish shoqërive UK tek shoqëria mëmë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime” Sh. a Elbasan, ku faturat janë përpiluar në përshkrimin e mallit me cilësimin si “*transferim inventarësh afatgjatë, afatshkurtër, inventar i imët etj.*,” duke mos pasur përshkrimin e aktiveve të transferuara, në kundërshtim me Ligjin Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 101.

-znj. I.S, me detyrë Drejtor Juridik dhe Personeli, ish Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA dhe SHRUKË SHA:

-Për mos marrjen e masave lidhur me detyrimin financiar në vlerën 2,044,387,395.08 lekë midis SHRUKË dhe FSHU, nga e cila vlera e detyrimit për energjinë elektrike të konsumuar është 1,058,289,531lekë, për kamatëvonesën në vlerën 986,097,863 lekë dhe shpenzimet përmbartimore në vlerën 14,224,576 lekë.

-Për mos marrjen e masave lidhur me mbledhjen e detyrimeve që debitorët e ujësjellësit kanë ndaj SHRUKË SHA në vlerën 83,428,616 lekë dhe ndaj përmbartuesve privatë të cilët kanë ndaj SHRUKË SHA detyrimin 18,049,762 lekë,në kundërshtim me udhëzimin nr. 1276/5, datë 27.7.2017 “*Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor shtetëror*”.

-Për mos marrjen e masave lidhur me vonesat e ndryshme në pagesa në vlerën 10,621,713 lekë, si dhe për vlerën 9,476,713 lekë, e cila përfaqëson gjoha të pa paguara.

-nuk ka kryer rekrutimin e punonjësve sipas procedurave të përcaktuara që nga njoftimet, aplikimet, paraqitja e dokumentacionit dhe vlerësimi nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

- nuk ka plotësuar me dokumentacionin ligjor në 40 dosje personeli, si kërkesa për punësim, certifikata, vërtetime nga prokuroria, gjykata, librezën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; raport mjekësor për aftësimin në punë; Fletë pune të lëshuar nga Zyra e Punës; etj dokumente të nevojshme sipas kërkesave të pozicionit të punës,
- nuk ka evidentuar me inventar përmbajtjen e dosjes së punonjësve, në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 21, dhe ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.

D.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte:

“Zgjidhje e kontratës së punës”

- Për **z. L.K**, ish Administrator i ish Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA, për periudhën janar 2020-tetor 2022,
 - për transferimin e aktivitetit të ish shoqërive UK tek shoqëria mëmë “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime” Sh. a Elbasan, ku faturat janë përpiluar në përshkrimin e mallit me cilësimin si *“transferim inventarësh afatgjatë, afatshkurtër, inventar i imët etj.”* duke mos pasur përshkrimin e aktiveve të transferuara, në kundërshtim me ligjin Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 101.
 - nuk ka marrë masa për tejkalimin e fondit të pagave për vitin 2021, në masën 108%, ose +8% nga planifikimi.
 - nuk ka analizuar dhe të marrë masa për tejkalime të theksuara të disa zërave të shpenzimeve dhe mosrealizim të të ardhurave me tregues negativ në rritje nga njëri vit në tjetrin.
 - Programet e zhvillimit të shoqërisë pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës nuk i ka dërguar për miratim në Ministrinë përgjegjëse për ekonominë.
 - për vitet 2020-2022 shoqëria me të ardhurat e realizuara nuk ka mbuluar koston duke rritur humbjet çdo vit. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura, shoqëria ka performuar dobët nën nivelin 80%, UK Elbasan 68%.
 - Në hartimin dhe miratimin e programit ekonomik, nuk ka zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 dhe 4.
 - Ka punësuar 47 punonjës në kundërshtim me nenin 10 të Marrëveshjes së nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 22.07.2022 me objekt *“Krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjetllës kanalizimeve”*.
- **z. A.Zh**, ish Drejtor Teknik i ish Ujësjetllës Kanalizime Peqin SHA,
 - për vitet 2020-2022 shoqëria me të ardhurat e realizuara nuk ka mbuluar koston duke rritur humbjet çdo vit. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura, shoqëria ka performuar dobët nën nivelin 80%, UK Peqin 39%.

-Ka punësuar 2 punonjës në kundërshtim me nenin 10 të Marrëveshjes së nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 22.07.2022 me objekt “Krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve”.

- Në hartimin dhe miratimin e programit ekonomik, nuk ka zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 dhe 4.

- **z. E.P.**, ish administrator në UK Belsh,

-për vitet 2020-2022 shoqëria me të ardhurat e realizuara nuk ka mbuluar koston duke rritur humbjet çdo vit. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura, shoqëria ka performuar dobët nën nivelin 80%, UK Belsh 53%.

- Në hartimin dhe miratimin e programit ekonomik nuk janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 dhe 4.

- **z.P.T.**, ish Drejtor Teknik i ish Ujësjellës Kanalizime Belsh SHA,

-për vitet 2020-2022 shoqëria me të ardhurat e realizuara nuk ka mbuluar koston duke rritur humbjet çdo vit. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura, shoqëria ka performuar dobët nën nivelin 80%, UK Belsh 53%.

- Në hartimin dhe miratimin e programit ekonomik nuk janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 dhe 4

- **znj.P.A.**, ish Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore në ish Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA,

- **z. Sh.L.**, ish Shef Finance në ish Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA,

-**znj. E.M.**, ish Drejtor Tregtar i SHRUKE SHA,

-**z. E.P.**, ish Shef Finance i ish Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA,

Për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në emërimin e znj. G.C., mangësitë në dokumentet e punësimit, mos evidentimin në listë prezencë nga drejtorët përkatës duke favorizuar punësim dhe shpërbllim page pa kryer punë dhe pa u paraqitur në punë, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, pika 2/b, c. “Punësimi i Audituesit të brendshëm”, VKM nr.514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve”, grupi 11,12 dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 69,70(*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-44, të Raportit të Auditimit*).

z. O.T., në cilësinë e ish administratorit të UK Belsh,

-për transferimin e aktivitetit të ish shoqërive UK tek shoqëria mëmë “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime” Sh. a Elbasan, ku faturat janë përpiluar në përshkrimin e mallit me cilësimin si “*transferim inventarësh afatgjatë, afatshkurtër, inventar i imët etj.*,” duke mos pasur përshkrimin e aktiveve të transferuara, në kundërshtim me ligjin Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 101.

-për vitet 2020-2022 shoqëria me të ardhurat e realizuara nuk ka mbuluar koston duke rritur humbjet çdo vit. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura, shoqëria ka performuar dobët nën nivelin 80%, si UK Belsh 53%.

- Në hartimin dhe miratimin e programit ekonomik nuk janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 dhe 4.

z. T.B në cilësinë e ish administratorit të UK Cërrrik (i larguar),

-për transferimin e aktivitetit të ish shoqërive UK tek shoqëria mëmë “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime” Sh. a Elbasan, ku faturat janë përpiluar në përshkrimin e mallit me cilësimin si “*transferim inventarësh afatgjatë, afatshkurtër, inventar i imët etj.*,” duke mos pasur përshkrimin e aktiveve të transferuara, në kundërshtim me ligjin Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 101.

-z. E.T në cilësinë e ish administratorit UK Cërrik,

-për transferimin e aktivitetit të ish shoqërive UK tek shoqëria mëmë “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime” Sh. a Elbasan, ku faturat janë përpiluar në përshkrimin e mallit me cilësimin si “*transferim inventarësh afatgjatë, afatshkurtër, inventar i imët etj.*,” duke mos pasur përshkrimin e aktiveve të transferuara, në kundërshtim me ligjin Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 101.

-nuk ka marrë masa për tejkalimin e fondit të pagave për vitin 2021, në masën 166%, ose +66% nga fondi i planifikuar i pagave. Planifikimi i treguesve të punës nuk është bazuar në numrin e punonjësve të planifikuar, fondin e pagave, duke sjellë tejkalim të shpenzimeve nga planifikimi.

-për vitet 2020-2022 shoqëria me të ardhurat e realizuara nuk ka mbuluar koston duke rritur humbjet çdo vit. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura, shoqëria ka performuar dobët në nivelin 80%, UK Cërrik 22% .

-Ka punësuar 21 punonjës në kundërshtim me nenin 10 të Marrëveshjes së nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 22.07.2022 me objekt “*Krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjetllës kanalizimeve*”.

-znj. F.Xh, ish shefe finance e njësisë të Ujësjetllës Kanalizime Cërrik SHA,

-për transferimin e aktivitetit të ish shoqërive UK tek shoqëria mëmë “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime” Sh. a Elbasan, ku faturat janë përpiluar në përshkrimin e mallit me cilësimin si “*transferim inventarësh afatgjatë, afatshkurtër, inventar i imët etj.*,” duke mos pasur përshkrimin e aktiveve të transferuara, në kundërshtim me ligjin Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 101.

-nuk ka marrë masa për tejkalimin e fondit të pagave për vitin 2021, në masën 166%, ose +66% nga fondi i planifikuar i pagave. Planifikimi i treguesve të punës nuk është bazuar në numrin e punonjësve të planifikuar, fondin e pagave, duke sjellë tejkalim të shpenzimeve nga planifikimi.

-për vitet 2020-2022 shoqëria me të ardhurat e realizuara nuk ka mbuluar koston duke rritur humbjet çdo vit. Përsa i përket kriterit të mbulimit të koston me të ardhura, shoqëria ka performuar dobët në nivelin 80%, UK Cërrik 22%

-nuk ka planifikuar zërat e shpenzimeve bazuar në rezultatet e vitit paraardhës dhe mungon analiza ekonomike për rezultatet e arritura. Në hartimin dhe miratimin e programit ekonomik të shoqërisë nuk janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 dhe 4.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

V. ANEKSE

Tabela nr.1 Mbi pagesat e likuidatorëve

Emërtimi	Emër mbiemër	Shuma
UK Elbasan	G. T.	983,045
UK Cërrik	I. Z.	432,955
UK Gramsh	M.B	519,545
UK Belsh	G.H	510,000
UK Librazhd	E.A	516,670
UK Peqin	M.A	644,000
Shuma		3,606,215

Tabela 2. prokurimeve SHRUK Elbasan 2023

Autoriteti Kontraktor	Objekti i prokurimit	Lloji i procedurës	Data e hapjes	Data e vlerësimit nga KVO	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës pa TVSH	Diferenca e fondit limit me vlerën e kontratës (pa TVSH)	Kontraktori
SHRUK Elbasan SH.A	“Blerje matësa uji për nevojat e shoqërisë”	E hapur	18.07.2023	04.08.2023	33,769,623	17,958,000	15,811,623	H shpk
SHRUK Elbasan SH.A	Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike te objekteve te shoqerise	E hapur	25.01.2023	27.02.2023	87,047,490		87,047,490	“MS” shrsf
SHRUK Elbasan SH.A	“Blerje vajra, graso, litar permistopash dhe kushineta, për pajisjet e stacionit të pompimit”	E hapur e thjeshtuar	28.12.2023	12.01.2024	1,499,700	1,220,500	279,200	E-Oil 2015 sha
SHRUK Elbasan SH.A	“Blerje tubo KUN 2023”	E hapur e thjeshtuar	08.05.2023	18.05.2023	7,179,500	6,930,520	248,980	I G
SHRUK Elbasan SH.A	Blerje siguracion per mjetet e shoqerise tpi dhe kasko	E hapur e thjeshtuar	29.03.2023	11.04.2023	1,500,000	1,499,002	998	S.
SHRUK Elbasan SH.A	“Rikonstruksion dhe ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të zonave informale: Harmës; pjesërisht Krastë e Vogël, pjesërisht Lagjja: Dyli Haxhire” dhe, pjesërisht Lagjja: Katund i Ri”	E hapur	08.05.2023	12.06.2023	703,790,028	697,149,643	6,640,385	BOE "M" SH.P.K
SHRUK Elbasan SH.A	Blerje automjeti per nevojat e shoqerise	E hapur e thjeshtuar	20.07.2023	31.07.2023	3,750,000	3,700,000	50,000	C. shpk
SHRUK Elbasan SH.A	Blerje Gazoil 10 ppm	E hapur	03.03.2023	20.03.2023	18,604,167	18,604,167	-	K.
SHRUK Elbasan SH.A	Blerje Benzine	E hapur	03.03.2023	20.03.2023	402,500	402,500	-	K.
SHRUK Elbasan SH.A	Supervizion punimesh për objektin : Rikonstruksion dhe ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të zonave informale, Harmës; pjesërisht Krasta e Vogël, pjesërisht L: Dyli	E hapur e thjeshtuar	24.07.2023	04.08.2023	5,630,320	5,630,320	-	Gj.& Co

	Haxhire, pjesërisht L: Katundi i Ri, të Bashkisë Elbasan.							
SHRUK Elbasan SH.A	Blerje internet dhe intranet	E hapur e thjeshtuar	30.01.2023	10.02.2023	6,396,000		6,396,000	
SHRUK Elbasan SH.A	“Riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve të shoqërisë për njësitë Gramsh-Belsh Peqin Cërrik-Librazhd” të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha.	E hapur e thjeshtuar	22.09.2023	03.10.2023	2,489,183	2,444,750	44,433	E.G
SHRUK Elbasan SH.A	Blerje materiali per nevojat e shoqerise	E hapur e thjeshtuar	08.11.2023	20.11.2023	3,799,433	3,674,220	125,213	Alma Kodra
Totali					875,857,945	759,213,622	116,644,323	

Tabela nr.3 e prokurimeve periudha 2022

Autoriteti	Objekti i prokurimit	Lloji i procedures	Data e hapjes	Data e vlerësimit nga KVO	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës pa TVSH	Diferenca e fondit limit me vlerën e kontratës (pa TVSH)	Kontraktori
Sh.A UKB	Blerje Karburanti (Gazoil D1)	E hapur e thjeshtuar	18.05.2022	06.06.2022	1,800,000	1,800,000	-	PAOLA
Sh.A UKB	Blerje Tubo me diameter me presjone te ndryshme dhe materiale hidraulike	E hapur e thjeshtuar	06.05.2022	17.05.2022	1,595,366	1,570,265	25,101	ASI-2A CO
Sh.A UKC	“Rikonstruksion i stacionit te pompave SP 97 Uzina”	E hapur e thjeshtuar	10.08.2022	22.08.2022	4,946,204	4,314,558	631,646	GREIN-T
Sh.A UKC	Vendosje matësash ne pallatet me kollone te brendshme, Bashkia Cerrik	E hapur	28.07.2022	12.08.2022	33,864,357	32,867,308	997,049	GREIN-T
Sh.A UKL	Blerje materiale per linjat e ujesjellesit dhe kanalizimeve	E hapur e thjeshtuar	28.03.2022	07.04.2022	3,000,000	2,740,000	260,000	ERVIN LUZI
Sh.A UKL	Rikonstruksion i zyrave te shoqerise	E hapur e thjeshtuar	25.05.2022	06.06.2022	2,500,000	2,458,564	41,436	RESTAURIM GURRA-KACA
Sh.A UKG	Blerje klori per nevojat e shoqerise	E hapur e thjeshtuar	28.04.2022	10.05.2022	1,425,000	1,282,500	142,500	"2 AT"
Sh.A UKE	Blerje pajisje leximi (palmare) dhe mirembajtje sistemi leximi automatik per viti 2022	E hapur e thjeshtuar	01.06.2022	17.06.2022	2,999,600	2,959,680	39,920	KREATX
Sh.A UKE	Rikonstruksion linjash dhe objektesh per ujesjelles kanalizime Elbasan viti 2022”	E hapur	11.04.2022	09.05.2022	53,000,000	50,788,667	2,211,333	B N.
Sh.A UKE	“Blerje siguracion TPL dhe Kasko per automjetet e shoqerise uke,viti 2022”	E hapur e thjeshtuar	18.05.2022	30.05.2022	1,618,659	1,618,488	171	S U GA
Sh.A UKE	“Zhvillim dhe mirembajtje per sistemin e faturimit kontabilitetit dhe fiskalizimit te UKE”	E hapur e thjeshtuar	25.02.2022	10.03.2022	3,919,996	3,900,000	19,996	K

Sh.A UKE	“Mbikqyrje e projektit Rikonstruksion linjash dhe objektesh per ujesjelles kanalizime elbasan viti 2022”	E hapur e thjeshtuar	29.04.2022	13.05.2022	1,038,813	912,769	126,044	D-N
Sh.A UKE	“Blerje Gazoil D1”	E hapur	07.02.2022	23.02.2022	9,445,333	9,445,333	-	O L S I
Sh.A UKE	Blerje materiale Hidraulike per nevojat e Ujesjelles Kanalizime Elbasan	E hapur, marrveshje kuader	24.06.2022	27.07.2022	75,000,000	75,000,000	-	ALEN - CO
Sh.A UKE	“Furnizim Vendorsje Pjese kembimi per automjetet e shoqerise”	E hapur	23.05.2022	15.06.2022	15,953,008	15,953,008	-	A K
Sh.A UKE	“Blerje toner dhe boje per vitin 2022”	E hapur e thjeshtuar	01.06.2022	16.06.2022	1,388,399	1,044,880	343,519	EL
Sh.A UKE	Blerje Benzine pa plumb	E hapur	07.02.2022	23.02.2022	446,985	446,985	-	O L S I
Sh.A UKE	Blerje veshje pune per vitin 2022	E hapur e thjeshtuar	04.04.2022	14.04.2022	1,443,660	1,424,208	19,452	G S
Sh.A UKE	Perditesim i programit te faturimit, migrimi i te dhenave dhe WEBService”	E hapur e thjeshtuar	04.11.2022	16.11.2022	9,500,000	9,300,000	200,000	K
Sh.A UKE	Ndertim i rrjetit ujesjelles Bradashesh	E hapur	31.08.2022	19.09.2022	18,824,299	18,303,638	520,661	B N.
Sh.A UKE	“Riparimi i asfalteve te demtuara nga Uke ne rruget e qytetit te elbasanit”	E hapur	30.05.2022	20.06.2022	3,000,000	3,000,000	-	B N.
Sh.A UKE	Blerje hipoklorit natriumi	E hapur	06.05.2022	30.05.2022	16,996,283	16,996,283	-	"AT"
Sh.A UKE	Blerje materiale elektrike	E hapur, marrveshje kuader	04.07.2022	26.07.2022	35,000,000	35,000,000	-	IY
Totali					298,705,962	293,127,134	5,578,828	

Tabela 4 e prokurimeve periudha 2021

Autorite kontraktor	Objekti i prokurimit	Lloji i procedurës	Data e hapjes	Data e vlerësimit nga KVO	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës pa TVSH	Diferenca e fondit limit me vlerën e kontratës (pa TVSH)	Kontraktori
Sh.A UK C	Blerje materiale mirembajtje rrjeti (hidraulike, elektrike, tuba etj)	E hapur e thjeshtuar	14.10.2021	08.11.2021	3,000,000	2,950,920	49,080	A.K.M
Sh.A UK C	Ndertimi i linjave shperndares dhe kolektoreve te ujit te pjshem	Kërkesë për propozim	26.01.2021	05.02.2021	1,501,166	1,483,693	17,473	G-T
Sh.A UK C	Ndertim i cezmave publike per komunitetin ne nevoje	E hapur e thjeshtuar	03.09.2021	20.09.2021	4,332,615	4,000,000	332,615	G-T
Sh.A UK B	Blerje tubo me diameter me presione te ndryshme dhe	Kërkesë për propozim	01.02.2021	12.02.2021	2,487,460	2,408,453	79,007	ASI

	materiale hidraulike.							
Sh.A UK B	KUZ Qyteti Belsh-Lagjja Hysaj	E hapur	18.02.2021	29.03.2021	67,310,125	65,771,020	1,539,105	"M".SH.P.K
Sh.A UK B	Blerje Gazoil D1	Kërkesë për propozim	14.01.2021	25.01.2021	2,000,000	1,800,000	200,000	P
Sh.A UK B	Supervizim KUZ Lagja Hysë	Kërkesë për propozim	26.02.2021	10.03.2021	1,429,186	1,297,880	131,307	H
Sh.A UK P	Blerje materiale hidraulike	E hapur	16.02.2021	12.03.2021	20,189,000	19,182,581	1,006,419	B. B
Sh.A UK	Ndërtim i stacionit të pompave Bishqem	Kërkesë për propozim	06.05.2021	20.05.2021	10,259,884	10,209,252	50,632	ASI
Sh.A UK L	Rikonstruksioni i rrjetit të ujësjes në fshatin Zgost, Bashkia Librazhd	E hapur	23.02.2021	25.03.2021	26,996,121	25,917,509	1,078,612	K
Sh.A UK L	Blerje materiale për linjat e ujësjes të kanalizimeve".	Kërkesë për propozim	29.01.2021	08.02.2021	3,600,000	2,740,000	860,000	EL
Sh.A UK G	"Rikonstruksion i linjave të ujësjes në apartamentet e pallateve me kullonë të brendshme qyteti Gramsh"	E hapur e thjeshtuar	09.09.2021	27.09.2021	7,483,458	7,466,481	16,977	BOE V
Sh.A UK G	Blerje klori për nevojat e shoqërisë	Kërkesë për propozim	13.01.2021	29.01.2021	1,187,000	932,000	255,000	"AT"
Sh.A UK Gramsh	Ndërtim i plotë të fshatit të fshatit Liras, sh	Kërkesë për propozim			4,548,287	4,130,768	417,519	H
Totali					156,324,302	150,290,556	6,033,745	

Tabela 5 e prokurimeve periudha 2020

Autoriteti kontraktues	Objekti i prokurimit	Lloji i procedurës	Data e hapjes	Data e vlerësimit nga KVO	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës pa TVSH	Diferenca e fondit limit me vlerën e kontratës (pa TVSH)	Kontraktori
Sh.A UK C	Blerje hipoklorit natriumi	Kërkesë për propozim	10.06.2020	22.06.2020	980,000	816,975	163,025	P.L
Sh.A UK P	Mbikqyrje punimesh ne objektin "Ujesjellesi i fshatit Bishqem Xhami dhe ndertim pusi"	Kërkesë për propozim	31.12.2020	11.01.2021	1,127,400	991,683	135,717	AS
Sh.A UK P	Ujësjellësi fshati Bishqem Xhami dhe ndërtim pusi.	E hapur	28.12.2020	27.01.2021	48,570,710	48,485,976	84,734	ASI
Sh.A UK P	Blerje hipoklorit kalciumi	Kërkesë për propozim	31.08.2020	10.09.2020	2,700,000	2,620,000	80,000	ASI
Sh.A UK P	Blerje hipoklorit natriumi	Kërkesë për propozim	31.08.2020	10.09.2020	600,000	580,000	20,000	ASI
Sh.A UK P	Blerje materiale hidraulike	Kërkesë për propozim	04.09.2020	19.09.2020	2,400,000	2,370,000	30,000	ASI
Sh.A UK Belsh	Projekt Zbatimi i K.U.Z qyteti Belsh,(Lagjia Hysaj)	Kërkesë për propozim	12.08.2020	24.08.2020	5,000,000	4,540,672	459,328	H
Sh.A UK Belsh	Blerje tubo me diameter me presjone te ndryshme dhe materiale hidraulike	Kërkesë për propozim	20.05.2020	06.06.2020	2,985,610	1,970,000	1,015,610	
Sh.A UK Belsh	Blerje Gazoil D1	Kërkesë për propozim	27.03.2020	07.04.2020	1,500,000	1,500,000	-	P
Sh.A UK E	Instalimi i teknologjive te reja ne stacionet e pompimit ne sistemin Mengel-Samurr Godolesh((per zevendesimin e pompave dhe paisjeve elektrike),Bas hkia Elbasan	Auditimi I zbatimit te kontrates me vlere 61,680,80 0 lek, kolauduar dt. 28.05.2020						"B-N" shpk

Sh.A UK G	Rikonstruksio n i linjës kryesore të ujësjellësit fshati Mashan,Njësi a Administrativ e Kodovjat & vendosje matësash në pallatet me kollonë të brendshme qyteti Gramsh	E hapur	15.04.2020	28.05.2020	30,239,843	29,785,889	453,954	VK
Sh.A UK G	Blerje eskavatori me zinxhir gome	Kërkesë për propozim	05.03.2020	16.03.2020	1,460,000	1,450,000	10,000	P
Totali					97,563,563	95,111,195	2,452,368	

Tabela 6 zbatimi i kontratave të punëve

Nr	PROJEKTI/OBJEKTI	Autoriteti Kontraktor	VLERA E INVESTIMI T ME TVSH	FILLIMI I INVESTIMI T MBARIMI INVESTIMI T	KOLAU DUAR	REALI ZIMI AKTUA L NE %	SHENI ME	SIPERMARR ESI I PUNIMEVE
1	Rikonstruksion të rrjetit të ujesjellesit :Rruga Kongresi i Permetit,(NSHU), J.Dyli, Haxhire, Elbasan;Linja kryesore STP -Byshek - depo Mlize, Shushice; Linja kryesore stp Bujqes- depo Mjebes dhe ndertim pjesor rrjeti shpermdares lagjia Kotor, fshati Bujqes+F.V makineri Paisje	UK ELBASAN sh.a	144,414,309	11.12.2020 19.05.2024	JO	97%	Nw process zbatimi	BN sh.p.k
2	Rikonstuksion dhe ndertim i rrjetit të kanalizimve të zonave informale Harnes Pjeserisht Krasta e vogel , pjeserisht Dyli Haxhire dhe pjeserisht lagja Katund i Ri	SHRUK Elbasan Sh.a	844,548,033	14.09.2023 14.09.2025	JO	20%	Ne proces zbatimi	B.O.E “M”, “T” shpk
3	Vendosje Matesash ne pallatet me kollone të brendshme , Bashkia Cerrik	UK CERRIK sh.a	39,440,770	04.09.2022 28.09.2023	JO	100%	Perfundu ar kolaudi mi	B.O.E “G” “I”
4	Rikonstruksion i linjës kryesore të ujësjellësit fshati Mashan,njesia administrative Kodovjat & vendosje matesash ne pallatet me kollone të brendshme qytet Gramsh, Bashkia Gramsh	UK GRAMSH sh.a	35,741,722	15.07.2020 09.11.2020	04.12.20 20	100%	Marre perfundi misht ne dorezim	“V K” shpk
5	Rikonstruksion i linjave të rrjetit të ujesjellesit ne disa rruge të qytetit Elbasan	UK ELBASAN sh.a	26,966,676	27.11.2019 13.04.2020	25.05.20 20	100%	Marre perfundi misht ne dorezim	“B-N” shpk

6	Instalimi i teknologjive te reja ne stacionet e pompimit ne sistemin Mengel-Samurr Godolesh(per zevendesimin e pompave dhe paisjeve elektrike),Bashkia Elbasan	UK ELBASAN sh.a	61,680,800	05.12.2019 17.04.2020	28.05.2020	100%	Marre perfundi misht ne dorezim	“B-N” shpk
7	Rikonstruksion i linjave te ujesjellesit ne apartatmetet e pallateve me kollone te brendshme qyteti Gramsh	UK GRAMSH sh.a	8,959,767	1.11.2021 28.02.2022	28.03.2022	100%	Marre perfundi misht ne dorezim	BOE “VI “P” shpk
8	Ujesjellësi i fshatit Bishqem Xhami dhe ndërtime Pusi në fshatin Bardhës	SH.A UK PEQIN	56,663,071	10.02.2021 10.08.2021	15.10.2021	100%	Marre perfundi misht ne dorezim	Shoqeria “A 2A” shpk
9	KUZ Belsh -Lagjja Hysaj	UK BELSH sh.a	78,651,659	18.05.2021 18.08.2021	21.04.2022	100%	Marre perfundi misht ne dorezim	B.O.E “M”
10	RIKONSTRUKSIONI I RRJETIT TE UJESJELLESIT NE FSHATIN ZGOSHT, BASHKIA LIBRAZHID	UK LIBRAZHID sh.a	25,917,508.90			100%		Z

VI. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT

Pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit është edhe dokumentacioni më poshtë:

Nr.	Emertimi	Objekti
1.	Aktkonstatim nr.1, datë 05.04. 2024	“Mbi funksionim e strukturave drejtuese”
2.	Aktkonstatim nr.2, datë 05.04. 2024	“Mbi programin ekonomik dhe pagat e 6 njësite”
3.	Aktkonstatim nr.3, datë 05.04. 2024	“Mbi organikën, sturkturat dhe pagat e SHRUKË”
4.	Aktkonstatim nr.4, datë 05.04. 2024	“Mbi programin ekonomik SHRUKË”
5.	Aktkonstatim nr.5, datë 05.04. 2024	“Mbi blerjet me vlera të vogla UK Belsh”
6.	Aktkonstatim nr.6, datë 05.04. 2024	“Mbi blerjet me vlera të vogla UK Cërrik”
7.	Aktkonstatim nr.7, datë 05.04. 2024	“Mbi blerjet me vlera të vogla UK Gramsh”
8.	Aktkonstatim nr.8, datë 05.04. 2024	“Mbi blerjet me vlera të vogla UK Librazhd”
9.	Aktkonstatim nr.9, datë 05.04. 2024	“Mbi veprimet e bankës, shpenzime operative SHRUKË”
10.	Aktkonstatim nr.10, datë 05.04. 2024	“Mbi blerjet me vlera të vogla UKE”
11.	Aktkonstatim nr.11, datë 05.04. 2024	“Mbi blerjet me vlera të vogla UK Peqin”
12.	Aktkonstatim nr.12, datë 05.04. 2024	“Mbi blerjet me vlera të vogla UKE”
13.	Aktkonstatim nr.13, datë 05.04. 2024	“Mbi blerjet me vlera të vogla Cërrik”
14.	Aktkonstatim nr.14, datë 05.04. 2024	“Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit”
15.	Aktkonstatim nr.15, datë 05.04. 2024	“Mbi zbatimin e kontratave”
16.	Aktkonstatim nr.16, datë 05.04. 2024	“Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit”
17.	Aktkonstatim nr.17, datë 05.04. 2024	“Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit”
18.	Aktkonstatim nr.18, datë 05.04. 2024	“Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit”
19.	Aktkonstatim nr.19, datë 05.04. 2024	“Mbi zbatimin e kontratës”
20.	Aktkonstatim nr.20, datë 05.04. 2024	“Mbi zbatimin e kontratave”
21.	Aktkonstatim nr.21, datë 05.04. 2024	“Mbi zbatimin e kontratave”
22.	Aktkonstatim nr.22, datë 05.04. 2024	“Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit”
23.	Aktkonstatim nr.23, datë 05.04. 2024	“Mbi mbajtjen e evidences kontabël”